



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 102

Tiranë – E premte, 8 korrik 2022

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 51/2022 datë 9.6.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.5.2022, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”.....	12787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 6.7.2022	Për miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2021.....	12787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 6.7.2022	Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara.....	12797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 6.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.....	12805
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 21, datë 27.6.2022	Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional.....	12813
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 8.7.2022	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”.....	12824
Urdhër i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 163, datë 6.6.2022	Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit .....	12826

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 134, datë 27.6.2022	Për miratimin e rregullores “Për nivelin minimal të trajnimit të detarëve”.....	12826
Rregullore e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe e Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 2666/1, datë 21.6.2022	Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paaftësitë e përkohshme për punë, për barrë lindje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale.....	12877
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 347/6, datë 6.7.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Cërrik– Kajan–Kuçovë–Jagodinë”.....	12884



**LIGJ**  
**Nr. 51/2022**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,  
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 9, DATË  
11.5.2022, “PËR NJË SHITESË NË AKTIN  
NORMATIV NR. 7, DATË 18.3.2022, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
TRANSPARENCËN DHE  
MONITORIMIN E ÇMIMIT PËR DISA  
PRODUKTE USHQIMORE BAZË DHE  
PRODUKTE TË TJERA TË LIDHURA  
ME TO SI PASOJË E SITUATËS SË  
VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.5.2022, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miratuar më datë 9.6.2022.

**VENDIM**  
**Nr. 469, datë 6.7.2022**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR  
PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË  
VITIT 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2021, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**RAPORTI VJETOR**  
**PËR NDIHMAT SHTETËRORE**  
**TË VITIT 2021**

**PËRMBLEDHJE**

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5, të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndhmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe të analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore të miratuara sipas vendime të miratuara nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Bashkia e Tiranës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2021, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2014–2021, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së.



Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë, që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2017–2021. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2017–2021 është vlerësuar në rreth 53,070.36 milionë lekë (388.54 milionë €), prej të cilave 4,633.30 milionë lekë (37.44 milionë €), që përfaqësojnë 0.25% të PBB-së, janë dhënë në vitin 2021. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2021, vendin kryesor (rreth 54.2%) e zënë ndihmat horizontale, ndërsa ndihma sektoriale përbën 45.8% të ndihmës gjithsej. Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin “*de minimis*” të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2021 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, raporti vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2021 do t’i përcillet Komisionit Evropian.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2021

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2017–2021

2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

2.2.1 Ndhimja shtetërore horizontale

2.2.2 Ndhimja shtetërore sektoriale

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që

rrjedhin nga marrëveshja e stabilizim-asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore, si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohet se:

*“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.*

Gjithashtu, neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>, përcakton se:

*“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”*

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarrja nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të

<sup>1</sup> Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



nenit 107(1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- Masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;

- Masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar; si edhe

- Masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

### Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

a) *Ndihma për organet publike dhe njësi të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet joekonomik;*

b) *Masa të përgjithshme të destinuar për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;*

c) *Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve me çmimin e tregut.*

## 1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

### Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- Ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;

- Ndihmën për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme;

- Ndihmën për punësim;

- Ndihmën për trajnim;

- Ndihmën operacionale;

- Ndihmën për sportin;

- Ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndihmën për transportin publik;

- Ndihmën për shërbimin publik;

- Ndihmën për infrastrukturën *broadband*;

- Ndihmën për turizmin.

**Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:**

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore;

A3 – Garancitë shtetërore.

## II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2021

### 2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2017–2021

**A) Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike**

**Tabela nr. 1:** Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomike 2014–2021

Treguesit	Njësia e matjes	2014	Shkalla e ndihmës 2014	2015	Shkalla e ndihmës 2015	2016	Shkalla e ndihmës 2016	2017	Shkalla e ndihmës 2017	2018	Shkalla e ndihmës 2018	2019	Shkalla e ndihmës 2019	2020	Shkalla e ndihmës 2020	2021	Shkalla e ndihmës 2021
PBB	mlrd lekë	1,395.3	0.23	1,434.3	0.35	1,472.5	0.19	1,550.6	0.24	1,696.7	0.33	1,691.9	0.50	1,644.1	1.87	1,890.3	0.25
Të punësuar (15-64 vjeç)	rr	1,005,924	3,234	1,055,836	4,750	1,120,281	2,504	1,167,785	3,253	1,184,413	4,687	1,210,615	7,007	1,172,988	26,225	1,198,177	3,867
Popullsia	rr	2,889,104	1,126	2,880,703	1,741	2,876,101	975	2,873,457	1,322	2,866,376	1,937	2,862,427	2,963	2,829,741	10,871	2,829,741	1,637
Ndihma shtetërore	mlrd lekë	3,252.78		5,014.99		2,805.34		3,798.67		5,551.34		8,482.45		30,761.82		4,633.30	


Burimi: MFE

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2015–2021, si edhe treguesit e përqindjes së ndihmës shtetërore ndaj GDP-së; ndihmë shtetërore për person të punësuar dhe ndihma shtetërore për person të popullsisë. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2021 është dhënë në vlerën totale 4,633.3 milion lekë (37.44 milion euro). Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u ul nga 1.87 % më 2020-n, në 0.25 % në vitin 2021.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2014–2021.



*Grafiku nr. 1: Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014–2021*



### B) Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2018–2019.

*Tabela nr. 2: Shkalla e Ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2018–2019*

Periudha	2018	2019
<b>Shtetet</b>		
Shqipëri	0.33	0.5
Belgjikë	0.79	0.94
Bullgari	0.99	0.42
Ceki	1.60	1.33
Danimarkë	1.54	1.40
Gjermani	1.45	1.54
Estoni	1.03	1.16
Irlandë	0.16	0.23
Greqi	0.31	0.54
Spanjë	0.34	0.31
France	0.90	0.85
Kroaci	1.53	1.29
Itali	0.42	0.35
Qipro	0.46	0.47
Letoni	1.00	0.99
Lituani	1.51	1.68
Luksemburg	0.24	0.26
Hungari	2.05	1.67
Maltë	3.32	1.80
Holandë	0.35	0.33
Austri	0.45	0.46
Poloni	1.12	1.02
Portugali	0.52	0.45
Romani	0.54	0.64
Sloveni	0.88	0.83
Slovaki	0.48	0.60
Finlandë	0.82	0.78
Suedi	0.91	0.80
<b>Mbretëria e Bashkuar</b>	0.44	0.51

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition<sup>2</sup> dhe MFE (%)

<sup>2</sup>[https://webgate.ec.europa.eu/comp/redisstat/databrowser/view/AID\\_SCB\\_OBJ/default/table?lang=en&category=A](https://webgate.ec.europa.eu/comp/redisstat/databrowser/view/AID_SCB_OBJ/default/table?lang=en&category=A)



## 2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndhimë shtetërore horizontale; dhe
- Ndhimë shtetërore sektoriale.

**Ndhimja shtetërore horizontale** jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.


**Ndhimja shtetërore sektoriale** jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

**Tabela nr. 3: Ndhimja shtetërore gjithsej 2018–2021 ndarë sipas kategorive (në milionë lekë)**

KATEGORIA	2017			2018			2019			2020			2021		
	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %
<b>Ndhimja Horizontale</b>	<b>2,379.88</b>	<b>17.86</b>	<b>63.2%</b>	<b>4,082.54</b>	<b>32.00</b>	<b>74.5%</b>	<b>4,210.44</b>	<b>34.23</b>	<b>49.8%</b>	<b>28,815.79</b>	<b>232.84</b>	<b>93.76%</b>	<b>2,511.09</b>	<b>20.29</b>	<b>54.20%</b>
Punësimi	196.79	1.48	5.2%	111.78	0.88	2.0%	247.73	2.01	2.9%	0.51	0.00	0.0%	44.40	0.36	0.2%
Trajnimi	276.98	2.08	7.4%	150.48	1.18	2.7%	98.22	0.80	1.2%	3.50	0.03	0.0%	67.36	0.54	0.2%
Sport	218.80	1.64	5.8%	104.01	0.82	1.9%	121.72	0.99	1.4%	125.31	1.01	0.4%	185.90	1.50	0.6%
Kultura	39.58	0.30	1.1%	134.00	1.05	2.4%	63.32	0.51	0.7%	93.99	0.76	0.3%	84.04	0.68	0.3%
<b>Ndhimja operacionale</b>	<b>5.02</b>	<b>0.04</b>	<b>0.1%</b>	<b>1,642.90</b>	<b>12.88</b>	<b>30.0%</b>	<b>1,532.50</b>	<b>12.46</b>	<b>18.1%</b>	<b>27,475.35</b>	<b>222.01</b>	<b>95.3%</b>	<b>325.30</b>	<b>2.63</b>	<b>1.1%</b>
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,595.38	11.97	42.4%	1,895.98	14.86	34.6%	2,060.24	16.75	24.4%	1,096.00	8.86	3.8%	1,768.02	14.29	6.1%
SME	47.33	0.36	1.3%	43.39	0.34	0.8%	86.71	0.71	1.0%	21.13	0.17	0.1%	36.08	0.29	0.1%
<b>Ndhimja Sektoriale</b>	<b>1,383.79</b>	<b>10.38</b>	<b>36.8%</b>	<b>1,400.00</b>	<b>10.97</b>	<b>25.5%</b>	<b>4,246.37</b>	<b>34.53</b>	<b>50.2%</b>	<b>1,918.25</b>	<b>15.50</b>	<b>6.24%</b>	<b>2,122.21</b>	<b>17.15</b>	<b>45.80%</b>
Transport publik (Hekurudha)	400.00	3.00	10.6%	400.00	3.14	7.3%	400.00	3.25	4.7%	400.00	3.23	20.9%	400.00	3.23	20.9%
Shërbimi publik	974.90	7.32	25.9%	1,000.00	7.84	18.2%	400.00	3.25	4.7%	720.00	5.82	37.5%	380.00	3.07	19.8%
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	-	-	491.96	4.00	5.8%	54.25	0.44	2.8%	71.65	0.58	3.7%
Turizmi	8.89	0.07	0.2%	-	-	-	2,954.41	24.02	35%	744.00	6.01	38.8%	1,270.56	10.27	66.2%
<b>TOTALI</b>	<b>3,763.67</b>	<b>28.25</b>	<b>100</b>	<b>5,482.54</b>	<b>42.97</b>	<b>100</b>	<b>8,456.81</b>	<b>68.76</b>	<b>100</b>	<b>30,734.04</b>	<b>248.34</b>	<b>100</b>	<b>4,633.30</b>	<b>37.44</b>	<b>100</b>


Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

**Grafiku nr. 2: Ndhimja shtetërore gjithsej 2017–2021**



Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafiku nr. 3: Ndhimja shtetërore horizontale/sectoriale 2017–2021



*Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3 tregojnë se në vitin 2021 ndihma shtetërore horizontale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 54.2 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 45.8 %.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2021 u ulën me 26,100.74 milion lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2020. Ky ndryshim i përgjithshëm është rezultat i faktorëve, si: 1. Rritje e ndihmës shtetërore për punësimin me 43.89 milion lekë; 2. Rritje e ndihmës shtetërore për trajnimin me 94.21 milion lekë; 3. Rritje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit me 63.86 milion lekë; 4. Rritje e ndihmës shtetërore për sportin me 60.59 milion lekë; 5. Ulje e ndihmës shtetërore për kulturën me 9.95; 6. Ulje e ndihmës operacionale me 27,150.05 milion lekë; 7. Rritje e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 672.02 milion lekë; 8. Rritje e ndihmës shtetërore për SME-të me 14.95 milion lekë; 9. Ulje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) me 340 milion lekë; 10. Rritje e ndihmës për infrastrukturën *broadband* me 526.56 milion lekë; dhe 11. Rritje e ndihmës shtetërore për turizmin me 526.56 milion lekë.

### 2.2.1. Ndhimja shtetërore horizontale

Në vitin 2021 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 2,511.09 milion lekë (20.29 milion euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e zë ndihma për kërkim dhe zhvillim me 6.1%.

Tabela nr. 4: Ndhimja shtetërore horizontale 2017–2021


Ndhimja Horizontale	2017		2018		2019		2020		2021	
	mIn LEK	mIn EUR	mIn LEK	mIn EUR	mIn LEK	mIn EUR	mIn LEK	mIn EUR	mIn LEK	mIn EUR
Punësimi	196.79	1.48	112.10	0.88	247.73	2.01	0.51	0.00	44.40	0.36
Trajnim	276.98	2.08	150.48	1.18	98.22	0.80	3.50	0.03	67.36	0.54
Sport	218.80	1.64	104.01	0.82	121.72	0.99	125.31	1.01	185.90	1.50
Kultura	39.58	0.30	134.00	1.05	63.32	0.51	93.99	0.76	84.04	0.68
Ndhimja operacionale	5.02	0.04	1,642.90	12.88	1,532.50	12.46	27,475.35	222.01	325.30	2.63
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,595.38	11.97	1,895.98	14.86	2,060.24	16.75	1,096.00	8.86	1,768.02	14.29
SME	47.33	0.36	43.39	0.34	86.71	0.71	21.13	0.17	36.08	0.29
<b>TOTALI</b>	<b>2,379.88</b>	<b>17.86</b>	<b>4,082.86</b>	<b>32.00</b>	<b>4,210.44</b>	<b>34.23</b>	<b>28,815.79</b>	<b>232.84</b>	<b>2,511.09</b>	<b>20.29</b>

*Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*






Grafiku nr. 4: Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2017–2021



Grafiku nr. 5: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale më 2021-shin



Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore horizontale janë si vijon:

**Ndihma për punësim:** Ndihma për punësim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”. Sipas VKM -17 u punësuan, u formuan nëpërmjet punës dhe praktikave profesionale 1095 persona.

- **Programi i punësimit:** Për këtë program u planifikuan 55.877.069 lekë dhe u realizuan fakt 44.406.923 lekë ose 80% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 155 subjekte, të cilat kanë punësuar **292 punëkërkuës të papunë**.

**Ndihma për trajnim:** Ndihma për trajnim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës

Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”.

- **Programi i formimit nëpërmjet punës:** Për këtë program u planifikuan 32.574.347 lekë dhe u realizuan fakt 30.954.538 lekë ose 95% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 79 subjekte, të cilat kanë punësuar 226 punëkërkuës të papunë.

- **Programi i Praktikave Profesionale:** Për këtë program u planifikuan 40.460.771 lekë dhe u realizuan fakt 36.402.697 lekë ose 90% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 85 subjekte, të cilat kanë punësuar 458 punëkërkuës të papunë.



*Ndihma për sportin:* Ndihma për sportin është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 54, datë 26.1.2015, “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike, duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2021 janë dhënë 185.9 milion lekë.

*Ndihma për nxitjen e kulturës:* Ndihma për kulturën është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 56, datë 4.6.2015, “Autorizim i ndihmës shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore”. Në vitin 2020 ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është në vlerën 84.04 milion lekë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike, për 160 projekte në programin e artit dhe kulturës.

*Ndihma operationale:* Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuara me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 24, datë 2.5.2008, “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serrat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”. Për vitin 2021 dhënësit dhe zbatuesit e ndihmës shtetërore raportojnë ndihmën shtetërore në shumën 325.29 milion lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serrat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, me përfitues 7 subjekte.

*Ndihma për kërkim dhe zhvillim:* Ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë “marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2021 është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfituar përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 1,768.02 milion lekë (në

vitin 2020 shuma e përjashtimeve ishte 1,096.0 milion lekë).

*Ndihma për SME:* Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuara me vendim të KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020, “Autorizim i Ndhmës Shtetërore ‘Mbështetje Financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese, të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’, duke futur elemente ‘Go-Green’ në to””; me vendim të KNSH-së nr. 101, datë 15.12.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore, “Për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave””; dhe me vendim të KNSH-së nr. 103, datë 19.7.2021, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes’. Bashkia e Tiranës raporton dhe vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 36.08 milion lekë, duke përfituar gjithsej.

- Skema e autorizuar me vendim të KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020, “Autorizim i Ndhmës Shtetërore ‘Mbështetje Financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese, të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’, duke futur elemente ‘Go-Green’ në to””, me përfitues 24 subjekte.

- Skema e autorizuar me vendim të KNSH nr. 101, datë 15.12.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore, ‘Për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave’, me përfitues 18 subjekte.

- Skema e autorizuar, me vendim të KNSH-së nr. 103, datë 19.7.2021, “Autorizim i ndihmës shtetërore, ‘Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes’”, me përfitues 20 subjekte.

### 2.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale


Në vitin 2021 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 2,122.21 milion lekë (17.15 milion euro). Peshë për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2021 është 45.8%.

Tabela nr. 5: Ndhimja shtetërore sektoriale 2017–2021


Ndhimja sektoriale	2017		2018		2019		2020		2021	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Transport publik (Hekurudha)	400.00	3.00	400.00	3.14	400.00	3.25	400.00	3.23	400.00	3.23
Shërbimi publik	974.90	7.32	1,000.00	7.84	400.00	3.25	720.00	5.82	380.00	3.07
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	491.96	4.00	54.25	0.44	71.65	0.58
Turizmi	8.89	0.07	-	-	2,954.41	24.02	744.00	6.01	1,270.56	10.27
<b>TOTALI</b>	<b>1,383.79</b>	<b>10.38</b>	<b>1,400.00</b>	<b>10.97</b>	<b>4,246.37</b>	<b>34.53</b>	<b>1,918.25</b>	<b>15.50</b>	<b>2,122.21</b>	<b>17.15</b>

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafiku nr. 6: Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2017–2021



Grafiku nr. 7: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2020



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2021, peshën kryesore e zë ndihma për turizmin (60%).

*Ndhimja për transportin publik* e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor është 400 milionë lekë edhe në vitin 2021.

*Ndhimja për shërbimet publike:* Në vitin 2021 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizime në shumën 380 milion lekë.

*Ndhimja për Infrastruktura Broadband:* Në bazë të vendimit të Komisionit të Ndhimës Shtetërore nr. 89, datë 23.4.2019, “Autorizimi i ndihmës shtetërore për digjital-divident”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore ka dhënë ndihmën në vlerën 71.65 milionë lekë.



*Ndihma për turizmin:* Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 82, datë 17.5.2018, “Autorizim i Ndhmës Shtetërore ‘Për skemën e Incentivave Fiskale në Sektorin e Turizmit’”, ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit për vitin 2021 është përfituar nga strukturat akomoduse nga reduktimi i TVSH-se nga 20% në 6% për vitin 2021 në shumën 1253.19 milionë lekë. Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 74, datë 12.12.2016, “Autorizim i ndihmës shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit”, në vitin 2021 janë dhënë 17.37 milion lekë me 7 përfitues.

### III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2021, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen, në:

*A1 – Subvencione dhe grante;*

*A2 – Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;*

*B – Pjesëmarrja në kapital;*

*C1 – Hua të buta;*

*C2 – Instrumente të tjera;*

*D – Garancitë.*


Tabela nr. 6: Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Ndihma Shtetërore`	Subvencione dhe Grante (A1)	Përfshirje nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
<b>Ndihma Horizontale</b>		
<i>Punësimi</i>	44.40	
<i>Trajnim</i>	67.36	
<i>Sport</i>	185.90	
<i>Kultura</i>	84.04	
<i>Ndihma operacionale</i>		325.29
<i>Kërkim, zhvillim dhe inovacion</i>		1,768.02
<i>SME</i>	36.08	
<b>Ndihma Sektoriale</b>		
<i>Transport publik (Hekurudha)</i>	400.00	
<i>Shërbimi publik</i>	380.00	
<i>Infrastruktura Broadband</i>	71.65	
<i>Turizmi</i>	17.37	1,253.19
<b>TOTALI</b>	<b>1,286.80</b>	<b>3,346.50</b>

*Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Instrumenti i përdorur më shumë është dhe A2 – Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet social (72 %); A1 – Subvencione dhe grante (28 %), sikurse paraqitet edhe në grafikun nr. 8.

Grafiku nr. 8: Struktura e shpërndarjes së instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2021

**VENDIM**

Nr. 470, datë 6.7.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE,  
PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË  
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË  
VENDIMMARRJES SË MBËSHTETUR  
PËR PERSONAT ME AFTËSI  
TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ky vendim përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve të vendimarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara.

2. Në kuptim të këtij vendimi, vendimarrje e mbështetur është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara, nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin më të mirë të personit të aftësisë së kufizuara, duke i mundur kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

3. Mbështetja në vendimarrje ofrohet si alternativë fuqizuese, me qëllim realizimin e të

drejtave dhe lirive të personit me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen efektive të personit në shoqëri si përfitues i shërbimeve në institucionet publike dhe jopublike, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

4. Ofrimi i vendimarrjes së mbështetur bazohet në respektin e nevojave, dëshirave, zgjedhjeve, vlerave, besimeve dhe traditave të personave me aftësi të kufizuara.

5. Mbështetja në vendimarrje për personat me aftësi të kufizuara, fizike, mendore, intelektuale ose ndijore ofrohet për të rritur aksesin për mbështetjen e nevojshme, kur personat me aftësi të kufizuara janë në pamundësi për të marrë vendime, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Vendimarrja e mbështetur synon marrjen e vendimeve nga personi me aftësi të kufizuara pas ofrimit të informacionit të plotë nga mbështetësi. Komunikimi i vendimeve nga personi me aftësi të kufizuara ose mbështetësi, kur garantohet komunikimi joverbal ose komunikim i thjeshtuar kryhet vetëm për rastet kur vendimarrja e mbështetur është në interesin e personit me aftësi të kufizuara dhe ky i fundit përfiton nga mbështetja në vendimarrje.

7. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë:

a) të zgjedhin mënyrën si do të jetojnë, sipas mundësive të tyre;

b) të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe gjithëpërfshirëse në aktivitetet e jetesës së përditshme, sipas vendimarrjes që mbron interesin më të lartë të tyre;



c) të marrin vendime për mbështetje në formën më efektive pa kufizime dhe ndërhyrje në të drejtat e tyre;

ç) të pranojnë ose të refuzojnë mbështetjen për vendimmarrje, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

d) të marrin vendime pa cenuar të drejtat e personave të tjerë.

8. Mbështetësi ndihmon në marrjen dhe komunikimin e vendimeve për personat me aftësi të kufizuara. Mbështetësi, në asnjë rast, nuk zëvendëson si vendimmarrës vetë personat me aftësi të kufizuara.

9. Personi me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohet si i paaftë për të marrë vendime bazuar vetëm mbi faktin se vendimet mund të mos pranohen nga mbështetësi.

10. Mungesa e aftësisë për të marrë një vendim në një fushë të caktuar nuk nënkupton mungesën e aftësisë për të marrë vendime në fusha të tjera.

11. Mbështetja që ofrohet ndaj personit me aftësi të kufizuara synohet të jepet në një kohë sa më të shkurtër dhe në përputhje me kërkesat e personave me aftësi të kufizuara.

12. Personi me aftësi të kufizuara, i cili përfiton mbështetjen në vendimmarrje, është personi që ka aftësi për të marrë vetë vendime dhe kërkon mbështetje, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

13. Personi me aftësi të kufizuara, që përfiton mbështetjen për vendimmarrje, nuk prezumohet si i paaftë për të marrë vendime, në rastet kur informacioni i ofruar nuk është në formë të përshtatur, duke përfshirë gjuhën e thjeshtuar, komunikimin joverbal nga interpreti i gjuhës së shenjave, shoqëruesi për të verbrit dhe ndihmën e mjeteve ndihmëse.

14. Marrëveshja e vendimmarrjes së mbështetur është alternativë për vendimmarrje të mbështetur për personat me aftësi të kufizuara, që janë në gjendje të marrin vendimet e tyre, por që kanë nevojë për një kompetencë specifike të shtuar.

15. Marrëveshja për vendimmarrje të mbështetur nuk zëvendëson, në asnjë rast, alternativat ekzistuese, si kujdestaria ligjore/përfaqësuesi ligjor.

16. Në rastin kur një grup individësh janë deklaruar si mbështetës në vendimmarrje, ata bashkëpunojnë për procesin e mbështetjes me

personin me aftësi të kufizuara, sipas përzgjedhjes së personit me aftësi të kufizuara.

17. Institucionet publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbime, kanë detyrimin:

a) të marrin masat përkatëse për ofrimin e informacionit sipas kërkesës verbale ose me shkrim nga personi me aftësi të kufizuara;

b) të evidentojnë dhe të trajnojnë personat që ofrojnë këtë shërbim për formatet e aksesueshme sipas legjislacionit në fuqi.

18. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, bashkitë dhe organizatat për aftësinë e kufizuar bashkëpunojnë për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e personave me aftësi të kufizuara për të përdorur vendimmarrjen e mbështetur si një mjet për fuqizimin e autonomisë e të pavarësisë së personave me aftësi të kufizuara.

19. Shërbimin e vendimmarrjes së mbështetur e përfitojnë personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë, dëshirojnë e zgjedhin këto shërbime dhe plotësojnë këto kritere:

a) Kanë mbushur moshën 18 vjeç;

b) Kërkojnë mbështetje për të marrë vendime për aktivitete të jetës së përditshme, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Hasin pengesa për marrjen apo kuptimin e informacionit që i nevojitet për të marrë vendime.

20. Mbështetës në vendimmarrje është/janë:

a) familjari/ët, i afërmi/të afërmit, miqtë ose ndihmësi personal;

b) një ose disa individë me zotësi të plotë për të vepruar, që garanton/jnë mbrojtjen e personit me aftësi të kufizuara, pa qëllim abuzimi apo përfitimi gjatë gjithë ofrimit të vendimmarrjes së mbështetur;

c) një individ ose grup individësh, zgjedhur prej personit me aftësi të kufizuara, që plotëson kriteret e përcaktuara dhe ka nënshkruar marrëveshjen, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) i/të gatshëm që të mbështesë/in personin që kërkon mbështetje në vendimmarrje, duke vepruar në përputhje me interesin, zgjedhjet dhe dëshirat e personit me aftësi të kufizuara.

21. Mbështetësi në vendimmarrje të mbështetur nuk duhet të jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, kundërvajtjeje penale me dashje apo vendim gjykatë me një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

22. Personi me aftësi të kufizuara dhe mbështetësi/t në vendimmarrje nënshkruajnë një



marrëveshje sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të cilën e dorëzojnë në njësinë administrative/strukturat vendore të shërbimeve sociale në bashki. Marrëveshja nuk përjashton që personi me aftësi të kufizuara të kryejë veprime në mënyrë të pavarur nga marrëveshja.

23. Nënshkrimi i marrëveshjes kryhet në praninë e dy punonjësve nga sektori i shërbimeve sociale i bashkisë/njësisë administrative përkatëse.

24. Mbështetësi merr informacionin e duhur dhe bashkëpunon me punonjës social në bashki, për të komunikuar në mënyrë të kuptueshme dhe në formatin më të përshtatshëm për personin që merr vendimin.

25. Mbështetësi paraqitet individualisht dhe/ose me personin me aftësi të kufizuara në çdo institucion publik dhe jopublik për të marrë informacion me autorizim ligjor.

26. Punonjësi nga strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe njësisë administrative identifikon dhe referon rastet e mosofrimit të shërbimit të vendimmarrjes së mbështetur.

27. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Shërbimi Social Shtetëror përfshijnë vendimmarrjen e mbështetur, si shërbim i ofruar, sipas legjislacionit në fuqi.

28. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Shërbimi Social Shtetëror nxitin dhe promovojnë përgatitjen e institucioneve për vendimmarrje të mbështetur përmes programeve të trajnimit në bashki, me qëllim mirëfunksionimin e këtij shërbimi.

29. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar bashkëpunon me strukturat e shërbimeve sociale në nivel rajonal dhe vendor për të përforcuar referimin e shërbimeve që ndihmojnë në vendimmarrjen e mbështetur.

30. Institucionet publike dhe jopublike kanë detyrimin që të shpjegojnë të drejtat dhe detyrimet personave me aftësi të kufizuara/mbështetësve, pasojat e veprimeve me natyrë juridike, duke përdorur teknika të përshtatshme për nivelin dhe llojin e aftësisë së kufizuar.

31. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, bashkitë dhe njësitë administrative për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj



## ANEKS NR.1

## MARRËVESHJE PËR VENDIMMARRJEN E MBËSHTETUR

\* Marrëveshja duhet të lexohet me zë të lartë. Teksti i saj është në gjuhë të thjeshtuar për aftësinë e kufizuar dhe të përshtatet në format për t'u kuptuar qartë nga personi me aftësi të kufizuara.

## 1. Të dhëna personale

a) Emri im është: \_\_\_\_\_

(Emër, atësia, mbiemri)

b) Numri personal i identifikimit; \_\_\_\_\_

c) Mosha: \_\_\_\_\_

ç) Gjinia: \_\_\_\_\_

d) Arsimi: \_\_\_\_\_

dh) Vendbanimi: \_\_\_\_\_

Unë kam nevojë për mbështetje nga njerëz të besuar për të marrë vendime. Njerëzit që do të më ndihmojnë quhen “mbështetës”. Unë mundem të deklaroj cilat janë nevojat e mia për ndihmë në marrjen e vendimeve dhe kuptoj pasojat

PO \_\_\_\_\_ JO \_\_\_\_\_

## 2. Mbështetësi për vendimmarrje nr.1

a) Emri im është: \_\_\_\_\_

(Emër, atësia, mbiemri)

b) Numri personal i identifikimit; \_\_\_\_\_

c) Mosha: \_\_\_\_\_

ç) Gjinia: \_\_\_\_\_

d) Arsimi: \_\_\_\_\_

dh) Vendbanimi: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_/\_\_/\_\_

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrim

Data

## 3. Mbështetësi për vendimmarrje nr.2





a) Emri im është: \_\_\_\_\_

(Emër, atësia, mbiemri)

b) Numri personal i identifikimit: \_\_\_\_\_

c) Moshë: \_\_\_\_\_

ç) Gjinia: \_\_\_\_\_

d) Arsimi: \_\_\_\_\_

dh) Vendbanimi: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri dhe Mbiemri

\_\_\_\_\_

Nënshkrim

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Data

4. Fushat në të cilat kërkoj ndihmën e mbështetësit tim në vendimarrje:

a. Çështjet shëndetësore:

Mbështetje duke aksesuar dhe marrë informacionet e nevojshme të cilat ndihmojnë në vendimmarrje më të mirë për personin me aftësi të kufizuara, për caktimin e takimeve dhe komunikimin me ofruesit e shërbimeve shëndetësore. Mbështetësi im nuk mund të shikojë të dhënat e mia personale sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

b. Shërbimet mbështetëse sociale:

Shërbimet mbështetëse ku mund të ndihmohem në shërbimet sociale duke aksesuar dhe marrë informacionin e nevojshëm që do të më ndihmojë për një vendimmarrje më të mirë për shërbimet që më ofrohen. Mbështetësi im nuk mund të shikojë të dhënat e mia personale sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

c. Çështjet financiare:

Mbështetje për personin me aftësi të kufizuara që të marrë vendime duke sjellë informacion për çështjet financiare, si: shpenzimin dhe kursimin në jetën e përditshme për nevoja, si veshja, strehimi, edukimi, arsimimi. Mbështetësi im nuk mund të shikojë të dhënat e mia



personale sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

ç. Mbështetësit e deklaruar më sipër do të më ndihmojnë për këto aktivitete: (shëno cilat ke nevojë)

- Çfarë dua të bëj në qendër ditore/qendër rezidenciale/shtëpi familje \_\_\_\_\_
- Si të kujdesem për shëndetin
- Si ta kaloj kohën
- Ku të punoj dhe si mund të marr informacion për punësim dhe formim profesional
- Si të zgjedh çfarë të ha e çfarë rrobash të vesh
- Si të shpenzoj dhe të kursej paratë për jetesën e përditshme
- Ku të jetoj

Tjetër \_\_\_\_\_

5. Fushat në të cilat nuk dua ndihmën e mbështetësit tim në vendimmarje (nëse ka)

---

---

---

---

6. Mbështetësit nuk do të marrin vendime për mua. Ata më ndihmojnë të marr vendime, po vendimet i marr unë. Që të më ndihmojnë, mbështetësit:

- Do të më ndihmojnë të mësoj më shumë rreth zgjedhjeve të mia.
- Do të më ndihmojnë të kuptoj zgjedhjet e mia, në mënyrë që të marr vendime të mira për mua.
- Do të më ndihmojnë t’u thonë të tjerëve vendimin tim.

7. Kjo marrëveshje fillon në datën \_\_\_\_\_ do të vazhdojë derisa të them unë apo mbështetësi.

8. Nënshkrimi i personit me aftësi të kufizuara.



Unë e nënshkruaj këtë marrëveshje sepse dua që të marr ndihmë për vendime. Unë e di që nuk jam i detyruar ta firmos. Unë e di që mund ta ndryshoj këtë marrëveshje dhe po e firmos me vullnetin tim pa u ndikuar ose detyruar.

Nënshkrimi /emri \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

#### 9. Deklaratë e mbështetësit të parë

a) Emri im është: \_\_\_\_\_

(Emër, atësia, mbiemri)

b) Numri personal i identifikimit: \_\_\_\_\_

c) Moshë: \_\_\_\_\_

ç) Gjinia: \_\_\_\_\_

d) Arsimi: \_\_\_\_\_

dh) Vendbanimi: \_\_\_\_\_

Unë i/e nënshkruari/a, \_\_\_\_\_ deklaroj që jam mbështetës i \_\_\_\_\_ dhe do ta mbështes në vendimmarrje me ndershmëri, mirëbesim dhe integritet.

Detyra ime si mbështetës/e është të respektoj, shpreh dhe komunikoj në palë të treta mendimet, zgjedhjet dhe dëshirat e \_\_\_\_\_.

Mbështetja ime është:

a) dhënia e informacionit për këtë person në një mënyrë që ta kuptojë atë për të marrë vendime;

b) diskutimi mbi alternativat, të mirat dhe të këqijat e vendimeve që mund të marrë;

c) ndihmë që të përçojë vendimin, dëshirat apo preferencat;

ç) shpjegimi i vendimeve të vendimmarrësit palëve të treta.

#### 10. Deklaratë e mbështetësit të dytë/tretë



a) Emri im është: \_\_\_\_\_  
(Emër, atësia, mbiemri)

b) Numri personal i identifikimit: \_\_\_\_\_

c) Moshë: \_\_\_\_\_

ç) Gjinia: \_\_\_\_\_

d) Arsimi: \_\_\_\_\_

dh) Vendbanimi: \_\_\_\_\_

Unë i/e nënshkruari/a, \_\_\_\_\_ deklaroj që jam mbështetës i \_\_\_\_\_ dhe do ta mbështes në vendimmarrje me ndershmëri, mirëbesim dhe integritet.

Detyra ime si mbështetës/e është të respektoj, t'u shpreh dhe t'u komunikoj palëve të treta mendimet, zgjedhjet dhe dëshirat e \_\_\_\_\_.

Mbështetja ime është:

- a) dhënia e informacionit për këtë person në një mënyrë që ta kuptojë atë për të marrë vendime;
- b) diskutimi mbi alternativat, të mirat dhe të këqijat e vendimeve që mund të marrë;
- c) ndihmë që të përçojë vendimin, dëshirat apo preferencat.
- ç) shpjegimi i vendimeve të vendimmarrësit palëve të treta.

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Vendi \_\_\_\_\_



**VENDIM**  
**Nr. 471, datë 6.7.2022**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 636, DATË 26.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE, TË MËNYRËS SË SHKËMBIMIT E TË PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT DHE TË TË DHËNAVE STATISTIKORE, TË KËRKUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS, PRANË STRUKTURAVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 18/2017, “Për të

drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shtojca 1, bashkëlidhur vendimit nr. 636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**SHTOJCA 1**  
**LISTA E TREGUESVE**

Nr.	Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave
1	Numri dhe përqindja e fëmijëve, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër, përqindje	INSTAT
2	Numri dhe përqindja e martesave deri 18 vjeç, sipas: - Gjinisë; - Moshës.	Numër, përqindje	INSTAT/Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)
3	Numri dhe përqindja e vajzave deri 18 vjeç që kanë lindur/regjistruar fëmijë, sipas moshës.	Numër, përqindje	INSTAT/DPGJC
4	Përqindja/numri i fëmijëve që jetojnë në nivel varfërie relative, disagregimi sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Numrit të fëmijëve në familje; - Ndarjes gjeografike.	Përqindje/numër	INSTAT/anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri
5	Numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës (0-18 vjeç) - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (DPSHSSH)/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6	Numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshave; - Regjistrimi në sistemin parashkollor dhe në sistemin e arsimit bazë; - Qarqeve.	Numër	DPSHSSH/MSHMS



7	<b>Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale (në fund të vitit), sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës (0–6 vjeç, 6–18 vjeç); - Lloji të shërbimit; - Sektorit të shërbimit (privat/publik/jopublik); - Qarqeve.	Numër	DPSHSSH
8	<b>Numri i fëmijëve në familje kujdestare në fund të vitit raportuar nga Shërbimi Social Shtetëror, sipas:</b> - Statusit të Aftësisë së Kufizuar.	Numër	DPSHSSH
9	<b>Numri i fëmijëve të shpallur “të braktisur”, me vendim gjykatë.</b>	Numër	Ministria e Drejtësisë (MD)
10	<b>Numri i fëmijëve të birësuar gjatë vitit, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare - Aftësisë së kufizuar/probleme shëndetësore; - Brenda apo jashtë vendit; - Strukturës së familjes; - Qarqeve.	Numër	Komiteti i birësimit/MD
11	<b>Niveli i vdekshmërisë neonatale (deri ditën e 27 të jetës) për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.</b>	Numër për një mijë	INSTAT
12	<b>Vdekshmëria foshnjore (vdekjet e fëmijëve nën moshën 1 vjeç/1000 lindje gjallë), sipas gjinisë.</b>	Numër për një mijë	INSTAT
13	<b>Numri i vdekjeve të fëmijëve deri 1 vjeç, sipas shkakut të vdekjes.</b>	Numër	MSHMS
14	<b>Niveli i vdekshmërisë nën 5 vjeç për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.</b>	Numër për një mijë	INSTAT
15	<b>Niveli i vdekshmërisë amtare në 100,000 lindje të gjalla, sipas grup-moshës.</b>	Numër për një qind mijë	INSTAT/MSHMS
16	<b>Përqindja e lindjeve të asistuara nga staf profesional.</b>	Përqindje	MSHMS
17	<b>Numri dhe përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë sipas gjinisë.</b>	Numër dhe përqindje	MSHMS
18	<b>Incidenca e sëmundjeve tek fëmijët, 0-14 vjeç, sipas:</b> - Sëmundjeve; - Gjinisë; - Grup-moshës.	Numër	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
19	<b>Numri dhe përqindja e grave shtatzëna diagnostikuar me HIV-pozitiv gjatë vitit që përdorin terapi antiretrovirale.</b>	Numër dhe përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
20	<b>Numri dhe përqindja e fëmijëve HIV-pozitiv që përdorin TAR (terapi antiretrovirale), sipas:</b> - Grup-moshës; - Gjinisë.	Numër dhe përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
21	<b>Përqindja e fëmijëve target që vaksinohen siç rekomandohet në kalendarin kombëtar të vaksinimit deri në moshën 1 vjeç, sipas vaksinave përkatëse.</b>	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
22	<b>Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç nën peshë, sipas:</b> - Gjinisë; - Qarqeve;	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS



	- Rezidencës (urbane/rurale).		
23	<b>Përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj,</b> sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
24	<b>Përqindja e foshnjave (6–24 muaj) që ushqehen me gji edhe pas muajit 6,</b> sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
25	<b>Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën,</b> sipas: - Kategorive të prapambetjes; - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
26	<b>Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç mbipeshë,</b> sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	Përqindje	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
27	<b>Numri i vetëvrasjeve të fëmijëve, të regjistruar nga policia,</b> sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
28	<b>Numri i tentativave për vetëvrasje të fëmijëve të regjistruar nga policia,</b> sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
29	<b>Numri i fëmijëve viktimë të trafikimit gjatë vitit, sipas</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit; - Qarqet ku janë identifikuar rastet. <b>Numri i fëmijëve të identifikuar si viktimë trafikimi sipas formave të shfrytëzimit:</b> - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion; - Pornografi; - Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje; - Lypje e detyruar,	Numër	Ministria e Brendshme MB
30	<b>Numri i fëmijëve viktimë të mundshme trafikimi, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit; - Qarqet ku janë identifikuar rastet. <b>Numri i fëmijëve të identifikuar si viktimë të mundshme trafikimi sipas formave të shfrytëzimit:</b>	Numër	MB



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shfrytëzim seksual;</li> <li>- Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara;</li> <li>- Prostitucion;</li> <li>- Pornografi;</li> <li>- Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje;</li> <li>- Lypje e detyruar.</li> </ul>		
31	<p><b>Numri i fëmijëve me status refugjatë, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Vendit të origjinës;</li> <li>- Llojit të mbrojtjes;</li> <li>- Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar).</li> </ul> <p><b>Numri i fëmijëve me status mbrojtjeje plotësuese sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Vendit të origjinës;</li> <li>- Llojit të mbrojtjes;</li> <li>- Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar).</li> </ul>	Numër	Ministria e Brendshme
32	<p><b>Numri i fëmijëve që kanë kërkuar azil në Shqipëri, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Vendit të origjinës;</li> <li>- Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar);</li> </ul>	Numër	Ministria e Brendshme
33	<p><b>Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar/mbështetur nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshave;</li> <li>- Shtetësisë;</li> <li>- Llojit të rastit të menaxhuar;</li> <li>- Statusit të menaxhimit të rastit;</li> <li>- Niveli i rrezikut të rastit;</li> <li>- Bashkive.</li> </ul>	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, bashkitë
34	<p><b>Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojit të masës;</li> <li>- Statusit të aprovimit të masës.</li> </ul>	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/njësitë për mbrojtjen e fëmijëve - bashkitë
35	<p><b>Numri i fëmijëve të riadhesuar, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Bashkive.</li> </ul>	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
36	<p><b>Numri i fëmijëve viktimë të dhunës të regjistruar nga institucionet shëndetësore sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Llojit të dhunës;</li> <li>- Ndarjes gjeografike.</li> </ul>	Numër	MSHMS
37	<p><b>Numri i fëmijëve viktimë të veprave penale regjistruar nga policia, sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Veprës penale;</li> </ul>	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë





	- Përfunduar në vdekje; - Ndarjes gjeografike.		
38	<b>Numri fëmijëve autorë të dyshuar të veprës penale regjistruar nga policia, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Veprës penale; - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
39	<b>Numri i fëmijëve (14–17 vjeç) në paraburgim, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivismit (po/jo); - Kategoritë e masave alternative të marra; - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
40	<b>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) në burg, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivismit (po/jo); - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
41	<b>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të trajtuar nga shërbimi i provës, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të masave të marra; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim; - Statusi menaxhimit të rastit (i ri, i mbartur/në proces, i mbyllur).	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
42	<b>Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria, sipas:</b> - Gjinisë; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të vendimeve të marra; - Masave të sigurisë së marra.	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
43	<b>Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të raportuar nga prokuroria, sipas:</b> - Gjinisë; - Shtetësisë; - Kategorive të dëmit (plagosje lehtë/rëndë/vdekje); - Veprës penale.	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
44	<b>Numri i fëmijëve autorë të dyshuar të veprave penale të trajtuar në gjykatë, sipas:</b> - Gjinisë;	Numër	Ministria e Drejtësisë



	- Procedimeve penale; - Kategorive të vendimeve të marra.		
45	<b>Numri i fëmijëve viktime të veprave penale të trajtuara në gjykatë, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Veprës penale;	Numër	Ministria e Drejtësisë
46	<b>Numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtje në gjykatë si viktime të dhunës në familje, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së urdhrit të mbrojtjes (urdhër mbrojtje/urdhër menjëhershëm mbrojtje).	Numër	Ministria e Drejtësisë
47	<b>Numri i fëmijëve që kanë përfituar ndihmë ligjore falas, sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare - Shtetësisë; - Aftësisë së kufizuar; - Kategorisë së rastit (penale, civile, familjare, administrative).	Numër	Ministria e Drejtësisë
48	<b>Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas:</b> - Shkakut të diskriminimit; - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga Komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive); - Fusha ku pretendohet diskriminimi (punësim, arsim, të mira dhe shërbime).	Numër	Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi
49	<b>Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas:</b> - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive).	Numër	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
50	<b>Numri i ankesave, kërkesave, njoftimeve dhe rasteve me iniciativë, të trajtuara nga Avokati i Popullit me objekt të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, sipas:</b> - Ankesa/kërkesa nga vetë fëmijët; - Ankesa/kërkesa në emër të fëmijëve; - Raste me iniciativë të trajtuara dhe inspektive; - Statusi i trajtimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive).	Numër	Avokati i Popullit
51	<b>Numri i fëmijëve (16–18 vjeç) të punësuar që kanë pësuar aksidente në punë sipas:</b> - Gjinisë; - Grup-moshës; - Industrisë; - Llojit të punës që punonin.	Numër	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
52	<b>Numri i fëmijëve punëmarrës raportuar nga</b>		Ministria e Financave dhe



	<b>Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, sipas</b> - Grup-moshës; - Gjinisë; - Shtetësisë; - Nivelit arsimor; - Përshkrimit të proceseve të punës; - Kohëzgjatjes së pushimit vjetor (ditë); - Kohëzgjatjes ditore e punës; - Kohëzgjatjes javore të punës; - Numri i fëmijëve të punësuar me kontrata individuale të punës; - Numri i fëmijëve të siguruar. <b>Numri i fëmijëve nën 18 vjeç të konstatuar në punë të vështira dhe të rrezikshme.</b> <b>Numri i fëmijëve nën 18 vjeç të konstatuar në punë nate.</b>		Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
53	<b>Numri i fëmijëve 0–3 vjeç që shkojnë në çerdhe, sipas:</b> - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Sektor publik/privat; - Bashkive.	Numër	Bashkitë
54	<b>Përqindja e fëmijëve 3–6 vjeç të regjistruar në kopsht në krahasim me numrin total të fëmijëve 3–6 vjeç, sipas:</b> - Gjinisë; - Moshës.	Përqindje	INSTAT/Ministria e Arsimit dhe Sportit
55	<b>Përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin total të fëmijëve 6 vjeç sipas gjinisë.</b>	Përqindje	INSTAT/Ministria e Arsimit dhe Sportit/ njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar
56	<b>GER dhe NER sipas ciklit të studimit/arsimit dhe gjinisë (indeksi i barazisë gjinore).</b>	Përqindje	INSTAT/MAS
57	<b>Përqindja e braktisjes shkollore, sipas:</b> - Gjinisë; - Nivelit arsimor; - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	Përqindje	MAS/Njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar
58	<b>Përqindja e nxënësve përsëritës, sipas nivelit:</b> - Nivelit arsimor; - Gjinisë; - Aftësisë së kufizuar; - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	Përqindje	MAS/Njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar
59	<b>Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi sipas:</b> - Bashkisë ku është identifikuar rasti; - Bashkisë ku jeton rasti i identifikuar (nëse është ndryshe nga bashkia ku rasti është identifikuar); - Moshës; - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; <b>Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi sipas formave të shfrytëzimit:</b> - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion;	Numër	Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pornografi;</li> <li>- Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje;</li> <li>- Lypje e detyruar.</li> </ul> <p><b>Numri i fëmijëve sipas nivelit të rrezikut</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- I menjëhershëm;</li> <li>- I lartë;</li> <li>- Mesatar;</li> <li>- I ulët.</li> </ul> <p><b>Numri i fëmijëve, për të cilët është marrë një masë mbrojtjeje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Masë emergjente mbrojtjeje;</li> <li>- Mbikëqyrje e specializuar në mjedisin familjar;</li> <li>- Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative (të afërm; institucione rezidencial/strehëz).</li> </ul>		
60	<p><b>Numri i fëmijëve viktime trafikimi sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkisë ku është identifikuar rasti/</li> <li>- Bashkisë ku jeton rasti i identifikuar (nëse është ndryshe nga bashkia ku rasti është identifikuar);</li> <li>- Moshës;</li> <li>- Gjinisë;</li> <li>- Përkatësisë në një pakicë kombëtare.</li> </ul> <p><b>Formave të shfrytëzimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shfrytëzim seksual;</li> <li>- Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara;</li> <li>- Prostitucion;</li> <li>- Pornografi;</li> <li>- Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje;</li> <li>- Lypje e detyruar.</li> </ul> <p><b>Numri i fëmijëve, për të cilët është marrë një masë mbrojtjeje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Masë emergjente mbrojtjeje;</li> <li>- Mbikëqyrje e specializuar në mjedisin familjar;</li> <li>- Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative (të afërm; institucione rezidencial/strehëz).</li> </ul>	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijës në bashki
61	<p><b>Numri i fëmijëve të pashoqëruar sipas:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinisë,</li> <li>- Grup-moshës;</li> <li>- Përkatësisë në një pakicë kombëtare;</li> <li>- Shtetësisë;</li> <li>- Qarqeve.</li> </ul>	Numër	Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Ministria e Brendshme.



## UDHËZIM

Nr. 21, datë 27.6.2022

**PËR KUALIFIKIMIN E VAZHDUAR  
PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE  
TË KULTURËS PROFESIONALE NË  
ARSIMIN DHE FORMIMIN  
PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 62 të udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të AFP, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,

UDHËZOJ:

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1  
Të përgjithshme**

1. Organizimi i kualifikimit të vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional (AFP) do të bëhet në përputhje me përgjegjësitë, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Procesi i kualifikimit të vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në AFP bazohet në parimet e meritës, transparencës, barazisë, korrektesisë, paanshmërisë, fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

## KREU II

**PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE  
PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË  
VAZHDUAR PROFESIONAL TË  
MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS  
PROFESIONALE NË AFP**

Neni 2

**Shkallët e kualifikimit të mësimitdhënësve të  
kulturës profesionale dhe kandidatët për  
kualifikim**

1. Kualifikimi i vazhduar (atestimi) i mësimitdhënësve të kulturës profesionale, me kohë të plotë, realizohet me tri kategori (shkallë) kualifikimi, nga më e ulëta tek më e larta:

- kategoria e kualifikimit me titull “Mësues i kualifikuar”;
- kategoria e kualifikimit me titull “Mësues specialist”;
- kategoria e kualifikimit me titull “Mësues mjeshtr”.

2. Pas emërimit me kontratë pa afat, deri në marrjen e kategorisë, “Mësues i kualifikuar”, mësimitdhënësit e kulturës profesionale, me kohë të plotë, mbajnë titullin “Mësues”.

3. Mësimitdhënësit e kulturës profesionale, të cilët kryejnë procedurat për fitimin e kualifikimit për një kategori më të lartë se ajo që zotërojnë, konsiderohen “kandidatë” për kualifikim.

4. Në institucionet ofruese të AFP-së, mësimitdhënësit kandidatë për kualifikim ndahen në dy grupe:

a) Grupi A: Mësimitdhënësit e kulturës profesionale (teorike dhe/ose praktike), me kohë të plotë, të cilët kanë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlerëshëm, në fushat profesionale përkatëse.

b) Grupi B: Mësimitdhënësit e praktikës profesionale, me kohë të plotë, të cilët kanë shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit *Bachelor*, në fushat profesionale përkatëse.

Neni 3

**Kërkesat për fitimin e kualifikimit**

1. Për të fituar një kualifikim të një kategorie më të lartë, kandidati duhet të plotësojë këto kërkesa:



a) të plotësojë portofolin (dosjen) e kualifikimit, sipas kritereve të përcaktuara;

b) të kryejë çdo vit, të paktën 18 orë (1 kredit) trajnime të akredituara nga AKAFPK-ja ose të njohura nga AKAFPK-ja.

c) të kryejë me sukses provimin e kualifikimit përkatës.

Neni 4

#### **Kërkesa dhe pranimi i kandidatëve në kualifikim**

1. Procedura për fitimin e kategorive të kualifikimit (atestimit) nga mësimdhënësit e kulturës profesionale kryhet çdo vit kalendarik, në periudhën 1 janar–15 korrik.

2. Në procedurën për fitimin e kategorive të kualifikimit pranohen të gjithë kandidatët që janë të punësuar si mësimdhënës me kontratë pa afat, me kohë të plotë, në një ofrues të AFP-së dhe, që, sipas pikës 4, shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 2, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kriteret e mëposhtme për vjetërsinë e punës me kohë të plotë, si mësimdhënës të kulturës profesionale në AFP.

a) të paktën 5 vjet punë, për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”;

b) të paktën 10 vjet punë, për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist”, si dhe të paktën 5 vjet pas marrjes së kategorisë së kualifikimit “Mësuesi i kualifikuar”;

c) të paktën 20 vjet, punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtrë”, si dhe të paktën 10 vjet pas marrjes së kategorisë së kualifikimit “Mësues specialist”.

3. Mësimdhënësit e kulturës profesionale, të cilët plotësojnë kriteret për fitimin e një kategorie kualifikimi më të lartë se ajo që zotërojnë, duhet të paraqesin në drejtorinë e ofruesit të AFP-së përkatëse, në periudhën 1–31 tetor, kërkesë me shkrim për të kryer kualifikimin përkatës, në vitin pasardhës.

4. Çdo drejtori e ofruesve të AFP, pasi verifikon kërkesat, duhet të dërgojë zyrtarisht në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), deri në 20 nëntor, listën emërore, kategoritë e kualifikimit, për të cilat kërkojnë atestimin, të dhënat për vitet e punës dhe kontaktet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe që plotësojnë kushtet.

5. AKPA-ja, pasi vlerëson dokumentacionin e dërguar nga ofruesit e AFP-së, dërgon zyrtarisht në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), deri në 15 dhjetor, listën emërore dhe kontaktet e kandidatëve, të ndara sipas grupeve (pika 4 e nenit 2) dhe kategorive të kualifikimit (pika 1 e nenit 2), për të cilat ata aplikojnë.

6. AKAFPK-ja, deri në 31 dhjetor, njofton (me *e-mail*) të gjithë kandidatët për fillimin e procedurës së kualifikimit, për hapat që duhet të ndjekin, adresën zyrtare ku duhet të dërgojnë dokumentet dhe afatet përkatëse.

### KREU III

#### **PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PORTOFOLIN E KUALIFIKIMIT**

Neni 5

#### **Përmbajtja e portofolit të kualifikimit**

1. Portofoli i çdo mësimdhënësi të kulturës profesionale, kandidat për çfarëdo kategori kualifikimi, përbëhet nga dy pjesë:

a) pjesa me të dhënat personale;

b) pjesa me përmbajtje profesionale.

2. I gjithë dokumentacioni i portofolit të kualifikimit përgatitet nga kandidati në format elektronik (pdf) dhe dërgohet me *e-mail*, në adresën [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), dhe brenda afatit të përcaktuar nga AKAFPK-ja, në njoftimin e dhënë, sipas pikës 6 të nenit.

3. Pjesa e portofolit me të dhënat personale të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara):

a) jetëshkrimin në gjuhën shqipe, sipas formatit të *Europass* (shtojca 1);

b) certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera, me kreditet e fituara (të paktën 5 kredite për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”, si dhe të paktën 10 kredite për kategorinë “Mësues mjeshtrë”), sipas pikës 1.b të nenit 4;

c) certifikatat e trajnimeve të tjera, që lidhen me mësimdhënien ose profesionin, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit (nëse ka);

d) vërtetime që tregojnë se kandidati është bashkëpunëtor (specialist i jashtëm me kontratë) i AKAFPK-së (nëse është);



e) dëshmitë e titujve/gradave shkencore të fituara (nëse ka);

f) vërtetimin, nëse ka kryer, në periudhën e dy vjetëve të fundit, të paktën 3 (tri) ditë stazh (praktikë) në fushën profesionale përkatëse, në një institucion publik apo biznes privat. Vërtetimi duhet të jetë i vulosur e firmosur nga drejtori i ofruesit dhe nga përfaqësuesi i institucionit/biznesit;

g) dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja (nëse ka).

4. Pjesa me përmbajtje profesionale e portofolit të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara), ku evidentohet edhe emri e mbiemri i kandidatit:

a) planin e mësimdhënies të një lënde teorike profesionale ose të një moduli të praktikës profesionale, që e jep mësim.

b) plan-ditarin e një seance mësimore teorike, bazuar në mësimdhënien me prezencë fizike dhe atë *online*, ose plan-ditarin e një seance mësimore praktike me prezencë fizike;

c) formulimin e një objektiwi mësimor specifik, teorik ose praktik;

d) një instrument për vlerësimin e njohurive ose shprehive të nxënësve apo kursantëve (test teorik me të paktën 5 njësi testi të ndryshme ose listë kontrolli për shprehitë praktike me të paktën 5 kriterë vlerësimi);

e) një material mësimor për nxënësit/kursantët, për një çështje teorike (një faqe A4) ose një udhëzues pune për një aftësi praktike.

f) një prezantim (në *PowerPoint*) për një çështje teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde).

5. Dokumentet e listuar në pikën 3, shkronja “a”, “d”, “b”, të nenit 5, si dhe në pikën 4, të nenit 5, janë dokumente të detyrueshme, mungesa e të paktën njërit prej tyre e përjashton kandidatin nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.

6. AKAFPK-ja, pas përfundimit të afatit të marrjes së dokumenteve të portofolit, shqyrton dokumentacionin dhe informon individualisht kandidatët (nëpërmjet adresës së *e-mail*: [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), nëse janë të plota apo është nevoja për plotësime të mundshme.

7. Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dërgojnë me *e-mail*: [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), në adresën përkatëse të AKAFPK-së, dokumentacionin e munguar brenda 5 ditëve pune nga

marrja e njoftimit, në të kundërt, përjashtohen nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.

Neni 6

### Vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe ankimi

1. Vlerësimi i portofolit të çdo kandidati bëhet nga “Komisioni për kualifikimin e mësimdhënësve të AFP” (KKM), i ngritur me urdhër të brendshëm nga drejtori i përgjithshëm i AKAFPK-së.

2. KKM-ja shqyrton dhe vlerëson me pikë të gjitha dokumentet e portofolit të kandidatit, sipas rubrikave dhe kriterëve të treguara në “Skemën e vlerësimit të portofolit” të shtojca 2.

3. Portofoli i kandidatit vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4. Kandidati që fiton më pak se 25 pikë për portofolin përjashtohet nga procedura e mëtejshme për kualifikim.

5. Kandidatët njoftohen me *e-mail*, për pikët e fituara nga vlerësimi i portofolit.

6. Kandidatët mund të ankohen për rezultatin e vlerësimit të portofolit, duke dërguar ankesën me *e-mail*, në adresën përkatëse të AKAFPK-së, [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), brenda 3 ditë pune nga njoftimi për pikët e fituara.

7. KKM-ja, brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton kandidatët për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të portofolit.

8. KKM-ja protokollon rezultatet e vlerësimeve për portofolat e kandidatëve, si dhe rezultatet përfundimtare pas ankimeve.

### KREU IV

### PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR TRAJNIMET E AKREDITUARA TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP-së

Neni 7

### Programet e kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP

1. AKAFPK-ja harton dhe publikon në faqen zyrtare çdo vit, deri në 30 nëntor, programet e kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale të AFP-së për vitin pasardhës, sipas grupeve (pika 4 e nenit 2).



2. Çdo program kualifikimi, bazohet te standardet e mësimdhënësit të AFP-së, përmban njohuritë dhe aftësitë bazë, që duhet të zotërojë mësimdhënësi i kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së, si dhe referencat e burimet përkatëse.

3. Përgatitja e mësimdhënësve të kulturës profesionale për kualifikimin, përmbajtja e trajnimeve të akredituara dhe kërkesat e testit të provimit të kualifikimit duhet t'i referohen programit të kualifikimit përkatës.

Neni 8

### Trajnimet e akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. Trajnime të akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP konsiderohen ato trajnime, që janë akredituar nga Komisioni Kualifikimit Mësimdhënësve (KKM) dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AKAFPK-së.

2. Duke filluar nga data e miratimit të këtij udhëzimi, trajnime të akredituara për mësimdhënësit e AFP-së do të konsiderohen edhe ato trajnime që janë akredituar nga “Komisioni i akreditimit të programeve dhe trajnimeve (KAPT)”, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), por që janë të publikuara në faqen e zyrtare të AKAFPK-së.

3. KKM-ja publikon në faqen zyrtare të AKAFPK-së kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë ofruesit e trajnimeve për të akredituar trajnimet për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP.

4. Ofruesit e trajnimeve dërgojnë me *e-mail*, në adresën përkatëse të AKAFPK-së, kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar për akreditim të trajnimeve, në format elektronik (pdf).

5. Kërkuesi duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar për akreditim, si më poshtë:

a) kërkesën për akreditim të ofruesit të trajnimeve (shtojca 3);

b) të dhënat e ofruesit (emërtimi i subjektit, emri i përfaqësuesit juridik, adresa e postës elektronike, numri i telefonit, linku i faqes së internetit);

c) dokumentacioni juridik (sipas rastit: ekstrakt nga QKB, vendim gjykate, vendim i Këshillit të Ministrave, NIPT, statut, akt pronësie ose marrje me qira për objektin ku kryhet trajnimi);

d) dokumentacioni i programit të trajnimit (titulli, objektivat, temat/modulet, kohëzgjatja

(kreditet), metodologjitë e realizimit, formati i realizimit: i drejtpërdrejtë apo *online*);

e) dokumentacioni për shkallën e kualifikimit të trajnerëve (jetëshkrimi, diploma, kualifikime shtesë);

f) dokumentacioni për infrastrukturën fizike dhe didaktike të realizimit të trajnimit (kushtet e mjedisit të trajnimit, mjetet didaktike).

6. Dokumentacioni i dërguar për akreditimin e trajnimit, shqyrtohet nga KKM-ja brenda 10 ditëve pune;

7. Pasi shqyrton dokumentacionin për akreditimin e trajnimit, KKM-ja njofton me *e-mail* aplikuesin, nëse trajnimi i plotëson ose jo kriteret për akreditim (së bashku me arsyet përse nuk i plotëson kriteret).

8. Aplikuesi për akreditimin e trajnimit, nëse nuk akreditohet, mund të ankohet te KKM-ja, me *e-mail*, brenda 3 ditëve pune nga marrja e njoftimit (te shtohet zyrtarisht).

9. KKM-ja, pasi shqyrton ankesën, merr vendimin përfundimtar dhe njofton aplikuesin me *e-mail*, brenda 5 ditëve pune nga marrja e ankesës.

10. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së akreditimit të trajnimit është 5 vjet.

11. Vendimi i KKM-së për akreditimin e trajnimit i përcillet zyrtarisht drejtorit të përgjithshëm të AKAFPK-së.

12. Drejtori i përgjithshëm i AKAFPK-së i lëshon ofruesit të trajnimit që akreditohet, “Certifikatën e akreditimit të trajnimit” (shtojca 4), e cila përmban kodin, datën dhe kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit, të dhënat që identifikojnë ofruesin e trajnimit dhe të dhënat për programin e trajnimit (titullin, vlerën e krediteve, emërtimin dhe kohëzgjatjen e temave/moduleve të trajnimit).

13. AKAFPK-ja publikon në faqen zyrtare listën e trajnimeve të akredituara, si dhe informacionin bazë për çdo trajnim (kodin e akreditimit, vlefshmërinë, kontaktet e ofruesit, titullin e trajnimit, vlerën e krediteve, temat/modulet e trajnimit dhe kohëzgjatjet).

14. KKM-ja mban procesverbal për shqyrtimin e aplikimit për akreditimin e trajnimit, si dhe për vendimin që i përcjell drejtorit të përgjithshëm të AKAFPK-së.





15. Personat, që angazhohen në procesin e akreditimit të trajnimeve për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit

Neni 9

### **Përzgjedhja dhe realizimi i trajnimeve të akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP**

1. Mësimdhënësit e kulturës profesionale, duke filluar nga data e miratimit të këtij udhëzimi, bazuar në nevojat individuale për trajnim dhe në rekomandimet e Njesisë së Zhvillimit të ofruesit të AFP-së, mund të përzgjedhin trajnimin/trajnimet që dëshirojnë të ndjekin, vetëm nga lista e trajnimeve të akredituara, të publikuar në faqen zyrtare të AKAFPK-së.

2. Mësimdhënësve të kulturës profesionale, të cilët kanë kryer trajnime të akredituara nga KAPT-ja e MAS-së, para datës së miratimit të këtij udhëzimi, do t'u njihen certifikatat dhe kreditet e fituara nga këto trajnime.

3. Mësimdhënësit kontaktojnë ofruesit e trajnimeve të akredituara dhe marrin informacionet e nevojshme për modalitetet e pjesëmarrjes në trajnimet që ofrojnë (përfshirë dhe tarifën e pjesëmarrjes, nëse ka).

4. Shpenzimet e pjesëmarrjes në trajnimet e akredituara përballohen nga pagesat e vetë pjesëmarrësve ose nga burime të tjera të ligjshme.

5. Mësimdhënësit e kulturës profesionale nuk mund të akumulojnë kredite nga i njëjti trajnim i akredituar, të cilin e kryejnë dy apo më shumë herë.

6. Ofruesi i trajnimit të akredituar duhet të njoftojë me *e-mail* në adresën zyrtare të AKAFPK-së: [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), jo më pak se 10 ditë pune para fillimit të trajnimit, për titullin, datat, oraret, vendin dhe/ose formatin e trajnimit, trajnerin/trajnerët dhe listën e pjesëmarrësve në trajnim.

7. Monitorues nga AKAFPK-ja, të cilët caktohen me urdhër të drejtuesit të AKAFPK-së, të monitorojnë realizimin e trajnimit të akredituar (procesin dhe dokumentacionin) dhe përgatitin raportin e monitorimit për drejtorin e përgjithshëm të AKAFPK-së.

8. Nëse gjatë monitorimit evidentohen shmangie të theksuara nga kërkesat dhe kriteret për trajnimin e akredituar, drejtori i përgjithshëm i

AKAFPK-së merr vendimin për anulimin e trajnimit, anulimin e akreditimit për këtë trajnim dhe heqjen nga lista e trajnimeve të akredituara.

9. Pas përfundimit të trajnimit të akredituar, ofruesi i trajnimit dërgon me *e-mail*, në adresën zyrtare të AKAFPK-së: [info@akafp.gov.al](mailto:info@akafp.gov.al), listën e mësimdhënësve që e përfundojnë me sukses trajnimin përkatës.

10. Ofruesi i trajnimit të akredituar i pajis pjesëmarrësit e suksesshëm në trajnim me certifikatën e trajnimit, e cila përmban emrin dhe mbiemrin e pjesëmarrësit, datat dhe kohëzgjatjen e trajnimit, të dhënat për programin e trajnimit (titullin, kodin, vlerën e krediteve, emërtimin dhe kohëzgjatjen e temave/moduleve), të dhënat për ofruesin e trajnimit (logon, firmën, vulën, nëse ka).

## KREU V

### **PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PROVIMET E KUALIFIKIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP**

Neni 10

### **Testet e provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP**

1. Provimet e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP zhvillohen me teste me shkrim.

2. Format, rubrikat, numri i njësive, pikëzimi dhe detaje të tjera të testeve të provimeve të kualifikimit përcaktohen nga KKM-ja dhe publikohen në faqen zyrtare të AKAFPK-së.

3. Testet e provimeve të kualifikimit përgatiten çdo vit, të veçanta, sipas grupeve (pika 4 e nenit 2).

4. AKAFPK-ja i përgatit testet e provimeve të kualifikimit me grupe bashkëpunëtorësh, specialistë me kontratë, të cilët përzgjidhen nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur.

5. Përgatitja, printimi dhe ruajtja e testeve të provimeve të kualifikimeve bëhet në përputhje me rregullat e fshehtësisë, të cilat përcaktohen me rregullore AKAFPK-së.

6. Personat që angazhohen në përgatitjen, printimin dhe ruajtjen e testeve të provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.



## Neni 11

**Administrimi i provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP**

1. AKAFPK-ja është përgjegjëse për procesin e administrimit dhe të mbikëqyrjes së provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP.

2. Provimet e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP kryhen çdo vit kalendarik, deri në 5 korrik.

3. AKAFPK-ja publikon në faqen zyrtare njoftimin për provimin e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, jo më pak se 10 ditë pune para datës së provimit.

4. Njoftimi për provimin e kualifikimit përmban listën e mësimdhënësve të grupit dhe kategorisë përkatëse që do të kryejnë provimin, datën, orën, kohëzgjatjen dhe vendin ku do të zhvillohet provimi, si dhe informacione të tjera.

5. Mësimdhënësit pjesëmarrës në provim paraqiten në mjedisin e provimit, me dokument identifikimi, të paktën 30 minuta para fillimit të provimit.

6. Para fillimit të provimit, administratorët e provimit u shpjegojnë pjesëmarrësve procedurat dhe rregullat e provimit.

7. Regjistrimi i pjesëmarrësve në provim, shpërndarja e testeve, mbledhja e testeve të plotësuara dhe ruajtja e tyre bëhet në përputhje me rregullat e fshehtësisë (sekretimit).

8. Provimi i kualifikimit zhvillohet në mjedise që plotësojnë kushte të përshtatshme (hapësirat, ndriçimi, temperatura, zhurmat), që mundësojnë zhvillimin korrekt të provimit dhe me distancën e nevojshme midis pjesëmarrësve.

9. Gjatë zhvillimit të provimit, nuk lejohet komunikimi midis pjesëmarrësve dhe përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit.

10. Për pjesëmarrësit në provim, që shkelin në mënyrë të dukshme rregullat e zhvillimit të provimit, administratorët e provimit vendosin përjashtimin nga provimi.

11. Në një mjedis provimi, nuk lejohet të zhvillojnë njëkohësisht provimin e kualifikimit më shumë se 15 mësimdhënës.

12. Nëse numri i mësimdhënësve në provimin e kualifikimit është më i madh se 15, bëhet ndarja në grupe dhe provimi zhvillohet në të njëjtën kohë në dy apo më shumë mjedise provimi.

13. Kohëzgjatja maksimale e provimit të kualifikimit është 1 orë e 30 minuta.

14. Në përfundim të provimit, administratorët e provimit plotësojnë procesverbalin e provimit, ku evidentohen aspektet kryesore të zhvillimit të provimit.

15. Punonjësit e AKAFPK-së, që angazhohen në procesin e administrimit dhe mbikëqyrjes së provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.

## Neni 12

**Vlerësimi i testeve të provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP dhe ankimi**

1. Vlerësimi i testeve të plotësuara nga pjesëmarrësit në provimin e kualifikimit bëhet nga KKM, brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i provimit të kualifikimit.

2. AKAFPK-ja njofton individualisht me *e-mail* pjesëmarrësit lidhur me rezultatet e provimit të kualifikimit.

3. Çdo test, vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4. Pjesëmarrësi në provim që fiton më pak se 25 pikë në testin e kualifikimit konsiderohet jofitues i provimit.

5. Pjesëmarrësit në provim mund të ankohen për rezultatin e vlerësimit të testit të kualifikimit, duke dërguar ankesën me *e-mail* dhe/apo me shkresë, në adresën përkatëse të AKAFPK-së, brenda 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit.

6. KKM-ja, brenda 3 ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton pjesëmarrësit për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të testit.

7. Pjesëmarrësi në provim, i cili vlerësohet me më pak se 25 pikë në provim dhe shpallet jofitues i provimit të kualifikimit, nuk fiton kualifikimin përkatës, por ka të drejtë të rifutet në provim në vitet pasardhëse.

8. KKM-ja mban procesverbal për rezultatet e vlerësimeve të testeve, si dhe rezultatet përfundimtare të testeve, pas ankimeve.

9. Personat që angazhohen në procesin e vlerësimit të testeve të provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit



KREU V  
VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I  
KUALIFIKIMIT TË VAZHDUAR  
PROFESIONAL DHE CERTIFIKIMI I  
MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS  
PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP-së

Neni 13

**Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit për  
mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP**

1. Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit të kandidatëve, mësimdhënës të kulturës profesionale në AFP, bëhet nga KKM-ja.

2. Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit të kandidatëve bëhet me sistemin e 100 pikëve, nga të cilat maksimalisht 50 pikë fitohen nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe maksimalisht 50 pikë fitohen nga provimi i kualifikimit përkatës.

3. Totali i pikëve të fituara nga kandidati në kualifikim llogaritet si shuma e pikëve të fituara nga portofoli i kualifikimit dhe e pikëve të fituara nga provimi i kualifikimit.

4. Kandidatit që nuk plotëson dokumentacionin e detyrueshëm të portofolit të kualifikimit ose fiton më pak se 25 pikë me portofolin e kualifikimit, nuk i llogaritet shuma e pikëve dhe nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.

5. Kandidatit që fiton më pak se 25 pikë në provimin e kualifikimit, nuk i llogaritet shuma e pikëve dhe nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.

6. Referuar shumës së pikëve të fituara në kualifikim, kandidatët vlerësohen me 5 (pesë) shkallë: A, B, C, D, E që i korrespondojnë përkatësisht vlerësimeve me fjalët “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët”, sipas Skemës së shkallëve të vlerësimit në shtojcën 5.

7. Nëse shuma e pikëve të fituara në kualifikim është më e vogël se 50 pikë, vlerësimi përfundimtar është “Dobët” (shkalla “E”) dhe kandidati nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.

8. AKAFPK-ja njofton individualisht me *e-mail* kandidatët pjesëmarrës në kualifikim për rezultatet e vlerësimit të kualifikimit të kryer prej tyre.

9. Kandidatët pjesëmarrës në kualifikim mund të ankohen për rezultatit e vlerësimit të kualifikimit, duke dërguar ankesën me *e-mail*, në adresën zyrtare të AKAFPK-së, brenda 3 ditë pune

nga shpallja e rezultatit.

10. KKM-ja, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton kandidatët për rezultatit përfundimtar të vlerësimit të kualifikimit për kategorinë përkatëse.

11. Kandidati pjesëmarrës në kualifikim që kërkon të përmirësojë rezultatit e kualifikimit (shkallën e arritur), mund t'i bëjë kërkesë (me *e-mail*) AKAFPK-së, për t'u rifitur në provimin e kualifikimit vetëm vitin e ardhshëm dhe në këtë rast, për vlerësimin përfundimtar, do të llogariten pikët e fituara në riprovim.

12. Pas vlerësimit përfundimtar të kandidatëve pjesëmarrës në kualifikim, AKAFPK-ja dërgon zyrtarisht në AKPA listën emërore të mësimdhënësve pjesëmarrës në kualifikim, kategoritë e kualifikimit të fituara dhe shkallët e vlerësimeve të arritura.

13. Personat që angazhohen në procesin e vlerësimit përfundimtar të kualifikimeve për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.

Neni 14

**Certifikimi i kualifikimit për mësimdhënësit  
e kulturës profesionale në AFP**

1. AKAFPK-ja, brenda 10 ditë pune nga shpallja e rezultateve përfundimtare të kualifikimit, bën certifikimin e kandidatëve, që kanë kryer me sukses të gjithë procedurën e kualifikimit (atestimit) për kategorinë përkatëse.

2. AKAFPK-ja prodhon certifikatat e kualifikimit për të gjithë kandidatët, që kanë fituar kategorinë përkatëse të kualifikimit.

3. Certifikata e kualifikimit duhet të përmbajë këto të dhëna: logon e AKAFPK-së, numrin e regjistrimit të certifikatës, emrin dhe mbiemrin e mësimdhënësit, kategorinë e kualifikimit të fituar, shkallën e vlerësimit me shkronjë, të shoqëruar me përshkrim, datën e certifikimit, emrin dhe firmën e drejtorit të përgjithshëm, si dhe vulën e AKAFPK-së.

4. AKAFPK-ja dërgon me postë certifikatat e plotësuara, në adresat e ofruesve të AFP-së ku mësimdhënësit janë të punësuar.

5. AKAFPK-ja dërgon në AKPA-ja listën përfundimtare të mësimdhënësve të kulturës profesionale, së bashku me rezultatet/kategorinë e kualifikimit përkatës të fituar.



6. AKAFPK-ja mban regjistrin e certifikatave të kualifikimit, të fituara nga mësime të kulturës profesionale të AFP, pas miratimit të këtij udhëzimi.

#### KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

#### Ruajtja e dokumentacionit të kualifikimit të mësimeve të kulturës profesionale në AFP

1. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në arkivat e institucioneve përkatëse, AKAFPK-së, AKPA-së dhe ofruesit e AFP-së, në përputhje me ligjin për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

2. Dokumentacioni në format elektronik ruhet në arkivin elektronik të institucioneve përkatëse.

3. Për certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera, sipas neni 5 pika 3/b, vetëm për kategorinë “Mësues mjeshtrë”, duhen:

a) të paktën 7 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2022;

b) të paktën 8 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2023;

c) të paktën 9 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2024.

Neni 16

#### Dispozita kalimtare

1. Afatet kohore për procedurat e kualifikimit që përcaktohen në këtë udhëzim, u referohen kualifikimeve të mësimeve, duke filluar nga vitit 2023 e në vijim.

2. Për afatet kohore që lidhen me kualifikimet e mësimeve për vitin 2022, AKAFPK-ja informon shkollat profesionale me anë të një udhëzuesi të posaçëm.

Neni 17

#### Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe e Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ofruesit e AFP-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ë Fletoren Zyrtare

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**

#### SHTOJCA 1 FORMATI I JETËSHKRIMIT

<b>Europass Curriculum Vitae</b>	Vendosni fotografinë.
<b>Informacion personal</b>	<b>Emri Mbiemri</b>
Emri/Mbiemri	Numri i shtëpisë/apartamentit, emri i rrugës, kodi postar, qyteti, shteti
Adresa	Fiks: Celular:
Telefoni/at	
Fax	
E-mail	
Shtetësia	
Data e lindjes	
Gjinia	
<b>Punësimi i dëshiruar/ Fusha e punësimit</b>	

**Eksperiencat e punësimit**

Vendosni dhe shtoni informacione të veçanta për secilën punë të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit.

Data  
Roli ose pozicioni i punës  
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë  
Emri dhe adresa e punëdhënësit  
Lloji i biznesit ose sektori

**Arsimi dhe trajnimet**

Vendosni informacione të veçanta për secilin kurs apo trajnim të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit.

Data  
Titulli i kualifikimit të arritur  
Temat kryesore/ aftësitë e mbuluara nga edukimi/ trajnimi  
Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin  
Niveli në klasifikimin kombëtar ose ndërkombëtar

(Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

**Aftësitë personale dhe kompetencat**

Gjuha e nënës

**Përcaktoni gjuhën e nënës** (shtoni një gjuhë të dytë nëse keni gjuhë nëne tjetër, shihni udhëzimet)

Gjuhë të tjera  
Vetë vlerësimi  
Niveli European (\*)

**Gjuha  
Gjuha**

Të kuptuarit		Të folurit		Të shkruarit	
Dëgjim	Lexim	Ndërveprim folës	Prodhim folës		

(\*) *Korniza evropiane e përbashkët e referimit për gubët*

Aftësi sociale dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Aftësi organizative dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Aftësi teknike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Aftësi kompjuterike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Aftësi artistike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Aftësi të tjera dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato. (Hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet.)

Leje drejtimi

Përcaktoni këtu nëse posedoni një leje drejtimi automjeti të vlefshme dhe për cilën kategori automjetesh. (Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet.)

**Informacion shtesë**

Shtoni këtu çdo informacion tjetër që mund të jetë i vlefshëm, si p.sh.; persona kontakti, referenca, etj. (Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet.)

**Aneksë**

Listoni materiale ose dokumente të bashkangjitura me CV-në. (Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet.)



**SHTOJCA 2**  
**SKEMA E VLERËSIMIT TË PORTOFOLIT TË KUALIFIKIMIT**  
**TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË AFP**

**Tabela 1: Llogaritja e pikëve nga elementet e portofolit të kandidatit**

Nr.	Elementi i portofolit	Kriteret e vlerësimit	Pikët për çdo kriter	Pikët maksimale
1	Plan i mësimdhënies së lëndës teorike ose modulit praktik	Rubrikat e planit të mësimdhënies sipas formatit	1÷2	10
		Përmbajtjet në koherencë me programin e lëndës ose përshkrujesin e modulit	1÷4	
		Variacion metodash dhe në koherencë me përmbajtjet	1÷4	
2	Plan-ditar i një seance teorike ose praktike	Rubrikat e plan-ditarit janë të plota	1÷2	9
		Fazat e mësimin sipas parimeve didaktike	1÷4	
		Variacion metodash në koherencë me përmbajtjet	1÷3	
3	Formulim i një objektivi mësimor specifik, teorik ose praktik	Objektivi i plotë, me të tria elementet	1	2
		Elementet e objektivit në koherencë me njëri-tjetrin	1	
4	Test teorik (jo më pak se 5 njësi) ose listë kontrolli (jo më pak se 5 kriteret vlerësimi)	Testi me 5 njësi/lista e kontrollit me 5 kriteret	1	6
		Variacion i njësive të testit/koherencë e kriterëve të listës	1÷2	
		Njësitë e testit janë korrekte/kriteret e listës të formuluar drejt	1÷3	
5	Material mësimor teorik (1 f. A4) ose udhëzues pune për aftësi praktike	Formati i materialit mësimor/struktura e udhëzuesit	1	5
		Ilustrimet e materialit mësimor/renditja e hapave të udhëzuesit	1÷2	
		Përmbajtja e materialit mësimor/ përmbajtja e udhëzuesit	1÷2	
6	Prezantim në <i>PowerPoint</i> për aspekte teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde)	Formati, ilustrimet, efektet e prezantimit	1÷2	4
		Përmbajtja e prezantimit	1÷2	
7	Trajtime të akredituara (shitesë) ose të pa-akredituara, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit	Trajtime me kohëzgjatje 6–18 orë	4	6
		Trajtime me kohëzgjatje 6–30 orë	5	
		Trajtime me kohëzgjatje më shumë se 30 orë	6	
8	Dëshmi të gjuhëve të huaja (të mbrojtura në IAL ose në teste ndërkombëtare)	Një gjuhë e huaj	4	8
		Dy gjuhë të huaja	6	
		Më shumë se dy gjuhë të huaja	8	
<b>Pikët maksimale</b>				<b>50</b>

**Tabela 2: Pikë shtesë (bonuse)**

Nr.	Elementi i portofolit	Kriteret e vlerësimit	Pikët për çdo kriter	Pikët maksimale
1	Tituj/gradat shkencore	Doktor	2	4
		Profesor i asociuar	3	
		Profesor	4	
2	Bashkëpunëtor (specialist me kontratë) i AKAFPK-së	Të paktën një kontratë me AKAFPK	2	2
3	Stazh (praktikë) në një institucion ose biznes, në fushën profesionale përkatëse	Të paktën 3 ditë stazh (praktikë), në dy vitet e fundit	4	4

**Shënime:**

- Pikët maksimale që fitohen nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit (tabela 1), janë 50 pikë.
- Kur kandidati nuk i plotëson pikët maksimale (50 pikë) nga vlerësimi i portofolit (tabela 1), mund të fitojë pikë shtesë (bonuse) nëse plotëson kriteret e tabelës 2. Shuma e pikëve nga tabela 1 dhe tabela 2, nuk duhet të kalojë 50 pikë.
- Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe nga bonuset, përjashtohet nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.



SHTOJCA 3  
FORMATI I KËRKESËS PËR AKREDITIM TË TRAJNIMIT

**Logoja e subjektit**  
**Emërtimi i subjektit**

Kërkesë për akreditim të trajnimit/trajtimeve

Datë .....

**Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**Tiranë**

Unë, ....., përfaqësues i subjektit ....., me adresë ....., telefon ....., e-mail ....., referuar udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr....., datë .....2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimeve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional”, parashtron kërkesën për akreditim të trajnimit (trajtimeve) të mëposhtme:

1. ....
2. ....
3. ....

Bashkangjitur ndodhet edhe dokumentacioni i kërkuar:

1. Të dhënat e subjektit;
2. Dokumentacioni juridik për subjektin;
3. Dokumentacioni i programit të trajnimit/trajtimeve;
4. Dokumentacioni për shkallën e kualifikimit të trajnerëve;
5. Dokumentacioni për infrastrukturën fizike dhe didaktike të realizimit të trajnimit.

Duke shpresuar në miratimin e kësaj kërkesë,

Me respekt,

Emër, mbiemër, firma dhe vula e subjektit (nëse ka)

SHTOJCA 4  
FORMATI I CERTIFIKATËS SË AKREDITIMIT TË TRAJNIMIT



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE**

**CERTIFIKATË E AKREDITIMIT TË TRAJNIMIT**

Mbështetur në vendimin e Komisionit për Kualifikimin e Mësimeve të AFP, nr....., datë ....., subjekti ..... akreditohet për ofrimin e trajnimit për mësime të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional, me titull: ....., me kohëzgjatje .... kredite (... orë trajnimi).

**Programi i trajnimit të akredituar**

Nr.	Temat/modulet e trajnimit	Kreditet	Orët e trajnimit
1	.....	...	...
2	.....	...	...
3	.....	...	...

Kodi i akreditimit: ..... Nr. i regjistrimit: .....

Datë .....

Kjo certifikatë akreditimi është e vlefshme për një afat ... -vjeçar.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
(emri, mbiemri, firma, vula)





SHTOJCA 5  
SKEMA E SHKALLËVE TË VLERËSIMIT

**Për kualifikimet e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP**

Shuma e pikëve të fituara nga portofoli + testi	Vlerësimi me shkallë	Vlerësimi me shprehje
0 ÷ 49	<b>E</b>	<b>Dobët</b>
50 ÷ 62	<b>D</b>	<b>Mjaftueshëm</b>
63 ÷ 75	<b>C</b>	<b>Mirë</b>
76 ÷ 88	<b>B</b>	<b>Shumë mirë</b>
89 ÷ 100	<b>A</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>

**Shënime:**

- a) Pikët maksimale që fitohen nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli i kualifikimit dhe nga testi i provimit të kualifikimit, janë 100 pikë.
- b) Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit, nuk e fiton kategorinë e kualifikimit, pavarësisht nga totali i pikëve të fituara.
- c) Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi në testin e provimit të kualifikimit, nuk e fiton kategorinë e kualifikimit, pavarësisht nga totali i pikëve të fituara.
- d) Nëse kandidati grumbullon më pak se 50 pikë nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli dhe nga testi, vlerësohet me shkallën “E” (Dobët) dhe nuk e fiton kategorinë e kualifikimit.

**UDHËZIM**

Nr. 18, datë 8.7.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021,  
“PËR PROCEDURAT DHE KRITERET  
PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË  
DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE,  
GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE  
AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA  
INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT  
TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË  
TJERA TË AUTORIZUARA”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2, e kreut II, riformulohet si më poshtë:

“Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit online.”;

b) Nën-pika “ii”, e germës “b”, të pikës 3, të kreut II, riformulohet si vijon:

“ii. Supplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.”.

c) Pika 3.1 e kreut II, shfuqizohet.

d) Nën-pika “ii” e germës “b”, të pikës 4, të kreut II, shfuqizohet.

e) Pika 4.1 e kreut II, shfuqizohet.

f) Nën-pika “ii”, e germës “b”, të pikës 5.1, të kreut II, riformulohet si vijon:

“ii. Kopjen e dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore “Doktor”, e noterizuar dhe shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit.”.

i) Pika 5.2 e kreut II, shfuqizohet.

j) Pika 1.2 e kreut III, riformulohet si vijon:

“1.2 Procedura e njohjes dhe njësimin fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në sistemin online, në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

SENJOD vetëm në ato raste kur ka dyshime të arsyeshme për autenticitetin e diplomës ose certifikatës së lëshuar kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën ose certifikatën përkatëse.

Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim. Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet nëpërmjet sistemit online.”.





k) Pika 1.3 e kreut III, riformulohet si vijon:

“1.3 Për arsye objektive QSHA, gjatë procedurës së njohjes dhe njësimit mund të kërkojë dokumentin/et, të parashikuar në këtë udhëzim, në formë shkresore.

Në rast të mos depozitimit të dokumentit, në formë shkresore, brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni arkivohet.”

l) Pika 1.4 e kreut III, riformulohet si vijon:

“1.4 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SENJOD i kërkon aplikantit plotësimin e dokumentacionit me anë të sistemit online, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni arkivohet.”

m) Pika 5, kreu III të riformulohet si vijon:

“5. Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të certifikatës/diplomës ose mund të vendosë ta kthejë për plotësim të tjera të nevojshme të dokumentacionit të sekretaria teknike (SENJOD), sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SENJOD) zbardh raportin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave, i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, nëpërmjet sistemit online dhe nënshkrim dhe vulë elektronike, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur ky Komision nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e diplomës ose certifikatës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit nëpërmjet sistemit online për arsyet dhe mangësitë e aplikimit.”

n) Pika 6.4, kreu III, të riformulohet si vijon:

“6.4. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.”

o) Pika 7.3, Kreu III, të riformulohet si vijon:

“7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit ad hoc nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.”

p) Pika 9, kreu III, të riformulohet si vijon:

“9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, (përveç gradave shkencore “Doktor”) lëshohet i firmosur nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i komisionit në dy kopje

me nënshkrim dhe vulë elektronike (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

q) Pika 3 e kreut IV ndryshon si vijon:

“3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të titujve akademikë, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës për gradën shkencore “Doktor” (nëse ka të tillë), dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;

iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.”

r) Pika 4 e kreut IV, shfuqizohet.

s) Pas pikës 1 të kreut VII, shtohet pika 1/1 si vijon:

“1/1. Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin ndiqen përcaktimet e parashikuar në këtë udhëzim, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose më shumëpalëshe të nënshkruar ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucionit përgjegjës të autorizuar prej saj dhe një subjekti juridik të huaj, që kanë për objekt njohjen dhe njësimin e diplomave të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë.”

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
Evis Kushi



**URDHËR I PËRBASHKËT**  
**Nr. 163, datë 6.6.2022**

**PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E**  
**KOMITETIT SEKTORIAL TË**  
**MIKPRITJES DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

**URDHËROJNË:**

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit.

2. Komiteti Sektorial TIK organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e hoteleri-turizmit;

ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të hoteleri-turizmit, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore e në sektorin hoteleri-turizëm;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtarë me më

shumë eksperiencë në çështjet e hoteleri-turizmit dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për përzgjedhjen e përfaqësuesit sipas germës “dh”, të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve sipas shkronjave “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti i Mikpritjes dhe Turizmit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**

**URDHËR**

**Nr. 134, datë 27.6.2022**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**“PËR NIVELIN MINIMAL TË**  
**TRAJNIMIT TË DETARËVE”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 102, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të germës “g”, të nenit 14, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për nivelin minimal të trajnimit të detarëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Belinda Balluku**

**DRAFTRREGULLORE**  
PËR NIVELIN MINIMAL TË TRAJNIMIT TË  
DETARËVE

Neni 1  
**Termat**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë kuptimin:

1. **“Kapiten”** është personi që drejton anijen;
2. **“Oficeri”** është një anëtar i ekuipazhit, i ndryshëm nga kapiteni, i caktuar si i tillë në bazë të rregulloreve ose legjislacionit të brendshëm ose, në mungesë të një përcaktimi të tillë, në bazë të marrëveshjeve kolektive ose individuale;
3. **“Oficeri i kuvertës”** është një oficer i kualifikuar në përputhje me dispozitat e kreut II të shtojcës I;
4. **“Oficeri i parë”** është oficeri menjëherë pas kapitenit në hierarki, i cili merr komandën e anijes në rast të paaftësisë fizike të kapitenit;
5. **“Inxhinieri mekanik”** është një oficer i kualifikuar në përputhje me dispozitat e kreut III të shtojcës I;
6. **“Kryeinxhinieri mekanik”** është inxhinieri kryesor mekanik, i cili kontrollon shtytjen mekanike, si dhe është përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve mekanike dhe elektrike të anijes;
7. **“Inxhinieri mekanik i dytë”** është inxhinieri mekanik në hierarki menjëherë pas kryeinxhinierit mekanik, i cili mban përgjegjësi për kontrollin e shtytjes mekanike, si dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve mekanike dhe elektrike të anijes, në rast të paaftësisë fizike të kryeinxhinierit mekanik;
8. **“Ndihmësinxhinieri mekanik”** është një person i cili i është nënshtruar trajnimit për t'u kualifikuar si inxhinier mekanik dhe i cili është caktuar si i tillë nga legjislacioni ose rregulloret e brendshme;

9. **“Operatori i radiokomunikimit”** është një person i pajisur me një certifikatë të posaçme të lëshuar ose të njohur nga autoritetet kompetente, sipas dispozitave të rregulloreve për radiokomunikimin;

10. **“Marinar”** është një anëtar i ekuipazhit të anijes, i ndryshëm nga kapiteni ose oficerët;

11. **“Anije detare”** është një anije e ndryshme nga ato që lundrojnë vetëm në ujërat e brendshme, në ujërat e zonave të mbrojtura ose në ujërat afër këtyre zonave të mbrojtura ose zonave ku zbatohen rregulloret portuale;

12. **“Anije që mban flamurin e një shteti anëtar të BE-së”** është një anije e regjistruar në një shtet anëtar të BE-së, i cili mban flamurin e atij shteti anëtar, në përputhje me legjislacionin e tij;

13. **“Lundrim bregdetar”** janë lundrimet në afërsi të një shteti, sipas përkufizimit nga ai shtet;

14. **“Fuqia shtytëse”** është fuqia maksimale nominale në dalje e shprehur në kilovat e të gjitha makinerive kryesore shtytëse të një anijeje e cila paraqitet në certifikatën e regjistrimit të anijes ose në një dokument tjetër zyrtar;

15. **“Anije cisternë”** është një anije e ndërtuar dhe e përdorur për transportimin në sasi të mëdha të naftës dhe nënprodukteve të saj;

16. **“Anije cisternë për substanca kimike”** është një anije e ndërtuar ose e përshtatur dhe e përdorur për transportin në sasi të mëdha të çdo produkti të lëngët të renditur në kreun 17 të Kodit Ndërkombëtar për Produktet Kimike Rifuxho, në versionin e tij të përditësuar;

17. **“Anije cisternë për gaze të lëngshme”** është një anije e ndërtuar ose e përshtatur dhe e përdorur për transportin në sasi të mëdha të gazeve të lëngshme apo të produkteve të tjera të renditura në kreun 19 të Kodit Ndërkombëtar për Transportin e Gazeve, në versionin e tij të përditësuar;

18. **“Rregulloret e radiokomunikimit”** janë rregulloret e radiokomunikimit bashkëlidhur, ose që konsiderohen të bashkëlidhura me Konventën Ndërkombëtare të Telekomunikacionit, të ndryshuar;

19. **“Anije pasagjerësh”** është një anije siç përcaktohet në Konventën Ndërkombëtare “Për Sigurinë e Jetës në Det”, të 1974-ës (SOLAS 74), të ndryshuar;”;



**20. “Anije peshkimi”** është një anije që përdoret për të kapur peshk apo të tjera burime të gjalla detare;

**21. “Konventa STCW”** është Konventa e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) “Për standardet e trajnimit, certifikimit dhe vrojimit për detarët”, e vitit 1978, e zbatueshme për çështjet në fjalë, duke marrë në konsideratë dispozitat kalimtare të nenit VII dhe rregullores I/15 të konventës dhe duke përfshirë, sipas rastit, dispozitat e zbatueshme të kodit STCW, të dyja në versionet e tyre të përditësuara;

**22. “Shërbimet e radiokomunikimit”** përfshijnë, sipas rastit, vrojtimin, mirëmbajtjen teknike dhe riparimet e kryera në përputhje me rregulloret për radiokomunikimin, me Konventën Ndërkombëtare “Për sigurinë e jetës në det”, të vitit 1974, (SOLAS 74) dhe, me rekomandimet përkatëse të IMO-s, në versionin e tyre të përditësuara;

**23. “Anije Ro-Ro për pasagjerët”** është një anije pasagjerësh me hapësira për ngarkimin Ro-Ro ose me hapësira të veçanta sipas përcaktimit në SOLAS 74, në versionin e saj të përditësuara;

**24. “Kodi STCW”** është kodi “Për trajnimin, certifikimin dhe vrojtimin për detarët” (STCW), i miratuar me rezolutën 2 të konferencës së vitit 1995, në versionin e saj të përditësuara;”;

**25. “Funksion”** është një grup detyrash dhe përgjegjësish, siç specifikohet në Kodin STCW, të nevojshme për operimin e anijes, sigurinë e jetës në det ose mbrojtjen e mjedisit detar;

**26. “Shoqëri”** është pronari i anijes ose çdo organizatë ose person tjetër, si menaxheri ose kontraktuesi “Bareboat”, i ngarkuar me përgjegjësinë e operimit të anijes nga pronari i anijes dhe i cili, duke pranuar këtë përgjegjësi, ka rënë dakord të marrë përsipër të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që i vendosen shoqërisë nga kjo rregullore;

**27. “Shërbim Detar”** nënkupton shërbimin në bordin e një anije të përshtatshme për lëshimin ose rivlerësimin e një certifikate kompetence, certifikate aftësie ose kualifikimi tjetër.

**28. “I miratuar”** është i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare në përputhje me këtë rregullore;

**29. “Vend i tretë”** është çdo shtet që nuk është shtet anëtar i BE-së;

**30. “Muaj”** është një muaj kalendarik ose 30 ditë të shpërndara në periudha prej më pak se një muaj.

**31. “Operator i radiokomunikimit GMDSS”** është një person i kualifikuar në përputhje me kreun IV të shtojcës I;

**32. “Kodi ISPS”** është Kodi Ndërkombëtar “Për sigurinë në anije dhe në port” i miratuar më 12 dhjetor 2002, me rezolutën 2 të konferencës së qeverive kontraktuese të SOLAS 74, në versionin e saj të përditësuara;

**33. “Oficeri i sigurisë së anijes”** është personi në bordin e një anijeje i cili i përgjigjet kapitenit dhe është caktuar nga shoqëria si përgjegjës për sigurinë e anijes, duke përfshirë zbatimin dhe mbajtjen e planit të sigurisë së anijes dhe bashkëpunimin me oficerin e sigurisë së shoqërisë dhe oficerët e sigurisë së portit;

**34. “Detyrat në lidhje me sigurinë”** përfshijnë të gjitha detyrat dhe detyrimet në lidhje me sigurinë në bordin e anijeve, siç përcaktohet në kreun XI/2 të SOLAS 74, të ndryshuar, dhe në Kodin ISPS;

**35. “Certifikatë kompetence”** është një certifikatë që lëshohet dhe azhurnohet për kapitenët, oficerët dhe operatorët e radiokomunikimit GMDSS, në përputhje me kërkesat II, III, IV ose VII të shtojcës I, e cila i jep të drejtën zotëruesit të ligjshëm të saj që të kryejë detyrën dhe funksionet që bëjnë pjesë në nivelin e përgjegjësisë të specifikuar në të;

**36. “Certifikatë e aftësisë”** është një certifikatë, e ndryshme nga certifikata e kompetencës, që u lëshohet detarëve dhe në të cilën cilësohet se janë përmbushur kërkesat përkatëse të trajnimit, kompetencave ose të shërbimit në det, sipas kësaj rregulloreje;

**37. “Dokument provë”** janë dokumente të ndryshme nga certifikata e kompetencës apo certifikata e aftësisë, që përdoren për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje;

**38. “Oficer elektroteknik”** është një oficer i kualifikuar në përputhje me kreun III të shtojcës I;

**39. “Marinar kuverte i kualifikuar”** është një marinar i kualifikuar në përputhje me kreun II të shtojcës I;

**40. “Oficer mashine i kualifikuar”** është një marinar i kualifikuar në përputhje me kreun III të shtojcës I;



41. “Vlerësim elektro teknik” nwnkupton njw vlerësim i kualifikuar në përputhje me kreun III të shtojcws 1;

42. “Autoritet Kompetent” do të thotë Administrata Detare e shtetit të Flamurit që mban anija.

43. “Drejtoria e Përgjithshme Detare” (DPD): është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmerisë së ligjit për fushën e detarisë, në varësi të ministrit përgjegjës për transportin.

44. “Autoriteti Kompetent në Komunikimet e Radios”: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

45. “GMDSS”: do të thotë Sistemi Global i Sigurisë së Fatkeqësive Detare.

46. “GMDSS-GOC”: do të thotë certifikata e përgjithshme e operatorit GMDSS.

47. “GMDSS-ROC”: do të thotë certifikata e kufizuar e operatorit GMDSS.

48. “Flag Endorsment”: certifikatë e lëshuar nga DPD-ja nëpërmjet së cilës vërtetohet njohja e kompetencës së detarit.

49. “Pasaporta e trajnimit në bord” (*training log book*): dokument i miratuar dhe lëshuar nga DPD-ja nëpërmjet së cilës detarët do të mund të vërtetojnë kryerjen e praktikës së detyrueshme në bordin e anijes.

#### Neni 2

##### Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për detarët shqiptarë të cilët shërbejnë në bordin e anijeve që lundrojnë në det dhe që mbajnë flamurin shqiptar, me përjashtim të:

a) anijeve luftarake, mjeteve detare ndihmëse ose anijeve të tjera në pronësi apo që operohen nga një shtet dhe që përfshihen vetëm në shërbimet jotregtare qeveritare;

b) anijeve të peshkimit;

c) jahteve për qëllime argëtimi, që nuk përfshihen në aktivitete tregtare;

d) anije druri të ndërtuara në mënyrë primitive.

2. Zbatohet për detarët që disponojnë një certifikatë të lëshuar nga DPD-ja, pavarësisht nga kombësia e tij.

#### Neni 3

##### Trajnimi dhe certifikimi

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare merr masat e nevojshme për të garantuar që detarët që shërbejnë në anijet e përmendura në nenin 2 të trajnohen të paktën në përputhje me kërkesat e Konventës STCW, siç përcaktohet në aneksin I të kësaj rregulloreje, dhe të jenë të pajisur me certifikatat e përcaktuara në pikat 35 dhe 36 të nenit 1 dhe/ose dokumente provë, siç përcaktohet në pikën 37 të nenit 1.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton që anëtarët e ekuipazhit të cilët duhet të jenë të certifikuar në përputhje me rregulloren III/10.4 të SOLAS 74 të trajnohen dhe të certifikohen në përputhje me këtë rregullore.

#### Neni 4

##### Certifikatat e kompetencës, certifikatat e kualifikimit dhe pranimit të tyre

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare lëshon certifikatat e kompetencës dhe të kualifikimit vetëm për kandidatët që përmbushin kërkesat e këtij neni.

2. Certifikatat për kapitenët, oficerët dhe operatorët e radiokomunikimit konvertohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, siç parashikohet në këtë nen.

3. Certifikatat e kompetencës dhe certifikatat e kualifikimit lëshohen në përputhje me rregulloren I/2, paragrafi 3 të shtojcës së Konventës STCW.

4. Certifikatat e kompetencës lëshohen vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, pas verifikimit të origjinalitetit dhe vlefshmërisë së çdo dokumenti provë të nevojshëm dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë nen.

5. Për sa i përket operatorëve të radiokomunikimit, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund:

a) të përfshijë në shqyrtimin për lëshimin e certifikatave në përputhje me rregulloret e radiokomunikimit, njohuritë shtesë që kërkohen nga rregulloret përkatëse; ose

b) të lëshojë një certifikatë të veçantë, që vërteton se mbajtësi ka njohuritë shtesë të kërkuara nga rregulloret përkatëse.

6. Konvertimi (*flag endorsement*) do të jenë në formën e certifikatave të lëshuara, siç parashikohet në seksionin A-I/2 të kodit STCW. Forma e



përdorur është ajo e përcaktuar në seksionin A-I/2, paragrafi 1. Konvertimet lëshohen në përputhje me nenin VI, paragrafi 2 të Konventës STCW.

Konvertimi (*flag endorsement*) që vërtetojnë lëshimin e certifikatave të kompetencës dhe certifikatave të kualifikimit të lëshuara për kapitenët dhe oficerët, në përputhje me rregulloret V/1-1 dhe V/1-2 të shtojcës I, jepen vetëm nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat e Konventës STCW dhe kësaj rregulloreje.

7. Drejtoria e Përgjithshme Detare njih një certifikatë kompetence ose një certifikatë kualifikimi të lëshuar për kapitenët dhe oficerët në përputhje me rregulloret V/1-1 dhe V/1-2 të shtojcës I të Konventës STCW, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 20, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, e konverton këtë certifikatë për të vërtetuar njohjen vetëm pas garantimit të origjinalitetit dhe vlefshmërisë së saj. Forma e përdorur e konvertimit është ajo e përcaktuar në paragrafin 3, të seksionit A-I/2 të kodit STCW.

8. Përditësimet, konvertimet e përmendura në paragrafët 5 dhe 6:

a) mund të lëshohen si dokumente të veçanta;

b) do të lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;

c) shoqërohen secila nga një numër unik, përveç konvertimeve që vërtetojnë lëshimin e një certifikate kompetence të cilat mund të kenë të njëjtin numër me certifikatën e kompetencës në fjalë, me kusht që ai numër të jetë unik; dhe

d) skadojnë menjëherë pas përfundimit të vlefshmërisë ose revokimit, pezullimit apo anulimit të certifikatave të përditësuara të kompetencës dhe të kualifikimit të lëshuara, për kapitenët dhe oficerët në përputhje me rregulloret V/1-1 dhe V/1-2 të shtojcës së Konventës STCW, nga DPD-ja ose vendi që i ka lëshuar ato dhe, në çdo rast, brenda pesë viteve nga data e lëshimit të tyre.

9. Përditësimi, konvertimi duhet të përfshijë funksionet e autorizuara që mund të kryhen nga mbajtësi i certifikatës, në të njëjtën formë me atë të kërkesave për personelin minimal për lundrim të sigurt të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të përdorë një formë të ndryshme nga ajo e përcaktuar në seksionin A-I/2 të kodit STCW, me kusht që, minimalisht, informacioni i kërkuar të paraqitet me germa latine dhe numra arabë, duke

marrë në konsideratë ndryshimet e lejuara sipas seksionit A-I/2.

11. Në përputhje me nenin 20, paragrafi 7, çdo certifikatë e kërkuar sipas kësaj rregulloreje apo të lëshuar nga DPD-ja duhet të jetë në dispozicion në formën e saj origjinale në bordin e anijes në të cilën shërben mbajtësi i saj.

12. Kandidatët për certifikim vërtetojnë:

a) identitetin e tyre;

b) që mosha e tyre nuk është më e vogël se ajo e parashikuar në rregulloret e shtojcës I lidhur me certifikatën e kompetencës ose të kualifikimit për të cilën po aplikojnë;

c) se i përmbushin kriteret e përshtatshmërisë shëndetësore, të specifikuara në seksionin A-I/9 të kodit STCW;

d) se kanë kryer shërbimin në det dhe çdo trajnim përkatës të detyrueshëm, të parashikuar në rregulloret e renditura në shtojcën I, për certifikatën e kompetencës ose certifikatën e kualifikimit për të cilën po aplikojnë; dhe

e) se i përmbushin standardet e kompetencës të përcaktuara në rregulloret e renditura në shtojcën I në lidhje me kapacitetet, funksionet dhe nivelet, të cilat duhet të specifikohen në përditësimin, konvertimin e certifikatës së kompetencës.

Ky paragraf nuk zbatohet për njohjen e përditësimeve, konvertimeve sipas rregullore I/10 të Konventës STCW.

13. Drejtoria e Përgjithshme Detare, duhet të:

a) të mbajë një ose disa regjistra për të gjitha certifikatat e kompetencës, certifikatat e kualifikimit, konvertimet (*flag endorsementet*) për kapitenët dhe oficerët dhe, sipas rastit, certifikatat e marinarëve, të cilat janë lëshuar, kanë skaduar, janë rivlerësuar, pezulluar, anuluar ose raportuar si të humbura apo të shkatërruara;

b) t'u vendosë në dispozicion informacion për statusin e certifikatave të kompetencës, konvertimeve (*flag endorsementet*) shteteve të tjera anëtare të Konventës STCW dhe shoqërive që kërkojnë të verifikojnë origjinalitetin dhe vlefshmërinë e certifikatave të kompetencës dhe/ose të kualifikimit lëshuar kapitenëve dhe oficerëve në përputhje me rregulloret V/1-1 dhe V/1-2 të shtojcës I, të paraqitura nga detarët të cilët kërkojnë njohjen e tyre, sipas rregullore I/10 të Konventës STCW, ose punësim në bordin e anijes.



14. Informacioni i kërkuar në përputhje me germën “b”, të paragrafit 12 vendoset në dispozicion nëpërmjet mjeteve elektronike.

15. Kur amendamentet përkatëse të Konventës STCW dhe pjesa A e Kodit STCW në lidhje me certifikatat digjitale për detarët të hyjnë në fuqi, ministria e linjës duhet të miratojë akte nënligjore përkatëse për të digjitalizuar certifikatat dhe *flag endorsementet* e detarëve.

#### Neni 5

##### **Kërkesat e trajnimit**

Trajnimi i kërkuar sipas nenit 3 ndahet në mënyrë të përshtatshme në njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të nevojshme sipas shtojcës I, në veçanti ato për sa i përket përdorimit të pajisjeve të shpëtimit të jetës dhe pajisjeve zjarrfikëse, të pasqyruara në planin mësimor, i cili do të aprovet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

#### Neni 6

##### **Parandalimi i mashtrimit dhe praktikave të tjera të paligjshme**

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare ndërmerr dhe zbaton masat e duhura për parandalimin e mashtrimit dhe praktikave të tjera të paligjshme që përfshijnë certifikatat dhe konvertimet *endormentet* e lëshuara, si dhe parashikojnë sanksione që janë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.

2. Me kërkesë të çdo shteti, Drejtoria e Përgjithshme Detare konfirmon, ose jo, me shkrim ose me postë elektronike, origjinalitetin autenticitetin e certifikatave, konvertimeve (*endormenteve*) përkatëse ose të çdo dokumenti tjetër provë për trajnimin, të lëshuara nga DPD-ja.

#### Neni 7

##### **Sanksionet ose masat disiplinore**

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton proceset dhe procedurat për hetimin e paanshëm të çdo raportimi për paftësi, në formën e veprimit, mosveprimit apo kompromentimit të sigurisë që mund të përbëjë kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë së jetës ose të pronës në det apo ndaj mjedisit detar, nga mbajtësit e certifikatave të kompetencës, certifikatave të kualifikimit ose

konvertimeve përditësimeve të lëshuara nga DPD-ja në lidhje me kryerjen e detyrave të specifikuara në këto certifikata, si dhe për revokimin, pezullimin dhe anulimin e certifikatave të kompetencës dhe të kualifikimit për këtë arsye dhe me qëllim parandalimin e mashtrimit.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare ndërmerr dhe zbaton masat e duhura për parandalimin e mashtrimit dhe praktikave të tjera të paligjshme që përfshijnë certifikatat e kompetencës, certifikatat e kualifikimit dhe miratimet e lëshuara nga ana e DPD-së.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare zbaton masat disiplinore, veçanërisht, kur:

a) shoqëria ose kapiteni kanë angazhuar një person, i cili nuk është i pajisur me certifikatë, ashtu siç kërkohet nga kjo rregullore;

b) kapiteni ka lejuar që një funksion apo shërbim i caktuar në çfarëdo lloji kapaciteti, që sipas kësaj rregulloreje duhet të kryhet nga një person i pajisur me një certifikatë të posaçme, të kryhet nga një person i papajisur me këtë certifikatë, një leje të vlefshme apo një dokument provë, sipas kësaj rregulloreje; ose

c) një person ka arritur, me anë të mashtrimit ose dokumenteve të falsifikuara, të caktohet për të kryer çfarëdo funksioni apo detyre që sipas kësaj rregulloreje duhet të kryhet ose të jetë nën përgjegjësinë e një personi të pajisur me një certifikatë ose leje të vlefshme.

4. Certifikata e kompetencës e lëshuar për detarët në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, mund të pezullohen me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, njoftim i cili i bëhet me dije brenda 10 ditëve personit përkatës. Gjatë procedimit dhe deri në datën e marrjes së vendimit, personi nën hetim mund të pezullohet nga shërbimi në detyrat që kanë të bëjnë me sigurinë e lundrimit të anijes.

5. Certifikatat e kompetencës pezullohen sipas rëndesës së shkeljes, për një periudhë nga 1 deri në 12 muaj. Në rast se mbajtësi i certifikatës së kompetencës është nën hetim penal për një shkelje specifike të ligjit, certifikatat e tij të kompetencës do të pezullohen mbi bazën e kërkesës së autoritetit i cili po bën procedimin.

6. Pezullimi mund të urdhërohet për shkeljet e mëposhtme të kryera nga detarët:

(a) situatat e përcaktuara në paragrafin 3;



(b) shkeljen e parashikimeve ligjore në lidhje me sigurinë dhe rregullat lundrimore;

(c) shkeljen e rregullave të parashikuara nga rregullat e lundrimit;

(d) mospërmbushja e detyrave të lidhura me funksionin për të cilin është lëshuar certifikata e kompetencës;

(e) konsumimin e alkoolit apo drogërave në bordin e anijes dhe kryerja e detyrave nën influencën e tyre;

(f) shkaktimin e qëllimshëm të ndotjeve, deri në atë masë sa që nuk përbën një kundërvajtje administrative dhe penale;

(g) braktisje e detyrës, pa autorizim, gjatë shërbimit, nëse një braktisje e tillë do të shkaktojë ndërprerje apo pengim të lundrimit.

7. Procedimi për pezullimin e certifikatës së kompetencës fillohet mbi bazën e gjetjeve direkte të organizmave të autorizuar të kontrollit ose me kërkesë me shkrim nga pronarët dhe/ose operatorët ose pjesëmarrësit e tjerë në aktivitetet lundrimore, në lidhje me shkeljet e kryera në këtë kategori sikurse janë parashikuar në paragrafin 6 të këtij neni.

8. Në rastin e anijeve që lundrojnë jashtë ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë kapiteni i anijes do të hartojë një dosje për hetimin e shkeljeve e cila do të dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare nëpërmjet pronarit të anijes. Mbi bazën e dosjes së përpiluar në bordin e anijes, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të vendosë mbi pezullimin e certifikatës së kompetencës.

9. Në rastin e anijeve që lundrojnë jashtë ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë hetimi i shkeljeve të kryera nga kapiteni i anijes, do të bëhet nga një përfaqësues i pronarit dhe/ose operatorit. Ky përfaqësues duhet të zotërojë certifikatën e kapitenit. Ky përfaqësues do të përpilojë një dosje mbi hetimin e shkeljes, të cilën do ja dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme Detare përmes pronarit ose operatorit.

10. Pezullimi i certifikatës së kompetencës përfundon me skadimin e afatit të pezullimit të përcaktuar në vendimin e pezullimit.

11. Anulimi i certifikatës së kompetencës bëhet për veprime të cilat përbëjnë shkelje specifike në lidhje me lundrimin tregtar, të sanksionuar me ligj.

12. Certifikata e kompetencës anulohet me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare mbi bazën e një vendimi të formës së prerë.

13. Anulimi është përfundimtar dhe i njoftohet personit përkatës brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të anulimit. Me anulimin e certifikatës, Drejtoria e Përgjithshme Detare tërheq certifikatën e kompetencës si dhe pasaportën e detarit.

14. Personi të cilit i është anuluar certifikata e kompetencës nuk mund të kryej asnjë aktivitet në bordin e një anije.

15. Një person ndaj të cilit është marrë masa e pezullimit të certifikatës së kompetencës, mund të apelojë këtë vendim me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit sipas ligjit.

## Neni 8

### Standardet e cilësisë

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare do të sigurojë, që:

(a) të gjitha veprimtaritë e trajnimit, vlerësimit të kompetencave, certifikimit, duke përfshirë certifikatat mjekësore, konvertimit përditësimit dhe rivlerësimit të kryera nga qendrat e trajnimit ose subjektet të licencuara, të monitorohen vazhdimisht përmes një sistemi të standardeve të cilësisë për të garantuar arritjen e objektivave të përcaktuara, duke përfshirë edhe ato në lidhje me kualifikimet dhe përvojën e trajnuesve dhe vlerësuesve, në përputhje me seksionin A-I/8 të kodit STCW;

(b) nëse këto veprimtari kryhen nga agjencitë ose subjektet shtetërore, të disponohet një sistem i standardeve të cilësisë në përputhje me seksionin A-I/8 të kodit STCW;’;

(c) objektivat e formimit dhe trajnimit dhe standardet përkatëse të kompetencave që duhet të arrihen të jenë të përcaktuara qartë, si dhe të jenë identifikuar nivelet e njohurive, të të kuptuarit dhe të aftësive të përshtatshme për testimet dhe vlerësimet e parashikuara nga Konventa STCW.

2. Fushat e zbatimit të standardeve të cilësisë mbulojnë administrimin e sistemeve të certifikimit, të gjitha kurset dhe programet e trajnimit, testimet dhe vlerësimet e kryera nga DPD-ja, si dhe kualifikimet dhe përvojën e kërkuar të trajnuesve dhe vlerësuesve, duke pasur parasysh politikat, sistemet, kontrollet dhe shqyrtimet e brendshme të cilësisë të miratuara për të garantuar arritjen e objektivave të përcaktuara.





Objektivat dhe standardet përkatëse të cilësisë të përmendura në pikën “c”, të nënparagrafit të parë mund të specifikohen veçmas për kurse dhe programe të ndryshme trajnimi dhe mbulojnë administrimin e sistemit të certifikimit.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton, gjithashtu, që vlerësimet e pavarura të veprimtarive të përvetësimit dhe vlerësimit të njohurive, të të kuptuarit, të aftësive dhe kompetencave si dhe të administrimit të sistemit të certifikimit, të kryhen jo më rrallë se një herë në pesë vite nga persona të kualifikuar që nuk janë personalisht të përfshirë në veprimtaritë në fjalë, me qëllim që të verifikohet se:

a) të gjitha masat e brendshme të kontrollit dhe të monitorimit, si dhe ato plotësuese janë në përputhje me metodat e planifikuara, si dhe me procedurat e dokumentuara, dhe janë efektive për garantimin e arritjes së objektivave të përcaktuara;

b) rezultatet e çdo vlerësimi të pavarur janë dokumentuar dhe janë sjellë në vëmendje të personave përgjegjës për fushën e vlerësuar;

c) janë marrë masa në kohën e duhur për korrigjimin e mangësive.

d) të gjitha dispozitat e zbatueshme të Konventës dhe të kodit STCW, duke përfshirë ndryshimet, mbulohen nga sistemi i standardeve të cilësisë. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të përfshijë brenda këtij sistemi edhe dispozitat e tjera të zbatueshme të kësaj rregulloreje.

4. Drejtoria e Përgjithshme Detare i përcjell Ministrisë një raport në lidhje me çdo vlerësim të kryer sipas paragrafit 2, në përputhje me formatin e specifikuar në seksionin A-I/7 të kodit STCW, brenda gjashtë muajve nga data e vlerësimit. Ministria e përcjell këtë informacion Sekretarit të Përgjithshëm të IMO-s.

Neni 9

### Standardet mjekësore

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare në bashkërendim me autoritetet përkatëse mjekësore, përcakton kriteret e përshtatshmërisë shëndetësore për detarët dhe procedurat për lëshimin e certifikatave mjekësore në përputhje me këtë nen dhe me seksionin A-I/9 të kodit STCW, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, seksionin B-I/9 të kodit STCW.

a) për vlerësimin e përshtatshmërisë shëndetësore të detarëve, Drejtoria e Përgjithshme

Detare sigurohet që personat të jenë profesionistë të kujdesit mjekësor të njohur për qëllimin e ekzaminimeve mjekësore të detarëve, në përputhje me seksionin A-I/9 të kodit STCW;

b) çdo detar i pajisur me një certifikatë aftësie ose një certifikatë kualifikimi, të lëshuar sipas dispozitave të Konventës STCW, i cili është në shërbim në det, është gjithashtu i pajisur me një certifikatë mjekësore të vlefshme të lëshuar në përputhje me këtë nen dhe me seksionin A-I/9 të kodit STCW.

Kandidatët për certifikim mjekësor:

a) janë të paktën 16 vjeç;

b) sigurojnë një mjet të vlefshëm identifikimi; dhe

c) përmbushin kriteret e zbatueshme të përshtatshmërisë shëndetësore të përcaktuara nga kjo rregullore.

2. Certifikatat mjekësore janë të vlefshme për një periudhë maksimale prej dy vjetësh, përveçse kur detarët janë nën 18 vjeç, raste në të cilat periudha maksimale e vlefshmërisë është një vit.

3. Nëse periudha e vlefshmërisë së certifikatës mjekësore përfundon gjatë lundrimit, zbatohet rregullorja I/9 e shtojcës së Konventës STCW.

4. Në raste urgjencash, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund ta autorizojë shërbimin e një detari edhe në mungesë të një certifikate të vlefshme mjekësore. Në këto raste, zbatohet rregullorja I/9 e shtojcës së Konventës STCW.

Neni 10

### Lëshimi dhe regjistrimi i certifikatave

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare do të sigurohet që certifikatat i lëshohen vetëm kandidatëve të cilët përmbushin kërkesat e këtij neni.

2. Çdo kandidat për certifikim duhet të përmbushë kërkesat dokumentare të mëposhtme:

(a) të identitetit të tij;

(b) të provojë që mosha e tij nuk është më e vogël se ajo e përshkruar në rregullat e shtojcës 1 në lidhje me certifikatën për të cilën ka aplikuar;

(c) që ai/ajo përmbush standardet e kërkuara mjekësore, në veçanti ato që lidhen me dëgjimin dhe shikimin të përcaktuara nga autoriteti mjekësor dhe mban një dokument të vlefshëm që vërteton gjendjen e tij shëndetësore, të lëshuar nga një mjek



i specializuar dhe i njohur nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;

(d) që ai/ajo ka përfunduar shërbimin detar dhe çdo trajnim të detyrueshëm lidhur me atë që është përcaktuar në shtojcën 1 të rregullores për certifikatën e kërkuar;

(e) ai ose ajo plotëson standardet e aftësisë përcaktuar në shtojcën 1 të rregullores për aftësitë, funksionet dhe nivelet që duhet të identifikohen në miratimin e certifikatës.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare, duhet:

(a) të mbajë një regjistër ose regjistra të të gjitha certifikatave dhe *flag endorsements* për kapitenët dhe, sipas rastit, për anëtarët e tjerë, që janë lëshuar, kanë skaduar ose janë rivlerësuar, pezulluar, anuluar ose raportuar të humbura apo shkatërruara, si dhe të urdhëresave të lëshuara;

(b) të vendosë në dispozicion informacione mbi statusin e certifikatave në rastet kur i kërkohej informacion mbi verifikimin e vërtetësisë dhe vlefshmërinë e certifikatës të lëshuara nga DPD-ja për detarët që kërkojnë njohjen e certifikatave të tyre ose punësimin në bordin e anijes.

#### Neni 11

##### Rivlerësimi i certifikatave

1. Me qëllim vazhdimin e kualifikimit për shërbimin në det, çdo kapiten, oficer dhe operator i radiokomunikimit që mban një certifikatë të lëshuar ose të njohur në përputhje me një nga krerët e shtojcës I, përveç kreut VI, dhe i cili, është duke kryer shërbimin në det ose synon ta rinisë atë pas një periudhe shkëputjeje, duhet në intervale jo më shumë se pesë vite:

a) të përmbushë kriteret e përshtatshmërisë shëndetësore të parashikuara në nenin 9 dhe

b) të vërtetojë se vazhdon të zotërojë kompetencën profesionale në përputhje me seksionin A-I/11 të kodit STCW.

2. Për të vazhduar shërbimin në det në bordin e anijeve për të cilat janë aprovuar në nivel ndërkombëtar kërkesa të veçanta trajnimi, çdo kapiten, oficer dhe operator i radiokomunikimit duhet të përfundojë me sukses trajnimin përkatës të miratuar.

3. Me qëllim shërbimin e vazhdueshëm në det në bordin e anijeve cisternë, çdo kapiten dhe oficer përmbush kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni dhe është i detyruar, në intervale jo më shumë se pesë

vite, të vërtetojë se vazhdon të zotërojë kompetencën profesionale për anijet cisternë në përputhje me paragrafin 3 të seksionit A-I/11 të kodit STCW.

4. Drejtoria e Përgjithshme Detare krahason standardet e kompetencës që u kërkohej kandidatëve për certifikatat e kompetencës të lëshuara deri më 1 janar 2017 me ato të specifikuara për certifikatën përkatëse të kompetencës në pjesën A të kodit STCW, dhe përcakton nevojën për t'u kërkuar mbajtësve të këtyre certifikatave të kompetencës që t'u nënshtrohen trajnimeve përkatëse riaftësuese dhe përditësuese apo rivlerësimit.

5. Ministria përgjegjëse për transportin, nëpërmjet DPD-s, sigurohet që qendrat e licencuara për trajnimin e detarëve të përmbushin të gjitha kriteret profesionale dhe teknike për delegimin e njohurive teorike dhe praktike, siç parashikohet në seksionin A-I/11 të kodit STCW.

6. Me qëllim përditësimin e njohurive për kapitenët, oficerët dhe operatorët e radiokomunikimit, Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton që tekstet e ndryshimeve të fundit në rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det dhe për mbrojtjen e mjedisit detar t'u vihen në dispozicion Kompanive të Menaxhimit të anijeve me flamur shqiptar.

#### Neni 12

##### Përdorimi i simulantëve

1. Është e nevojshme që të zbatohen standardet e performancës dhe dispozitat e tjera të seksionit A-I/12 të kodit STCW, si dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në pjesën A të kodit STCW për të gjitha certifikatat në fjalë, në lidhje me:

a) të gjitha trajnimet e detyrueshme të kryera me anë të simulatorëve;

b) të gjitha vlerësimet e kompetencës që kërkohej sipas pjesës A të Kodit STCW, që kryhen me anë të një simulatori;

c) çdo vërtetim, me anë të një simulatori, të vazhdimin të zotërimit të kompetencave që kërkohej sipas pjesës A të kodit STCW.



## Neni 13

**Përgjegjësitë e kompanisë së menaxhimit**

1. Në përputhje me nenet 3 dhe 6, Drejtoria e Përgjithshme Detare u ngarkon kompanive të menaxhimit përgjegjësinë e pranimit të detarëve për shërbim në anijet e tyre, në përputhje me këtë rregullore, si dhe i kërkojnë çdo kompanie të garantojë që:

(a) çdo detar i pranuar në cilëndo prej anijeve të saj (me flamur shqiptar) është i pajisur me një certifikatë të posaçme në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje

(b) anijet e saj (me flamur shqiptar) janë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të shtetit shqiptar për personelin minimal për lundrim të sigurt;

(c) dokumentacioni dhe të dhënat që lidhen me të gjithë detarët e pranuar në anijet e saj (me flamur shqiptar) janë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, si dhe përfshijnë, por pa u kufizuar me, dokumentacionin dhe të dhënat mbi përvojën e tyre, trajnimin, përshtatshmërinë shëndetësore dhe kompetencën në detyrat e caktuara;

(d) detarët që pranohen në anijet e tyre (me flamur shqiptar) janë të familjarizuar me detyrat e tyre specifike dhe me të gjitha rregullat, instalimet, pajisjet, procedurat dhe karakteristikat e anijes që lidhen me detyrat e tyre rutinë ose emergjente;

(e) ekuipazhi i anijes mund t'i koordinojë në mënyrë efektive veprimtaritë gjatë situatave emergjente dhe gjatë realizimit të detyrave me rëndësi jetësore për sigurinë ose për parandalimin apo reduktimin e ndotjes.

(f) detarët e pranuar në cilëndo prej anijeve të saj u janë nënshtruar trajnimeve riaftësuese dhe përditësuese, sipas kërkesave të Konventës STCW;

(g) në bordin e anijeve të saj ka në çdo kohë një komunikim verbal efikas, në përputhje me paragrafët 3 dhe 4, të kreut V, të rregullores 14 të SOLAS 74, në versionin e saj të ndryshuar.

2. Të gjitha kompanitë e menaxhimit, kapitenët dhe anëtarët e ekuipazhit janë përgjegjës për të garantuar që detyrimet e përcaktuara në këtë nen të zbatohen plotësisht dhe që të merren masa të tjera të nevojshme për të garantuar që çdo anëtar i ekuipazhit të japë një kontribut të vlefshëm dhe të informuar për operimin e sigurt të anijes.

3. Kompania e menaxhimit i jep udhëzime me shkrim kapitenit të çdo anijeje për të cilën zbatohet

kjo rregullore duke përcaktuar politikat dhe procedurat që duhet të ndiqen për të garantuar që të gjithë detarëve që sapo janë pranuar në bordin e anijes t'u jepet, përpara caktimit të detyrave, një mundësi për t'u njohur me pajisjet në anije, procedurat operative dhe masat e tjera të nevojshme për realizimin siç duhet të këtyre detyrave. Këto politika dhe procedura përfshijnë:

(a) përcaktimin e një periudhe të arsyeshme kohore gjatë së cilës çdo detar i punësuar rishtas do të ketë mundësinë të njihet me:

pajisjet specifike që do të përdoren ose operohen nga vetë ai; dhe

procedurat dhe rregullat specifike të vrojtimit, sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe emergjencës për anijet, të cilat detarët duhet t'i njohin me qëllim realizimin në mënyrë sa më të saktë të detyrave të caktuara;

(b) përcaktimin e një anëtari të mirinformuar të ekuipazhit, i cili do të jetë përgjegjës për të garantuar që çdo detar i punësuar rishtas të ketë mundësinë të marrë informacionet bazë në një gjuhë që ai e kupton.

4. Kompanitë e menaxhimit garantojnë që kapitenët, oficerët dhe pjesa tjetër e personelit të cilëve u janë caktuar detyra dhe përgjegjësi specifike në bordin e anijeve Ro-Ro të pasagjerëve kanë përfunduar trajnimin parapërgatitor për të fituar aftësitë e nevojshme për funksionin përkatës dhe për detyrat e përgjegjësitë që do të ndërmerren, duke marrë në konsideratë udhëzimet në seksionin B I/14 të kodit STCW.

## Neni 14

**Aftësia për punë**

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare me qëllim parandalimin e lodhjes:

(a) përcakton dhe kërkon të zbatohen periudha pushimi për personelin e vrojtimit dhe për personelin detyrat e të cilëve përfshijnë mbrojtjen, sigurinë dhe parandalimin e ndotjes, në përputhje me paragrafët 3 deri në 13 të këtij neni;

(b) kërkon që sistemet e vrojtimit të jenë të tilla që të mos e ulin efikasitetin e personelit për shkak të lodhjes dhe që detyrat të organizohen në mënyrë të tillë që vrojtuesi në fillim të lundrimit dhe vrojtuesit pasues të jenë të çlodhur dhe të aftë për punë.



2. Për qëllimet e parandalimit të abuzimit me drogën dhe alkoolin, Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton marrjen e masave të përshtatshme në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë nen.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare merr parasysh rrezikun që paraqet lodhja e detarëve, veçanërisht të atyre detyrave të cilat përfshijnë operimin e sigurt të anijes.

4. Të gjithë personave të ngarkuar me detyrën e oficerit të vrojtimit apo të marinarit pjesë e ekipit të vrojtimit dhe personave detyrat e të cilëve përfshijnë mbrojtjen, sigurinë dhe parandalimin e ndotjes u lejohej një periudhë pushimi prej jo më pak se:

a) 10 orë pushimi gjatë çdo periudhe 24-orëshe; dhe

b) 77 orë në çdo periudhë shtatë ditore.

5. Orët e pushimit mund të ndahen në jo më shumë se dy periudha, njëra prej të cilave ka një kohëzgjatje të paktën prej gjashtë orësh dhe intervalet ndërmjet periudhave të njëpasnjëshme të pushimit nuk janë më të gjata se 14 orë.

6. Kërkesat në lidhje me periudhat e pushimit të përcaktuara në paragrafët 4 dhe 5 nuk është nevoja të përmbushen në raste emergjencash apo në kushte të tjera të jashtëzakonshme. Mbledhjet e ekuipazhit, ushtrimet e fikjes së zjarrit dhe të shpëtimit të jetës si dhe ushtrimet e parashikuara nga ligjet dhe rregulloret e brendshme dhe nga instrumentet ndërkombëtare kryhen në mënyrë të tillë që të minimizojë ndërprerjen e periudhave të pushimit dhe të mos shkaktojnë lodhje.

7. Drejtoria e Përgjithshme Detare kërkon që programet e vrojtimit të afishohen në vende ku të jenë lehtësisht të aksesueshme. Për këto programe përdoret një format i standardizuar në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën angleze.

8. Në rast se detarët thirren në detyrë, si për shembull kur lokali i makinerisë është i pambikëqyrrur, duke ndërprerë kështu periudhën normale të pushimit ata marrin një periudhë kompensuese e të përshtatshme pushimi.

9. Drejtoria e Përgjithshme Detare kërkon regjistrimin e orëve të pushimit të përditshëm të detarëve në një format të standardizuar, në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën angleze, për të mundësuar monitorimin dhe verifikimin e përputhshmërisë me këtë nen. Detarët marrin një kopje të të dhënave

personale, të nënshkruar nga kapiteni ose nga një person i autorizuar nga ky i fundit.

10. Pavarësisht nga rregullat e përcaktuara në paragrafët 3 deri në 9, kapiteni i anijes ka të drejtë t'u kërkojë detarëve që të kryejnë sipas nevojës, orë pune shtesë për qëllimin e sigurisë së anijes, të personave në bord ose të ngarkesës, ose për të siguruar ndihmë për anijet e tjera apo personat në rrezik në det. Në bazë të sa më sipër, kapiteni mund ta pezullojë programin e orëve të pushimit dhe t'u kërkojë detarëve të kryejnë orët e nevojshme shtesë deri në kthimin e gjendjes në normalitet. Pas rivendosjes së situatës normale, kapiteni sigurohet që çdo detar që ka qenë në shërbim gjatë një periudhe të programuar pushimi, të marrë sa më parë të jetë e mundur, një periudhë kompensuese pushimi.

11. Duke respektuar parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve, Drejtoria e Përgjithshme Detare në bazë të ligjeve, rregulloreve të brendshme ose një procedure për autoritetin kompetent, mund të autorizojnë ose të regjistrojnë marrëveshje kolektive që lejojnë përjashtime për orët e pushimit të parashikuara në germën "b", të paragrafit 4 dhe në paragrafin 5, të këtij neni, me kusht që periudha e pushimit të jetë jo më pak se 70 orë gjatë çdo periudhe shtatë ditore dhe të respektojë kufijtë e përcaktuar në paragrafët 12 dhe 13 të këtij neni. Këto përjashtime duhet të respektojnë, sa më shumë të jetë e mundur, standardet e përcaktuara, por mund të marrin në konsideratë edhe dhënien e periudhave më të shpeshta apo më të gjata të lejeve, ose dhënien e lejeve kompensuese për detarët përgjegjës për vrojtimin ose detarët që punojnë në bordin e anijeve që kryejnë lundrime të shkurtra. Përjashtimet marrin në konsideratë, sa më shumë të jetë e mundur, udhëzimet në lidhje me parandalimin e lodhjes të përcaktuara në seksionin B-VIII/1 të kodit STCW. Nuk lejohen përjashtime nga minimumi i orëve të pushimit të parashikuara në germën "a", të paragrafit 4, të këtij neni.

12. Përjashtimet e përmendura në paragrafin 11 për periudhën e pushimit javor të parashikuar në germën "b" të paragrafit 4 nuk mund të zgjasin më shumë se dy javë të njëpasnjëshme. Intervalet ndërmjet dy periudhave të përjashtimeve në bord nuk janë më pak se dyfishi i kohëzgjatjes së përjashtimit.



13. Në kuadër të përjashtimeve të mundshme nga paragrafi 5, të përmendura në paragrafin 11, minimumi i orëve të pushimit për çdo periudhë 24-orëshe të parashikuar në germën “a” të paragrafit 4 mund të ndahet në jo më shumë se tre periudha pushimi, njëra prej të cilave ka një kohëzgjatje prej të paktën gjashtë orësh dhe dy të tjerat kanë një kohëzgjatje prej jo më pak se një orë. Intervalet ndërmjet periudhave të njëpasnjëshme të pushimit nuk janë më të gjata se 14 orë. Përjashtimet kufizohen në dy periudha 24-orëshe në çdo periudhë shtatë ditore.

14. Kufiri deri në 0,05% të nivelit të alkoolit në gjak (B, A, C) apo 0,25 mg/l në frymë ose një sasi alkooli me të njëjtin përqendrim për kapitenët, oficerët dhe detarët e tjerë gjatë kryerjes së detyrave të caktuara në lidhje me mbrojtjen, sigurinë dhe mjedisin detar përbën kufirin maksimal të nivelit të alkoolit në gjak.

#### Neni 15 Lejet

1. Në rast se është jashtëzakonisht e domosdoshme dhe nëse në gjykimin e DPD-së nuk përbën rrezik për personat, pronën apo mjedisin, kjo e fundit mund të lëshojë një leje për një periudhë të caktuar kohore jo më shumë se gjashtë muaj për ushtrimin e një funksioni të caktuar, përveç atij të operatorit të radiokomunikimit, përveçse kur parashikohet nga rregulloret përkatëse të radiokomunikimit, për të cilin nuk disponohet certifikata e posaçme, me kusht që personi të cilit i lëshohet kjo leje të ketë kualifikimin e duhur për ushtrimin në mënyrë të sigurt të detyrës në pozicionin vakant, duke përmbushur kërkesat e autoriteteve kompetente. Për kapitenin apo për kryeinxhinierin mekanik lejet lëshohen vetëm në rast të forcave madhore dhe për një periudhë sa më të shkurtër.

2. Lejet për pozicione të caktuara u lëshohen vetëm personave të certifikuar përkatësisht për ushtrimin e funksioneve një nivel më poshtë për nga rëndësia. Nëse për funksionin një nivel më poshtë për nga rëndësia nuk kërkohet certifikim, leja mund t'i lëshohet një personi, kualifikimi dhe përvoja e të cilit, sipas opinionit të DPD-së, janë ekuivalente me kërkesat për pozicionin vakant, me kusht që nëse personi nuk është i pajisur me një certifikatë të posaçme t'i kërkohet që t'i

nënshtrohet një testi të njohur nga DPD-ja për të siguruar se lëshimi i lejes nuk paraqet rrezik. Gjithashtu, DPD-ja sigurohet që në pozicionin në fjalë të caktohet sa më parë një person i certifikuar përkatësisht.

#### Neni 16

#### Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme Detare

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare është institucioni përgjegjës, për:

- a) miratimin e lejes për ushtrimin e aktivitetit të trajnimit të detarëve nga subjektet e licencuara.
  - b) mbikëqyrjen e trajnimit të detarëve kur është e nevojshme;
  - c) organizimin e testeve të detarëve që kanë përfunduar trajnimin;
  - d) lëshimin e certifikatave të përmendura në nenin 4;
  - e) lëshimin e lejeve të parashikuara në nenin 15.
2. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton, që:

- a) trajnimi dhe vlerësimi i detarëve:
  - i. të jetë plotësisht i strukturuar në përputhje me programet e shkruara, duke përfshirë metodat dhe mënyrat e zhvillimit, procedurat dhe materialet e kursit që janë të nevojshme për arritjen e standardit të parashikuar të kompetencës; dhe
  - ii. të zhvillohet, monitorohet, vlerësohet dhe mbështetet nga persona të kualifikuar në përputhje me germat “d”, “e” dhe “f”, të pikës 2;
- b) personat që kryejnë trajnimin apo vlerësimin gjatë shërbimit në bordin e anijes ta bëjnë këtë vetëm nëse trajnimi ose vlerësimi nuk ndikon negativisht në operimin normal të anijes, dhe që ata të mund t'i kushtojnë kohë dhe vëmendje trajnimit ose vlerësimit;

c) trajnuesit, mbikëqyrësit dhe vlerësuesit të jenë të kualifikuar përkatësisht për llojet dhe nivelet e veçanta të trajnimit ose vlerësimit të kompetencave të detarëve, qoftë në bord apo në breg;

d) çdo person që zhvillon trajnimin e detarëve gjatë shërbimit, në bordin e anijes ose në breg, që synohet të përdoret për t'u kualifikuar për certifikim në zbatim të kësaj rregullore:

- i. ta kuptojë programin e trajnimit dhe objektivat specifike të trajnimit për llojin e veçantë të trajnimit që po zhvillohet;
- ii. të jetë i kualifikuar për detyrën për të cilën zhvillohet trajnimi; dhe



iii. nëse trajnimi zhvillohet me anë të një simulatori;

iv. të ketë marrë udhëzimet e duhura për teknikat udhëzuese që përfshijnë përdorimin e simulatorëve; dhe

v. të ketë fituar përvojë pune praktike për llojin e veçantë të simulatorit në përdorim;

e) çdo person përgjegjës për mbikëqyrjen e trajnimit të një detari gjatë shërbimit, që synohet të përdoret për t'u kualifikuar për certifikim, të ketë njohuri të shkëlqyera të programit të trajnimit dhe objektivave specifike për secilin nga llojet e trajnimit që zhvillohen;

f) çdo person që zhvillon trajnimin e detarëve gjatë shërbimit, në bordin e anijes ose në breg, që synohet të përdoret për t'u kualifikuar për certifikim në zbatim të kësaj rregullore:

i. të ketë nivelin e duhur të njohurive dhe të të kuptuarit të kompetencave që do të vlerësohen;

ii. të jetë i kualifikuar në detyrën për të cilën kryhet vlerësimi;

iii. të ketë marrë udhëzimet përkatëse për metodat dhe praktikën e vlerësimit;

iv. të ketë fituar përvojë praktike në vlerësim; dhe

v. nëse kryerja e vlerësimit përfshin përdorimin e simulatorëve, të ketë fituar përvojë praktike në vlerësim për llojin e veçantë të simulatorit, nën mbikëqyrjen e një vlerësuesi me përvojë dhe duke përmbushur kërkesat e këtij të fundit;

g) kur Drejtoria e Përgjithshme Detare e një kurs apo institucion trajnimi ose një kualifikim të dhënë nga një institucion trajnimi, kualifikimet dhe përvoja e trajnuesve dhe vlerësuesve të trajtohen nga dispozitat e nenit 8 për zbatimin e standardeve të cilësisë; këto kualifikime, përvoja dhe zbatimi i standardeve të cilësisë përfshijnë një trajnim të posaçëm për teknikat udhëzuese dhe për metodat dhe praktikën e trajnimit dhe vlerësimit, si dhe janë në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të paragrafëve “d”, “e” dhe “f”, të pikës 2.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare siguron, që:

(a) i gjithë procesi i trajnimit dhe vlerësimit të detarëve është:

i. i strukturuar në përputhje me programet e shkruara, duke përfshirë metoda dhe mjete të shpërndarjes, procedura dhe materiale të kursit të nevojshme për të arritur standardet e përcaktuara të aftësisë; dhe

ii. i drejtuar, monitoruar, vlerësuar dhe mbështetur nga persona të kualifikuar në përputhje me paragrafët “d”, “e” dhe “f”, të pikës 3;

(b) personat që drejojnë trajnimin ose vlerësimin gjatë shërbimit në bordin e anijes e bëjnë këtë vetëm në rastet kur ky trajnim apo vlerësim nuk ndikon negativisht në funksionimin normal të anijes dhe ato mund t'i kushtojnë kohën dhe vëmendjen e tyre procesit të trajnimit apo vlerësimit;

(c) instruktorët, mbikëqyrësit dhe vlerësuesit janë të kualifikuar siç duhet për llojin dhe nivelin e veçantë të trajnimit apo vlerësimit të aftësisë së detarëve në bord ose në breg;

(d) çdo person që drejton trajnimin e detarëve gjatë shërbimit, në bord ose në breg, që ka për qëllim të përdoret në kualifikimin për certifikim sipas parashikimeve të kësaj rregullore:

i. ka vlerësimin e programit të trajnimit dhe mirëkuptimin e objektivave specifike të trajnimit për llojin e veçantë të trajnimit që kryhet;

ii. është i kualifikuar në detyrën për të cilën kryhet trajnimi; dhe

iii. nëse gjatë procesit të trajnimit përdoret simulanti:

- ka marrë udhëzimin e duhur në teknikat mësimore që përfshijnë përdorimin e simulantëve; dhe

- ka fituar përvojë praktike në llojin e veçantë të simulantit që përdoret.

(e) Çdo person përgjegjës për mbikëqyrjen e trajnimit të detarëve gjatë shërbimit që ka për qëllim të përdoret në kualifikimin për certifikim, ka njohuri të plotë të programit të trajnimit dhe objektivave specifike për çdo lloj trajnimi që kryhet;

(f) Çdo person që drejton vlerësimin e aftësisë së detarit gjatë shërbimit, në bord ose në breg, që ka për qëllim të përdoret në kualifikimin për certifikim:

i. ka nivelin e duhur të njohurisë dhe kuptimit të aftësisë që vlerësohet;

ii. është i kualifikuar në detyrën për të cilën bëhet vlerësimi;

iii. ka marrë udhëzimin e duhur në metodat dhe praktikën e vlerësimit;

iv. ka fituar përvojë praktike të vlerësimit; dhe

v. nëse kryerja e vlerësimit përfshin përdorimin e simulantëve, ka fituar përvojë praktike të vlerësimit në llojin e veçantë të simulantit sipas



mbikëqyrjes dhe me pëlqimin e vlerësuesit me përvojë.

(g) Kur Drejtoria e Përgjithshme Detare njih një kurs trajnimi, një institucion trajnimi, ose një kualifikim të ofruar nga një institucion trajnimi, si pjesë e kërkesave për lëshimin e certifikatës, kualifikimet dhe përvoja e instruktorëve dhe vlerësuesve mbulohen nga zbatimi i dispozitave të cilësisë së standardeve të nenit 8. Ky kualifikim, kjo përvojë, si dhe zbatimi i standardeve të cilësisë përfshin trajnimin e duhur në teknikat mësimore si dhe metodat dhe praktikat e trajnimit dhe vlerësimit dhe është në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të paragrafëve “d”, “e” dhe “f”, të pikës 3.

Neni 17

### **Komunikimi në bord**

Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton, që:

(a) Pa cenuar germat “b” dhe “d”, në bordin e të gjitha anijeve që mbajnë flamurin Shqiptar të ketë në çdo kohë mjete për një komunikim verbal efikas në lidhje me sigurinë ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekuipazhit të anijes, veçanërisht në lidhje me marrjen dhe kuptimin në kohë dhe në mënyrë të saktë të mesazheve dhe udhëzimeve;

(b) Me qëllim garantimin e efikasitetit të performancës së ekuipazhit në çështjet e sigurisë, në bordin e të gjitha anijeve të pasagjerëve që mbajnë flamurin Shqiptar, gjuha e punës do të jetë gjuha shqipe dhe/ ose angleze dhe komunikimi do të regjistrohet në ditarin e anijeve.

Gjuha e duhur e punës përcaktohet nga shoqëria ose kapiteni, sipas rastit; çdo detar është i detyruar të kuptojë dhe, sipas rastit, të japë urdhra dhe udhëzime dhe të raportojë në këtë gjuhë;

Nëse gjuha e punës nuk është vetëm gjuha shqipe, të gjitha planet dhe listat që duhet të afishohen duhet të përfshijnë përkthimet edhe në atë gjuhë.

(c) Në bordin e anijeve të pasagjerëve, personeli i caktuar në rolin e ekuipazhit që do të ndihmojë pasagjerët në situata emergjence të jetë lehtësisht i identifikueshëm dhe të ketë aftësi të mjaftueshme komunikimi për këtë qëllim, duke marrë parasysh një kombinim të përshtatshëm të secilit prej faktorëve të mëposhtëm:

gjuha ose gjuhët që i përshtaten kombësive të pjesës më të madhe të pasagjerëve që janë duke udhëtuar në një itinerar të caktuar;

gjasat që aftësia e përdorimit të një niveli elementar të gjuhës angleze për udhëzimet bazë mund të përbëjë një mjet komunikimi me pasagjerët që kanë nevojë për ndihmë, pavarësisht nëse pasagjerët ose anëtarët e ekuipazhit flasin ose jo të njëjtën gjuhë;

nevoja e mundshme për të përdorur mënyra të tjera komunikimi gjatë emergjencave (p.sh. mjetet vizuale ndihmëse, gjestet me duar ose tregimin e vendndodhjes së udhëzimeve, vendeve të grumbullimit, pajisjeve të shpëtimit të jetës ose rrugëve të evakuimit) atëherë kur komunikimi verbal është i papërshtatshëm;

shkalla në të cilën pasagjerëve u janë dhënë udhëzime të plota për sigurinë në gjuhën ose gjuhët e tyre amtare;

gjuhët që mund të përdoren për njoftimet në rastet e emergjencave apo të ushtrimeve për t’u dhënë pasagjerëve udhëzime thelbësore, si dhe për t’ua lehtësuar anëtarëve të ekuipazhit dhënien e ndihmës për pasagjerët;

(ç) në bordin e anijeve cisternë, anijeve cisternë për substanca kimike dhe anijeve cisternë për gaze të lëngshme që mbajnë flamurin shqiptar, kapiteni, oficerët dhe marinarët të jenë në gjendje të komunikojnë me njëritjetrin në gjuhët e përbashkëta të punës;

(d) të disponohen mjetet e duhura për komunikimin ndërmjet anijes dhe autoriteteve në tokë; këto komunikime kryhen në përputhje me kreun V, rregullorja 14, paragrafi 4, të SOLAS 74.

Neni 18

### **Njohja e certifikatave të kompetencës dhe e certifikatave të kualifikimit**

1. Detarët me shtetësi të huaj që nuk zotërojnë certifikata kompetence dhe/ose kualifikimi të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për kapitenët dhe oficerët në përputhje me rregulloret V/1-1 dhe V/1-2 të Konventës STCW, mund të autorizohen për të kryer shërbimin në anije me flamur shqiptar me kusht që të jetë miratuar një vendim për njohjen e certifikatave të tyre të kompetencës dhe certifikatave të kualifikimit nëpërmjet procedurave të përcaktuara në paragrafët 2 deri në 6 të këtij neni.

2. Nëse Drejtoria e Përgjithshme Detare synon të njohë, nëpërmjet konvertimit, certifikatat e kompetencës dhe/ose certifikatat e kualifikimit të



përmendura në paragrafin 1, të cilat u janë lëshuar nga një vend tjetër kapitenëve, oficerëve ose operatorëve të radiokomunikimit për shërbim në anijet që mbajnë flamurin shqiptar, duhet të ketë marrëveshje me vendin që ka lëshuar certifikatën.

Administrata Detare Shqiptare, me mbështetjen e Agjencisë Evropiane për Sigurinë në Det dhe me përfshirjen e mundshme të çdo shteti, mbledh informacionin e përmendur në shtojcën II dhe kryen një vlerësim të sistemeve të trajnimit dhe certifikimit në vendin për të cilin është paraqitur kërkesa për njohje, për të verifikuar nëse vendi në fjalë i përmbush ose jo të gjitha kërkesat e Konventës STCW dhe nëse janë marrë masat e duhura për të parandaluar mashtrimet në lidhje me certifikatat.

3. Në lidhje me anijet që përbëhen nga ekuipazh shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të vendosë që të konvertojë certifikatat e lëshuara nga vendet e tjera duke marrë në konsideratë dispozitat e përfshira në shtojcën II, pikat 4 dhe 5.

4. Pavarësisht nenit 5, paragrafi 6, nëse është e nevojshme, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund t'i lejojë detarët që të ushtrojnë funksione të caktuara, përveç atij të oficerit apo operatorit të radiokomunikimit, përveçse kur parashikohet nga rregulloret përkatëse të radiokomunikimit, për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj në bordin e një anijeje që mban flamurin shqiptar, me kusht që këta detarë të jenë të pajisur me një certifikatë të vlefshme të lëshuar dhe të konvertuar në përputhje me kërkesat e një vendi tjetër, por ende të pakonvertuar, për t'u njohur nga shteti shqiptar, me qëllim kualifikimin për shërbim në bordin e një anijeje që mban flamurin shqiptar. Duhet të disponohet një dokument provë që vërteton se është paraqitur kërkesa për konvertim tek autoritetet kompetente.

Neni 19

### **Mosrespektimi i kërkesave të Konventës STCW**

1. Pavarësisht kriterëve të specifikuar në shtojcën II, kur Drejtoria e Përgjithshme Detare gjykon se një vend tjetër me të cilin ka marrëveshje nuk vazhdon t'i përmbushë kërkesat e Konventës STCW, ai njofton menjëherë vendin duke dhënë arsyet e argumentuara.

2. Kur Drejtoria e Përgjithshme Detare synon të revokojë konvertimet (*flag endorsementet*) për të gjitha certifikatat e lëshuara nga një vend tjetër, njofton këtë të fundit, duke dhënë arsye të argumentuara.

3. Në rastet kur ka tregues se një institucion i caktuar i trajnimit detar nuk vazhdon t'i përmbushë kërkesat e Konventës STCW, Drejtoria e Përgjithshme Detare njofton vendin në fjalë se njohja e certifikatave të atij vendi do të revokohen brenda dy muajve, përveç nëse merren masa për të garantuar pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat e Konventës STCW.

4. Vendimi për revokimin e njohjes merret nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

5. Konvertimet (*flag endorsementet*) që vërtetojnë njohjen e certifikatave të lëshuara në përputhje me nenin 4, paragrafi 6 përpara datës në të cilën merret vendimi për revokimin e njohjes së vendit tjetër mbeten të vlefshme. Megjithatë, detarët e pajisur me këto lloj konvertimesh (*flag endorsement*) nuk mund të paraqesin kërkesë për konvertime (*flag endorsement*) në lidhje me kualifikime më të larta, përveç nëse kjo kërkesë bazohet vetëm në përvojën shtesë në shërbimin detar.

Neni 20

### **Rivlerësimi**

Vendet që janë njohur nga DPD-ja sipas procedurës së nenit 18 paragrafi 2, do t'ju kërkohet, çdo 5 vjet, të rivlerësohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, për të verifikuar nëse përmbushin kriteret përkatëse të përcaktuara në aneksin II dhe nëse janë marrë masat e duhura për të parandaluar lëshimin e certifikatave mashtruese.

Neni 21

### **Kontrolli Shtetëror i Flamurit**

1. Çdo anije me flamur shqiptar, me përjashtim të llojeve të përjashtuara nga neni 2, gjatë kohës që ndodhet në portet e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohet kontrollit shtetëror të flamurit nga inspektorët e KSHF-së për të verifikuar që të gjithë detarët që kryejnë shërbimin në bord, të cilët duhet të mbajnë një certifikatë kompetence dhe/ose kualifikimi dhe/ose një dokument provë sipas Konventës STCW, të jenë të pajisur me këtë certifikatë kompetence apo leje të vlefshme dhe/ose certifikatë kualifikimi dhe/ose dokument provë;





2. Gjatë inspektimit nga KSHF-ja duhet që të zbatohen të gjitha dispozitat dhe procedurat përkatëse të parashikuara në rregulloren e KSHF-së.

#### Neni 22 Ndalimi

Pa cenuar rregulloren e Kontrollit Shtetëror të Flamurit, mospërputhjet e mëposhtme, nëse inspektorët e KSHF-së dalin në përfundimin se ato përbëjnë rrezik për personat, pronën ose mjedisin, do të konsiderohen arsye që sipas kësaj Rregulloreje të ligjërojnë ndalimin e anijeve:

a) pamundësia e detarëve për t'u pajisur me certifikata të posaçme apo me leje të vlefshme, ose për të siguruar një dokument që provon aplikimin për konvertimin pranë autoriteteve të shtetit të flamurit;

b) mospërmbushja e kërkesave të zbatueshme për personelin minimal për lundrim të sigurt;

c) mospërmbushja e kërkesave të specifikuara për anijen gjatë vrojtimit të lundrimit ose të motorit;

d) mungesa e një personi të kualifikuar për përdorimin e pajisjeve thelbësore për lundrimin e sigurt, për radiokomunikimet e sigurisë ose për parandalimin e ndotjes në ambientin detar;

e) paaftësia për të provuar profesionalizmin lidhur me detyrat që u janë caktuar detarëve për sigurinë e anijes dhe parandalimin e ndotjes;

f) pamundësia për të caktuar në vrojtimit e parë në fillim të udhëtimit dhe në vrojtimit pasuese persona që janë të çlodhur dhe në gatishmëri.

#### Neni 23 Informacionet për qëllime statistikore

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare i komunikon Ministrisë përgjegjëse për transportin informacionin e renditur në shtojcën III vetëm për qëllimin e analizave statistikore. Ky informacion mund të përdoret vetëm nga administrata detare në politik bërje dhe jo për qëllime administrative, ligjore ose verifikimi.

2. Ky informacion i vihet në dispozicion ministrisë përgjegjëse për transportin çdo vit në formë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, dhe përfshin të dhënat e regjistruara deri më 31 dhjetor të vitit të mëparshëm. Drejtoria e

Përgjithshme Detare i ruan të drejtat e pronësisë së këtij informacioni në formën e të dhënave të papërpunuara.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Ministria përgjegjëse për transportin garantojnë që masat për mbledhjen, dorëzimin, ruajtjen, analizimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni të jenë hartuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë kryerjen e analizave statistikore.

#### Neni 24 Sanksionet

Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton sisteme sanksionesh për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara sipas neneve 3, 5, 6, 7, 8 deri në 13, 14, 15, 17, 21 dhe sipas shtojcës I, si dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e tyre. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.

#### Neni 25 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### ANEKS I KËRKESAT E TRAJNIMIT TË KONVENTËS STCW, REFERUAR NË NENIN 3

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Rregulloret e përmendura në këtë aneks plotësohen nga dispozitat e detyrueshme që përfshihen në pjesën A të kodit STCW, me përjashtim të kreut VIII, rregullorja VIII/2. Çdo referencë ndaj kërkesave të rregulloreve përbën gjithashtu një referencë ndaj seksionit përkatës të pjesës A të kodit STCW.

Drejtoria e Përgjithshme Detare sigurohet se detarët posedojnë aftësinë e saktë gjuhësore, përcaktuar në pjesët A-II/1, A-III/1, A-IV/2 dhe A-II/4 të Kodit STCW, duke i mundësuar ato të kryejnë detyrat e tyre të veçanta në anijen që mban flamurin shqiptar.

2. Pjesa A e kodit STCW përmban standardet e kompetencës që duhet të dëshmojnë nga



kandidatët me qëllim lëshimin dhe rivlerësimin e certifikatave të kompetencës sipas dispozitave të Konventës STCW. Për të qartësuar lidhjen midis dispozitave alternative të certifikimit në kreun VII dhe dispozitave për certifikimin në krerët II, III dhe IV, aftësitë e specifikuara në standardet e kompetencës grupohen sipas rastit në bazë të shtatë funksioneve të mëposhtme:

- a) lundrimi;
- b) trajtimi dhe magazinimi i ngarkesave;
- c) kontrolli i operimit të anijes dhe kujdesi ndaj personave në bordin e saj;
- d) inxhinieria navale;
- e) inxhinieria elektrike, elektronike dhe operimi i pajisjeve të kontrollit;
- f) mirëmbajtja dhe riparimi;
- g) radiokomunikimet në nivelet e mëposhtme të përgjegjësive:
- h) nivel menaxhimi;
- i) nivel operacional
- j) nivel mbështetës.

Funksionet dhe nivelet e përgjegjësive identifikohen me anë të nëntitullit në tabelat e standardeve të kompetencës të përcaktuara në krerët II, III dhe IV të pjesës A, të kodit STCW.

## KREU II KAPITENI DHE SEKTORI I KUVERTËS

### Rregullorja II/1

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e oficerëve të kuvertës (nivel operacional) përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në anijet me tonazh bruto 500 tonë ose më shumë**

1. Çdo oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit, që shërben në një anije që lundron në det me tonazh bruto 500 tonë ose më shumë është i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 ka kryer shërbim të aprovuar në det për jo më pak se 12 muaj si pjesë e një programi të aprovuar trajnimi, ku përfshihet edhe trajnimi në bordin e anijes, i cili plotëson kërkesat e seksionit A-II/1 të kodit STCW dhe është i dokumentuar në pasaportën e trajnimit në bord, ose ka kryer shërbim 36 muaj në det të dokumentuar në pasaportën e detarit (matrikull);

2.3 ka qenë, gjatë shërbimit të detyrueshëm në det, përgjegjës për vrojtimin në urë nën mbikëqyrjen e kapitenit ose një oficeri të kualifikuar, për një periudhë prej jo më pak se gjashtë muaj;

2.4 përmbush kërkesat e zbatueshme të rregulloreve në kreun IV, sipas rastit, për kryerjen e detyrave të caktuara të radiokomunikimit në përputhje me rregulloret përkatëse;

2.5 të kenë përfunduar arsimin përkatës dhe trajnimin e miratuar dhe të përmbushin standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/1 të Kodit STCW; dhe

2.6 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në paragrafin 2 të seksionit A-VI/1, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/2, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 dhe në paragrafët 1 deri në 3 të seksionit A-VI/4 të kodit STCW.

### Rregullorja II/2

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e kapitenëve dhe oficerëve të parë në anijet me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë**

Kapiteni dhe oficeri i parë në anijet me tonazh bruto prej 3000 tonësh ose më shumë

1. Çdo kapiten dhe oficer i parë në anijet që lundrojnë në det me tonazh bruto prej 3000 tonësh ose më shumë duhet të jetë i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 përmbush kërkesat për certifikimin si oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në anije me tonazh bruto prej 500 tonësh ose më shumë dhe ka kryer shërbim të aprovuar në det në këtë funksion:

2.1.1 për jo më pak se 12 muaj për certifikimin si oficer i parë; dhe

2.1.2 për jo më pak se 36 muaj për certifikimin si kapiten; megjithatë, kjo periudhë mund të reduktohet në jo më pak se 24 muaj nëse të paktën për 12 muaj ka shërbyer në funksionin e oficerit të parë; dhe

2.2 kanë përfunduar arsimin përkatës dhe trajnimin e miratuar dhe plotësojnë standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/2 të Kodit STCW për kapitenët dhe oficerët në anijet me tonazh bruto 3 000 ose më shumë.



### **Kapiteni dhe oficeri i parë në anijet me tonazh bruto prej 500 deri në 3000 tonë**

3. Çdo kapiten dhe oficer i parë në anijet që lundrojnë në det me tonazh bruto prej 500 deri në 3000 tonë duhet të jenë pajisur me një certifikatë kompetence.

4. Çdo kandidat për certifikim:

4.1 për certifikimin si oficer i parë, përmbush kërkesat për oficerët përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në anije me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë;

4.2 për certifikimin si kapiten, përmbush kërkesat për oficerët përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në anije me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë dhe ka kryer shërbim të aprovuar në det për jo më pak se 36 muaj në këtë funksion; megjithatë, kjo periudhë mund të reduktohet në jo më pak se 24 muaj nëse të paktën për 12 muaj ka shërbyer në funksionin e oficerit të parë; dhe

4.3 ka përfunduar një trajnim të aprovuar dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/2 të kodit STCW për kapitenët dhe oficerët e parë në anijet me tonazh bruto prej 500 deri në 3000 tonë.

#### Rregullorja II/3

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e oficerëve përgjegjës për vrojtimin e lundrimit dhe të kapitenëve në anijet me tonazh bruto nën 500 tonë**

1. Çdo oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në një anije që lundron në det me tonazh bruto prej më pak se 500 tonë, e cila nuk angazhohet në lundrime afër brigjeve, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence për anijet me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë.

2. Çdo kapiten që shërben në një anije e cila lundron në det me tonazh bruto prej më pak se 500 tonë dhe e cila nuk angazhohet në lundrime afër brigjeve, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence për shërbimin në funksionin e kapitenit në anijet me tonazh bruto prej 500 deri në 3000 tonë.

**Anijet që angazhohen në lundrime afër brigjeve**

#### **Oficeri përgjegjës për vrojtimin e lundrimit**

3. Çdo oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në një anije që lundron në det me tonazh bruto prej më pak se 500 tonë, i cili angazhohet në

lundrime afër brigjeve, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence.

4. Çdo kandidat për certifikim si oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në një anije që lundron në det me një tonazh bruto prej më pak se 500 tonë, i cili angazhohet në lundrime afër brigjeve:

4.1 është të paktën 18 vjeç;

4.2 ka kryer:

4.2.1 shërbim të aprovuar në det në sektorin e kuvertës për jo më pak se 36 muaj;

4.2.2 përmbush kërkesat e zbatueshme të rregulloreve në kreun IV, sipas rastit, për kryerjen e detyrave të caktuara të radiokomunikimit në përputhje me rregulloret e radiokomunikimit;

4.3 të kenë përfunduar arsimin përkatës dhe trajnimin e miratuar dhe të përmbushin standardin e kompetencës të specifikuar në Seksionin A-II/3 të Kodit STCW për oficerët e ngarkuar me një vrojtim lundrimi në anije me më pak se 500 tonazh bruto të angazhuara në udhëtime afër bregdetit; dhe

4.5 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në paragrafin 2 të seksionit A-VI/1, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/2, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 dhe në paragrafët 1 deri në 3 të seksionit A-VI/4 të kodit STCW;

#### **Kapiteni**

5. Çdo kapiten që shërben në një anije e cila lundron në det me tonazh bruto prej më pak se 500 tonë dhe e cila angazhohet në lundrime afër brigjeve, është i pajisur me një certifikatë kompetence.

6. Çdo kandidat për certifikim si kapiten në një anije që lundron në det me tonazh bruto prej më pak se 500 tonë, e cila angazhohet në lundrime afër brigjeve:

6.1 është të paktën 20 vjeç;

6.2 ka kryer shërbim të aprovuar në det për jo më pak se 12 muaj, si oficer përgjegjës për vrojtimin e lundrimit;

6.3 të kenë përfunduar arsimin përkatës dhe trajnimin e miratuar dhe të përmbushin standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/3 të Kodit STCW për kapitenët e anijeve me më pak se 500 tonazh bruto të angazhuara në udhëtime afër bregdetit; dhe

6.4 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në paragrafin 2 të seksionit A-VI/1, në



paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/2, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 dhe në paragrafët 1 deri në 3 të seksionit A-VI/4 të kodit STCW.

### ***Përjashtimet***

7. Nëse gjykon se madhësia e anijes dhe kushtet e lundrimit të saj janë të tilla që e bëjnë të paarsyeshëm ose të pamundur zbatimin e kërkesave të plota të kësaj rregulloreje dhe të seksionit A-II/3 të kodit STCW, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund ta përjashtojë kapitenin dhe oficerin përgjegjës për vrojtimin e lundrimit në këtë anije ose kategori anijesh nga disa kërkesa, duke pasur parasysh sigurinë e të gjitha anijeve që mund të operojnë në të njëjtat ujëra.

### **Rregullorja II/4**

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e marinarëve që janë pjesë e ekipit të vrojtimit të lundrimit**

1. Çdo marinar që është pjesë e ekipit të vrojtimit të lundrimit në një anije që lundron në det me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë, përveç marinarëve nën trajnim dhe marinarëve detyrat e të cilëve nuk kërkojnë kualifikim të veçantë, është i certifikuar posaçërisht për kryerjen e këtyre detyrave.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 16 vjeç;

2.2 ka kryer:

2.2.1 shërbim të aprovuar në det, duke përfshirë jo më pak se gjashtë muaj trajnim dhe përvojë; ose

2.2.2 trajnim të posaçëm, para shërbimit ose në bordin e anijes, duke përfshirë një periudhë të aprovuar të shërbimit në det prej jo më pak se dy muaj; dhe

2.3 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/4 të kodit STCW.

3. Shërbimi në det, trajnimi dhe përvoja që kërkohen nga pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 lidhen me funksionet e vrojtimit të lundrimit dhe përfshijnë kryerjen e detyrave nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të kapitenit, oficerit përgjegjës për vrojtimin e lundrimit ose një marinar të kualifikuar.

Drejtorja e Përgjithshme Detare vlerëson se detarët kanë përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje në qoftë se ato kanë shërbyer në një funksion përkatës në sektorin e kuvertës për një periudhë jo më pak se 1 vit brenda 5 viteve të

fundit që i paraprin hyrjes në fuqi të Konventës STCW.

### **Rregullorja II/5**

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e marinarëve si marinar kuverte të kualifikuar**

1. Çdo marinar kuverte i kualifikuar që shërben në një anije që lundron në det me tonazh bruto prej 500 tonë ose më shumë është i pajisur me një certifikatë të posaçme.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 përmbush kërkesat për certifikimin si një marinar pjesë e ekipit të vrojtimit të lundrimit;

2.3 pas kualifikimit për shërbimin si marinar pjesë e ekipit të vrojtimit të lundrimit, ka kryer shërbim të aprovuar në det në sektorin e kuvertës për:

2.3.1 jo më pak se 18 muaj; ose

2.3.2 jo më pak se 12 muaj si dhe ka përfunduar një trajnim të aprovuar; dhe

2.4 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-II/5 të kodit STCW.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund t'i konsiderojë të përmbushura kërkesat e kësaj rregulloreje për detarët nëse ata kanë shërbyer në një nga funksionet përkatëse në sektorin e kuvertës për një periudhë prej jo më pak se 12 muaj brenda 60 muajve të fundit përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

### **KREU III**

#### **SEKTORI I MASHINËS**

### **Rregullorja III/1**

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e oficerëve përgjegjës për vrojtimin e një lokali motori me personel ose inxhinierëve mekanikë të ngarkuar me detyrë në një lokal motori pa prani të përhershme të personelit**

1. Çdo oficer përgjegjës për vrojtimin e motorit në një lokal motori me personel ose inxhinier mekanik i ngarkuar me detyrë në një lokal motori pa prani të përhershme të personelit në një anije që lundron në det, me makineri kryesore shtytëse me



fuqi prej 750 kw ose më shumë, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 ka kryer një trajnim ku përfshihet specializimi në laborator dhe shërbimi i aprovuar në det për jo më pak se 12 muaj, si pjesë e një programi të aprovuar trajnimi që përfshin trajnimin në bord duke përbushur kërkesat e seksionit A-III/1 të kodit STCW dhe që dokumentohet me pasaportën e trajnimit në bord, ose ka kryer një trajnim ku përfshihet specializimi në laborator dhe shërbimi i aprovuar në det për jo më pak se 36 muaj, nga të cilat të paktën 30 muaj duhet të jenë në dhomën e motorit;

2.3 ka qenë, gjatë shërbimit të detyrueshëm në det, përgjegjës për vrojtimin në dhomën e motorit nën mbikëqyrjen e kryeinxhinierit mekanik ose të një inxhinieri mekanik të kualifikuar, për një periudhë prej jo më pak se gjashtë muaj;

2.4 ka përfunduar kurset e aprovuara të formimit dhe trajnimit dhe përbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/1 të kodit STCW; dhe

2.5 përbush standardet e kompetencës të specifikuara në paragrafin 2 të seksionit A-VI/1, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/2, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 dhe në paragrafët 1 deri në 3 të seksionit A-VI/4 të kodit STCW.

#### Rregullorja III/2

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e kryeinxhinierëve mekanikë dhe inxhinier mekanikë i dytë në anijet me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 3000 kw ose më shumë**

1. Çdo kryeinxhinier mekanik dhe inxhinier mekanikë i dytë në anijet që lundrojnë në det, me makineri kryesore shtytëse me fuqi prej 3000 kw ose më shumë, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 përbush kërkesat për certifikimin si oficer përgjegjës për vrojtimin e motorit në anijet që lundrojnë në det, me makineri kryesore shtytëse me fuqi prej 750 kw ose më shumë, dhe ka kryer shërbim të aprovuar në det në këtë funksion:

2.1.1 për jo më pak se 12 muaj si inxhinier mekanik i kualifikuar, për certifikimin si zëvendësinxhinier mekanik; dhe

2.1.2 për jo më pak se 36 muaj, për certifikimin si kryeinxhinier mekanik; megjithatë kjo periudhë mund të reduktohet në jo më pak se 24 muaj nëse të paktën për 12 muaj ka shërbyer në funksionin e zëvendësinxhinierit mekanik; dhe

2.2 të kenë përfunduar arsimin përkatës dhe kurset e aprovuara të trajnimit dhe përbushin standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/2 të kodit STCW.

#### Rregullorja III/3

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e kryeinxhinierëve mekanikë dhe inxhinier mekanikë i dytë për anijet me makineri kryesore shtytëse me fuqi nga 750 kw deri në 3000 kw**

1. Çdo kryeinxhinier mekanik dhe inxhinier mekanikë i dytë në anijet që lundrojnë në det, me makineri kryesore shtytëse me fuqi nga 750 deri në 3000 kw, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 përbush kërkesat për certifikimin si oficer përgjegjës për vrojtimin në dhomën e motorit dhe:

2.1.1 për certifikimin si zëvendësinxhinier mekanik, ka kryer të paktën 12 muaj shërbim të aprovuar në det si inxhinier mekanik ose si ndihmës inxhinier mekanik; dhe

2.1.2 për certifikimin si kryeinxhinier mekanik, ka kryer të paktën 24 muaj shërbim të aprovuar në det, nga të cilat të paktën 12 muaj shërbimi të jenë kryer pas kualifikimit si zëvendësinxhinier mekanik; dhe

2.2 të kenë përfunduar arsimin përkatës dhe kurset e aprovuara të trajnimit dhe përbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/3 të kodit STCW.

3. Çdo inxhinier mekanik i kualifikuar për të shërbyer si zëvendësinxhinier mekanik në anijet me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 3000 kw ose më shumë, mund të shërbejë si kryeinxhinier mekanik në anijet me makineri shtytëse kryesore me fuqi nën 3000 kw, me kusht që certifikata të jetë e validuar përkatësisht.



## Rregullorja III/4

**Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e marinarëve që janë pjesë e ekipeve të vrojtimit në lokalet e motorit me personel ose të ngarkuar me detyra në lokalet e motorit pa prani të përhershme të personelit**

1. Çdo marinar që është pjesë e ekipit të vrojtimit në një lokal motori me personel ose që është i ngarkuar me detyra në një lokal motori pa prani të përhershme të personelit në një anije që lundron në det, me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 750 kw ose më shumë, përveç marinarëve nën trajnim dhe marinarëve detyrat e të cilëve nuk kërkojnë kualifikim të veçantë, duhet i certifikuar posaçërisht për kryerjen e këtyre detyrave.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 16 vjeç;

2.2 ka kryer:

2.2.1 shërbim të aprovuar në det, duke përfshirë jo më pak se gjashtë muaj trajnim dhe përvojë; ose

2.2.2 trajnim të posaçëm, para shërbimit ose në bordin e anijes, duke përfshirë një periudhë të aprovuar të shërbimit në det prej jo më pak se dy muaj; dhe

2.3 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/4 të kodit STCW.

3. Shërbimi në det, trajnimi dhe përvoja që kërkohen nga pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 lidhen me funksionet e vrojtimit në lokalin e motorit dhe përfshijnë kryerjen e detyrave nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një inxhinieri mekanik ose një marinari të kualifikuar.

## Rregullorja III/5

**Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin si marinar mashine i kualifikuar i dhomës së motorit në lokalet e motorit me personel ose i ngarkuar me detyra në lokalet e motorit pa prani të përhershme të personelit**

1. Çdo marinar mashine i kualifikuar i dhomës së motorit në anijet që lundrojnë në det, me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 750 kw ose më shumë, duhet i pajisur me një certifikatë të posaçme.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 përmbush kërkesat për certifikimin si marinar pjesë e ekipit të vrojtimit në një lokal

motori me personel ose të ngarkuar me detyra në një lokal motori pa prani të përhershme të personelit;

2.3 pas kualifikimit për shërbimin si marinar pjesë e ekipit të vrojtimit në dhomën e motorit, ka kryer shërbim të aprovuar në det në dhomën e motorit për:

2.3.1 jo më pak se 12 muaj; ose

2.3.2 jo më pak se gjashtë muaj dhe ka përfunduar një trajnim të aprovuar; dhe

2.4 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/5 të kodit STCW.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare i konsideron të përmbushura kërkesat e kësaj rregulloreje për detarët nëse atë kanë shërbyer në një nga funksionet përkatëse në dhomën e motorit për një periudhë prej jo më pak se 12 muaj brenda 60 muajve të fundit përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

## Rregullorja III/6

**Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e oficerëve elektroteknik**

1. Çdo oficer elektroteknik që shërben në një anije që lundron në det, me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 750 kw ose më shumë, duhet i pajisur me një certifikatë kompetence.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 ka kryer një trajnim prej të paktën 12 muajsh ku përfshihet specializimi në laborator dhe shërbimi i aprovuar në det, nga të cilat të paktën gjashtë muaj janë shërbim në det si pjesë e një programi të aprovuar trajnimi që përmbush kërkesat e seksionit A-III/6 të kodit STCW dhe që dokumentohet me pasaportën e trajnimit në bord, ose ka kryer një trajnim prej të paktën 36 muajsh ku përfshihet specializimi në laborator dhe shërbimi i aprovuar në det, nga të cilat të paktën 30 muaj janë shërbim në dhomën e motorit;

2.3 ka përfunduar arsimin përkatës dhe trajnimet dhe përmbush standardet e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/6 të kodit STCW; dhe

2.4 përmbush standardet e kompetencës të specifikuar në paragrafin 2 të seksionit A-VI/1, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/2, në paragrafët 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 dhe në



paragrafët 1 deri në 3 të seksionit A-VI/4 të kodit STCW.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund t'i konsiderojë të përmbushura kërkesat e kësaj rregulloreje për detarët nëse ata kanë shërbyer në një nga funksionet përkatëse në bordin e një anijeje për një periudhë prej jo më pak se 12 muaj brenda 60 muajve të fundit përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, dhe nëse përmbushin standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/6 të kodit STCW.

4. Pavarësisht kërkesave të mësipërme të paragrafëve 1 deri në 4, Drejtoria e Përgjithshme Detare një person me kualifikim të përshtatshëm e konsideron të aftë të kryejë funksione të caktuara të seksionit A-III/6.

#### Rregullorja III/7

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e marinarëve elektroteknik**

1. Çdo marinar mashine i kualifikuar elektroteknik që shërben në një anije që lundron në det, me makineri shtytëse kryesore me fuqi prej 750 kw ose më shumë, është i pajisur me një certifikatë të posaçme.

2. Çdo kandidat për certifikim:

2.1 është të paktën 18 vjeç;

2.2 ka kryer shërbim të aprovuar në det, duke përfshirë jo më pak se 12 muaj trajnim dhe përvojë; ose

2.3 ka përfunduar një trajnim të aprovuar, duke përfshirë një periudhë të aprovuar shërbimi në det prej jo më pak se gjashtë muaj; ose

2.4 ka kualifikime të cilat përmbushin kompetencat teknike të tabelës A-III/7 të kodit STCW dhe ka kryer një periudhë të aprovuar të shërbimit në det prej jo më pak se tre muaj; dhe

2.5 përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/7 të kodit STCW;

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund t'i konsiderojë të përmbushura kërkesat e kësaj rregulloreje për detarët nëse atë kanë shërbyer në një nga funksionet përkatëse në bordin e një anijeje për një periudhë prej jo më pak se 12 muaj brenda 60 muajve të fundit përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore dhe nëse përmbushin standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-III/7 të kodit STCW.

4. Pavarësisht kërkesave të mësipërme të paragrafëve 1 deri në 4, Drejtoria e Përgjithshme Detare një person me kualifikim të përshtatshëm e konsideron të aftë të kryejë funksione të caktuara të seksionit A-III/7.

#### KREU IV

### **RADIOKOMUNIKIMI DHE OPERATORËT E RADIOKOMUNIKIMIT**

#### *Shënim shpjegues*

Dispozitat e detyrueshme në lidhje me vrojtimin e radiokomunikimeve janë përcaktuar në rregulloret e radiokomunikimit dhe në SOLAS 74, të ndryshuar. Dispozitat për mirëmbajtjen e aparaturave radio-elektrike përcaktohen në SOLAS 74, të ndryshuar, dhe në udhëzimet e miratuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare.

#### Rregullorja IV/1

#### **Zbatimi**

1. Përveç nga sa parashikohet në pikën 2, dispozitat e këtij kreu zbatohen për operatorët e radiokomunikimit në anijet që operojnë në sistemin global të sigurisë në rastet e fatkeqësive në det (GMDSS), siç parashikohet në SOLAS 74, të ndryshuar.

2. Përmbushja e dispozitave të këtij kreu nuk është e nevojshme për operatorët e radiokomunikimit në anijet për të cilat nuk kërkohet përputhshmëria me dispozitat e GMDSS-së në kreun IV të SOLAS 74. Megjithatë, operatorët e radiokomunikimit në këto anije duhet të veprojnë në përputhje me rregulloret e radiokomunikimit. Shtetet anëtare garantojnë që operatorëve të radiokomunikimit t'u jenë lëshuar ose njohur certifikatat e posaçme të kërkuara nga rregulloret e radiokomunikimit.

#### Rregullorja IV/2

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për certifikimin e operatorëve radio GMDSS**

1. Çdo person që mbikëqyr apo kryen detyrat e radiokomunikimit në një anije që përdor GMDSS është i pajisur me një certifikatë të posaçme në lidhje me GMDSS, të lëshuar ose të njohur nga



shteti shqiptar sipas dispozitave të rregulloreve të radiokomunikimit.

2. Gjithashtu, çdo kandidat për certifikatë kompetence, në përputhje me këtë rregullore, për shërbim në një anije që, sipas Konventës SOLAS të ndryshuar, duhet të ketë një instalim radioelektrik:

2.1 është të paktën 18 vjeç; dhe

2.2 ka përfunduar kurset e aprovuara të formimit dhe trajnimit dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-IV/2 të kodit STCW.

#### KREU V

### KËRKESA TË VEÇANTA TRAJNIMI PËR PERSONELIN NË LLOJE TË CAKTUARA ANIJESH

#### Rregullorja V/1-1

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për trajnimin dhe kualifikimet e kapitenëve, oficerëve dhe marinarëve në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike**

1. Oficerët dhe marinarët e ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi specifike në lidhje me ngarkesat ose pajisjet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës ose substancave kimike duhet pajisur me një certifikatë trajnimi bazë për operacionet e ngarkimit në këto anije.

2. Çdo kandidat për certifikatë trajnimi bazë për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike ka përfunduar trajnimin bazë në përputhje me dispozitat e seksionit A-VI/1 të kodit STCW, si dhe ka kryer:

2.1 të paktën tre muaj shërbim të aprovuar në det në anijet cisternë të naftës ose substancave kimike dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-1, paragrafi 1 të kodit STCW; ose

2.2 një trajnim bazë të aprovuar mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-1, paragrafi 1 të kodit STCW.

3. Kapitenët, kryeinxhinierët mekanikë, oficerët e parë, inxhinier mekanik i dytë dhe çdo person me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ngarkimin, shkarkimin, mbarëvajtjen e operacioneve të transitit, trajtimin e ngarkesave, pastrimin e cisternës ose operacionet e tjera të ngarkimit në

anijet cisternë të naftës, janë të pajisur me një certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës.

4. Çdo kandidat për certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës:

4.1 përmbush kërkesat për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike; dhe

4.2 pasi është kualifikuar për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike, ka kryer:

4.2.1 të paktën tre muaj shërbim të aprovuar në det në anijet cisternë të naftës; ose

4.2.2 të paktën një muaj trajnim të aprovuar në bord në anijet cisternë të naftës, në rolin e asistentit, që përfshin të paktën tre operacione ngarkimi dhe tre operacione shkarkimi dhe është i dokumentuar në një regjistër të aprovuar trajnimi, duke marrë në konsideratë udhëzimet në seksionin B-V/1 të kodit STCW; dhe

ka përfunduar një trajnim të avancuar e të aprovuar mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-1, paragrafi 2 të kodit STCW.

5. Kapitenët, kryeinxhinierët mekanikë, oficerët e parë, inxhinier mekanik i dytë dhe çdo person me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ngarkimin, shkarkimin, mbarëvajtjen e operacioneve të transitit, trajtimin e ngarkesave, pastrimin e cisternës ose operacionet e tjera të ngarkimit në anijet cisternë të substancave kimike, duhet të jenë të pajisur me një certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të substancave kimike.

6. Çdo kandidat për certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të substancave kimike:

6.1 përmbush kërkesat për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike; dhe

6.2 pasi është kualifikuar për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të naftës dhe substancave kimike, ka kryer:





6.2.1 të paktën tre muaj shërbim të aprovuar në det në anijet cisternë të substancave kimike; ose

6.2.2 të paktën një muaj trajnim të aprovuar në bord në anijet cisternë të substancave kimike, në rolin e asistentit, që përfshin të paktën tre operacione ngarkimi dhe tre operacione shkarkimi dhe është i dokumentuar në një regjistër të aprovuar trajnimi, duke marrë në konsideratë udhëzimet në seksionin B-V/1 të kodit STCW; dhe

6.3 ka përfunduar një trajnim të avancuar e të aprovuar mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të substancave kimike dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-1, paragrafi 3 të kodit STCW.

7. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton që detarëve të kualifikuar në përputhje me paragrafin 2, 4 ose 6, sipas rastit, t'u lëshohet një certifikatë kualifikimi ose t'u validohet përkatësisht një certifikatë ekzistuese kompetence ose kualifikimi.

#### Rregullorja V/1-2

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për trajnimin dhe kualifikimet e kapitenëve, oficerëve dhe marinarëve në anijet cisternë të gazeve të lëngshme**

1. Oficerët dhe marinarët e ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi specifike në lidhje me ngarkesat ose pajisjet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme duhet të jenë të pajisur me një certifikatë trajnimi bazë për operacionet e ngarkimit në këto anije

2. Çdo kandidat për certifikatë trajnimi bazë për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme ka përfunduar trajnimin bazë në përputhje me dispozitat e seksionit A-VI/1 të kodit STCW, si dhe ka kryer:

2.1 të paktën tre muaj shërbim të aprovuar në det në anijet cisternë të gazeve të lëngshme dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-2, paragrafi 1 të kodit STCW; ose

2.2 një trajnim bazë të aprovuar mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-2, paragrafi 1 të kodit STCW.

3. Kapitenët, kryeinxhinierët mekanikë, oficerët e parë, inxhinier mekanik i dytë dhe çdo person me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ngarkimin,

shkarkimin, mbarëvajtjen e operacioneve të transitit, trajtimin e ngarkesave, pastrimin e cisternës ose operacionet e tjera të ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme, duhet të jenë të pajisur me një certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme.

4. Çdo kandidat për certifikatë trajnimi të avancuar për operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme:

4.1 përmbush kërkesat për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme; dhe

4.2 pasi është kualifikuar për certifikim në lidhje me trajnimin bazë mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme, ka kryer:

4.2.1 të paktën tre muaj shërbim të aprovuar në det në anijet cisternë të gazeve të lëngshme; ose

4.2.2 të paktën një muaj trajnim të aprovuar në bord në anijet cisternë të gazeve të lëngshme, në rolin e asistentit, që përfshin të paktën tre operacione ngarkimi dhe tre operacione shkarkimi dhe është i dokumentuar me pasaportën e trajnimit në bord, duke marrë në konsideratë udhëzimet në seksionin B-V/1 të kodit STCW; dhe

4.3 ka përfunduar një trajnim të avancuar e të aprovuar mbi operacionet e ngarkimit në anijet cisternë të gazeve të lëngshme dhe përmbush standardin e kompetencës të specifikuar në seksionin A-V/1-2, paragrafi 2 të kodit STCW.

5. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton që detarëve të kualifikuar në përputhje me paragrafin 2 ose 4, sipas rastit, t'u lëshohet një certifikatë kualifikimi ose t'u validohet përkatësisht një certifikatë ekzistuese kompetence ose kualifikimi.

#### Rregullorja V/2

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për trajnimin dhe kualifikimet e kapitenëve, oficerëve, marinarëve dhe pjesës tjetër të personelit në anijet e pasagjerëve**

1. Kjo rregullore zbatohet për kapitenët, oficerët, marinarët dhe pjesën tjetër të personelit që shërbejnë në bordin e anijeve të pasagjerëve që kryejnë lundrime ndërkombëtare. Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton zbatueshmërinë e këtyre kërkesave për personelin që shërben në anijet e pasagjerëve që kryejnë lundrime brenda vendit.



2. Përpara caktimit të detyrave në bordin e anijeve të pasagjerëve, detarët kanë përfunduar trajnimin e nevojshëm sipas paragrafëve 4 deri në 7 më poshtë, në përputhje me kapacitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

3. Detarët që duhet të jenë trajnuar në përputhje me paragrafët 4, 6 dhe 7, u nënshtrohen trajnimeve riaftësuese në intervale jo më të gjata se pesë vite ose sigurojnë dëshmi për arritjen e standardeve të detyrueshme të kompetencës përgjatë pesë viteve të kaluara.

4. Kapitenët, oficerët dhe pjesa tjetër e personelit të caktuar në rolin e ekuipazhit që do të ndihmojnë pasagjerët në situata emergjence në bordin e anijeve të pasagjerëve kanë përfunduar trajnimin për menaxhimin e turmave, siç specifikohet në seksionin A-V/2, paragrafi 1, të kodit STCW.

5. Personeli që u ofron drejtpërdrejt shërbim pasagjerëve në hapësirat e posaçme në bordin e anijeve të pasagjerëve ka përfunduar trajnimin për sigurinë të specifikuar në seksionin A-V/2, paragrafi 2, të kodit STCW.

6. Kapitenët, kryeinxhinierët mekanikë, oficerët e parë, inxhinier mekanik i dyte dhe çdo person i caktuar në rolin e ekuipazhit përgjegjës për sigurinë e pasagjerëve në situata emergjence në bordin e anijeve të pasagjerëve, kanë kryer trajnime të aprovuara për menaxhimin e krizave dhe sjelljen njerëzore, siç specifikohet në seksionin A-V/2, paragrafi 3, të kodit STCW.

7. Kapitenët, oficerët e parë, kryeinxhinierët mekanikë, inxhinier mekanik i dyte dhe çdo person i ngarkuar me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për imbarkimin dhe zbarkimin e pasagjerëve, ngarkimin, shkarkimin apo sigurimin e ngarkesave, ose mbylljen e aparaturave në bordin e anijeve Ro-Ro të pasagjerëve, kanë përfunduar një trajnim të aprovuar për sigurinë e pasagjerëve, sigurinë e ngarkesave dhe integritetin e strukturës së anijes, siç specifikohet në seksionin A-V/2, paragrafi 4, të kodit STCW.

8. Drejtoria e Përgjithshme Detare garanton që çdo personi që rezulton i kualifikuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje t'i lëshohet një dokument provë për trajnimin e përfunduar.

## KREU VI

### FUNKSIONET NË LIDHJE ME SITUATAT E EMERGJENCËS, SIGURINË NË PUNË, MBROJTJEN, KUJDESIN MJEKËSOR DHE MBIJETESËN

#### Rregullorja VI/1

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për parapërgatitjen mbi çështjet e sigurisë, trajnimin dhe udhëzimet bazë për të gjithë detarët**

1. Detarët u nënshtrohen kurseve parapërgatitore dhe kryejnë trajnime ose marrin udhëzime bazë, në përputhje me seksionin A-V1/1 të kodit STCW, si dhe përmbushin standardet e duhura të kompetencës të specifikuara në të.

2. Nëse trajnimi bazë nuk përfshihet në kualifikimet e nevojshme për lëshimin e certifikatës, atëherë lëshohet një certifikatë kualifikimi që dëshmon se mbajtësi ka ndjekur kursin e trajnimit bazë.

#### Rregullorja VI/2

#### **Kërkesat minimale të detyrueshme për lëshimin e certifikatave të kualifikimit në mjetet e mbijetesës, barkat e shpëtimit dhe barkat e shpejta të shpëtimit**

1. Çdo kandidat për certifikatë kualifikimi për mjetet e mbijetesës dhe barkat e shpëtimit, të ndryshme nga barkat e shpejta të shpëtimit:

1.1 është të paktën 18 vjeç;

1.2 ka kryer shërbim të aprovuar në det për jo më pak se 12 muaj, ose ka ndjekur një kurs të aprovuar trajnimi dhe ka kryer shërbim të aprovuar në det për jo më pak se gjashtë muaj; dhe

1.3 përmbush standardet e kompetencës për certifikatat e kualifikimit për mjetet e mbijetesës dhe barkat e shpëtimit, të përcaktuara në seksionin A-V1/2, paragrafët 1 deri në 4, të kodit STCW.

2. Çdo kandidat për certifikatë kualifikimi për barkat e shpejta të shpëtimit:

2.1 është i pajisur me një certifikatë kualifikimi për mjetet e mbijetesës dhe barkat e shpëtimit, të ndryshme nga barkat e shpejta të shpëtimit;

2.2 ka ndjekur një kurs të aprovuar trajnimi; dhe

2.3 përmbush standardin e kompetencës për certifikatat e kualifikimit për barkat e shpejta të



shpëtimit, të përcaktuar në seksionin A-VI/2, paragrafët 7 deri në 10, të kodit STCW.

#### Rregullorja VI/3

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për trajnimin mbi teknikat e avancuara të fikjes së zjarrit**

1. Detarët e caktuar për të kontrolluar operacionet e fikjes së zjarrit kanë përfunduar me sukses trajnimin e avancuar në teknikat e fikjes së zjarrit, të fokusuar veçanërisht mbi organizimin, taktikat dhe komandën në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 deri në 4 të seksionit A-VI/3 të kodit STCW, si dhe përmeshin standardin e kompetencës të specifikuar në të.

2. Nëse trajnimi i avancuar për fikjen e zjarrit nuk përfshihet në kualifikimet e nevojshme për lëshimin e certifikatës, atëherë lëshohet një certifikatë kualifikimi që dëshmon se mbajtësi ka ndjekur një kurs trajnimi të avancuar për fikjen e zjarrit.

#### Rregullorja VI/4

### **Kërkesat minimale të detyrueshme në lidhje me ndihmën e parë dhe kujdesin mjekësor**

1. Detarët e caktuar për ofrimin e ndihmës së parë në bordin e anijes përmeshin standardin e kompetencës për ndihmën e parë të specifikuar në seksionin A-VI/4, paragrafët 1, 2 dhe 3 të kodit STCW.

2. Detarët e ngarkuar me përgjegjësi për kujdesin mjekësor në bordin e anijes përmeshin standardin e kompetencës për kujdesin mjekësor në bordin e anijeve, të specifikuar në seksionin A-VI/4, paragrafët 4, 5 dhe 6 të kodit STCW.

3. Nëse trajnimi për ndihmën e parë ose kujdesin mjekësor nuk përfshihet në kualifikimet e nevojshme për lëshimin e certifikatës, atëherë lëshohet një certifikatë kualifikimi që dëshmon se mbajtësi ka ndjekur një kurs trajnimi për ndihmën e parë ose kujdesin mjekësor.

#### Rregullorja VI/5

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për lëshimin e certifikatave të kualifikimit për oficerët e sigurisë së anijeve**

1. Çdo kandidat për certifikatë kualifikimi si oficer i sigurisë së anijes:

1.1. ka kryer shërbim të miratuar në det për jo më pak se 12 muaj ose ka kryer shërbimin në det dhe ka njohuri në lidhje me operimin e anijes; dhe

1.2. përmesh standardin e kompetencës për certifikatën e kualifikimit si oficer i sigurisë së anijes, të përcaktuar në seksionin A-VI/5, paragrafët 1 deri në 4, të kodit STCW.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare garantojnë që çdo personi që rezulton i kualifikuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje t'i lëshohet një certifikatë kualifikimi.

#### Rregullorja VI/6

### **Kërkesat minimale të detyrueshme për trajnimin dhe udhëzimet në lidhje me sigurinë për të gjithë detarët**

1. Detarët u nënshtrohen kurseve parapërgatitore dhe kryejnë trajnime ose marrin udhëzime në lidhje me sigurinë, në përputhje me seksionin A-VI/6 të kodit STCW, si dhe përmeshin standardin e duhur të kompetencës të specifikuar në të.

2. Nëse njohuritë dhe ndërgjegjësimi mbi sigurinë nuk përfshihen në kualifikimet e nevojshme për lëshimin e certifikatës, atëherë lëshohet një certifikatë kualifikimi që dëshmon se mbajtësi i saj ka ndjekur një kurs trajnimi dhe ndërgjegjësimi mbi sigurinë.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare i krahason trajnimet ose udhëzimet lidhur me sigurinë të parashikuara për detarët të cilët janë të pajisur me certifikatë kualifikimi apo që mund t'i dokumentojnë kualifikimet përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me ato të specifikuara në seksionin A-VI/6, paragrafi 4 të kodit STCW, si dhe përcakton nëse është e nevojshme t'u kërkojë këtyre detarëve përditësimin e kualifikimeve përkatëse.

### **Detarët e ngarkuar me detyra në lidhje me sigurinë**

4. Detarët e ngarkuar me detyra në lidhje me sigurinë përmeshin standardin e kompetencës të



specifikuar në seksionin A-VI/6, paragrafët 6 deri në 8 të kodit STCW.

5. Nëse trajnimi për detyrat e përcaktuara të sigurisë nuk përfshihet në kualifikimet e nevojshme për lëshimin e certifikatës, atëherë lëshohet një certifikatë kualifikimi që dëshmon se mbajtësi ka ndjekur një kurs trajnimi për detyrat e përcaktuara të sigurisë.

6. Drejtoria e Përgjithshme Detare i krahason standardet e trajnimit lidhur me sigurinë të parashikuara për detarët të cilët janë të pajisur me certifikatë kualifikimi apo që mund t'i dokumentojnë kualifikimet përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me ato të specifikuara në seksionin A-VI/6, paragrafi 8 të kodit STCW, si dhe përcakton nëse është e nevojshme t'u kërkojë këtyre detarëve përditësimin e kualifikimeve përkatëse.

## KREU VII CERTIFIKIMI ALTERNATIV

### Rregullorja VII/1 Lëshimi i certifikatave alternative

1. Pavarësisht kërkesave për certifikim të përcaktuara në kreun II dhe III të kësaj shtojce, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të zgjedhë të lëshojnë ose të autorizojnë lëshimin e certifikatave të ndryshme nga ato të përmendura në rregulloret e këtyre krerëve, me kusht që:

1.1 funksionet përkatëse dhe nivelet e përgjegjësisë që duhet të specifikohen në certifikata dhe validime të përzgjidhen dhe të përputhen me ato që paraqiten në seksionet A-II/1, A-II/2, A-II/3, A-II/4, A-II/5, A-III/1, A-III/2, A-III/3, A-III/4, A-III/5, dhe A-IV/2 të kodit STCW;

1.2 kandidatët të kenë përfunduar kurset e aprovuara të formimit dhe trajnimit dhe të përmbushin kërkesat për standardet e kompetencës, të parashikuara në seksionet përkatëse të kodit STCW dhe të përcaktuara në seksionin A-VII/1 të këtij kodi, për funksionet dhe nivelet që duhet të specifikohen në certifikata dhe validime;

1.3 kandidatët të kenë kryer shërbimin e aprovuar në det, të përshtatshëm për kryerjen e funksioneve dhe nivelet e përcaktuara në certifikatë. Kohëzgjatja minimale e shërbimit në det është e barabartë me kohëzgjatjen e shërbimit në

det të parashikuar në krerët II dhe III të kësaj shtojce. Megjithatë, kohëzgjatja minimale e shërbimit në det nuk është më pak se ajo e parashikuar në seksionin A-VII/2 të kodit STCW;

1.4 kandidatët për certifikim të ngarkuar me detyrën e lundrimit në nivel operacional të përmbushin kërkesat e zbatueshme të rregulloreve në kreun IV, sipas rastit, për kryerjen e detyrave të caktuara të radiokomunikimit në përputhje me rregulloret e radiokomunikimit;

1.5 certifikatat të lëshohen në përputhje me kërkesat e nenit 4 të kësaj rregulloreje dhe me dispozitat e përcaktuara në kreun VII të kodit STCW.

### Rregullorja VII/2 Certifikimi i detarëve

Çdo detar që kryen një nga funksionet apo grupet e funksioneve të specifikuara në tabelat, A-II/1, A-II/2, A-II/3, A-II/4 ose A-II/5 të kreut II, në tabelat A-III/1, A-III/2, A-III/4 ose A-III/5 të kreut III ose në tabelën A-IV/2 të kreut IV të kodit STCW, është i pajisur me një certifikatë kualifikimi, sipas rastit.

### Rregullorja VII/3 Parimet që rregullojnë lëshimin e certifikatave alternative

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare në rast se zgjedh të lëshojë ose të autorizojë lëshimin e certifikatave alternative sigurohet që të respektohen parimet e mëposhtme:

1.1 nuk zbatohet asnjë sistem certifikimi alternativ, përveçse kur ai garanton një shkallë sigurie në det dhe kur ka efekt parandalues për ndotjen, të paktën të barasvlershëm me atë të parashikuar nga krerët e tjerë; dhe

1.2 çdo marrëveshje për lëshimin e certifikatave alternative sipas këtij kreu parashikon barasvlershmërinë e certifikatave me ato të lëshuara sipas krerëve të tjerë.

2. Parimi i barasvlershmërisë në pikën 1 garanton që:

2.1 detarët e certifikuar sipas rregullave të kreut II dhe/ose III dhe ata të certifikuar sipas kreut VII janë në gjendje të shërbejnë si në anijet me strukturë të zakonshme organizimi ashtu edhe në ato me strukturë të ndryshme; dhe



2.2 detarët nuk janë trajnuar posaçërisht për një strukturë specifike organizimi, në mënyrë të tillë që do të pengonte ushtrimin e aftësive të tyre në struktura të tjera.

3. Gjatë lëshimit të çfarëdolloj certifikate sipas dispozitave të këtij kreu, merren parasysh parimet e mëposhtme:

3.1 lëshimi i certifikatave alternative nuk përdoret, për:

3.1.1 reduktimin e numrit të ekuipazhit në bord;

3.1.2 denigrimin e profesionit ose të aftësive të detarëve; ose

3.1.3 justifikimin e caktimit të detyrave të ndryshme të oficerëve të vrojtimit të dhomës së motorit dhe të kuvertës një personi që zotëron vetëm një certifikatë, gjatë një turni të vetëm vrojtimi; dhe

4. Parimet e përfshira në pikat 1 dhe 2 garantojnë ruajtjen e kompetencave të oficerëve të kuvertës dhe të inxhinierëve

## ANEKS II

### KRITERET PËR NJOHJEN E VENDEVE TË TJERA QË KANË LËSHUAR NJË CERTIFIKATË OSE NËN AUTORITETIN E TË CILAVE ËSHTË LËSHUAR NJË CERTIFIKATË, TË PËRMENDURA NË NENIN 19.

1. Vendi tjetër duhet të jetë palë e Konventës STCW.

2. Vendi tjetër duhet të jetë identifikuar nga Komiteti i Sigurisë Detare si një vend që ka dëshmuar se ka zbatuar plotësisht dispozitat e Konventës STCW.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare ka prezantuar masa për të garantuar që detarët të cilët paraqesin për njohje certifikata për funksione në nivel drejtues kanë njohuritë e duhura mbi legjislacionin detar të shtetit anëtar në lidhje me funksionet që lejohet të kryejnë.

4. Nëse Drejtoria e Përgjithshme Detare dëshiron të plotësojë vlerësimin e përputhshmërisë

së një vendi tjetër duke vlerësuar disa institute të trajnimit detar, ai vepron në përputhje me dispozitat e seksionit A-I/6 të kodit STCW.

## ANEKS III STANDARDET MJEKËSORE TË DETARËVE

### Pjesa I

#### Përmbledhje e përgjithshme

Kjo pjesë siguron informacione dhe udhëzime mbi kushtet mjekësore që mund të ndikojnë tek individët për kryerjen e sigurt të detyrave të tyre në det.

Standardet mjekësore përqipen të jenë të veçanta dhe të japin shembuj të detyrave/punëve që mund të ndikohen. Standardet nuk mund të mbulojnë çdo situatë klinike dhe inspektori mjekësor duhet të ushtrojë gjykimin në lidhje me objektivin kryesor – **ruajtjen e sigurisë**. Për shembull, a ndodh që kushtet të shkaktojnë humbje të papritur të kontrollit të anijes, ose humbje të papritur të vetëdijes gjatë punës në lartësi, apo të pengojnë kryerjen e detyrave emergjente?

Inspektorët mjekësorë duhet të bëjnë një vlerësim mjekësor të gjithanshëm të shëndetit të përgjithshëm të vetëdijshëm se gabimet ose moskryerja e **detyrës kritike** në disa punë mund të çojë në pasoja të rënda në lidhje me shëndetin dhe jetën njerëzore, ndikimin mjedisor dhe/ose humbjet e mëdha të pasurisë.

Gjithashtu, në përcaktimin e formës mjekësore, duhet marrë në konsideratë koha kritike e nevojshme për trajtimin/aksesin në kujdesin e duhur në tokë.

Inspektorët mjekësorë të detarëve duhet të vlerësojnë kushtet mjekësore që mund të rrisin mundësinë e performancës së varfër të detyrave kritike, si dhe mundësinë dhe ashpërsinë e pasojave kur vendosin nëse aplikanti është i përshtatshëm nga ana mjekësore për të punuar në det.



## Pjesa II Vlerësime mjekësore

### 1) Obeziteti – Morfologjia e trupit

- Meqenëse obeziteti mund të pengojë procedurat e zbrazjes, personat me një indeks të masës trupore prej më shumë se 30 kg/m<sup>2</sup> duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se ato mund të ngjitin shkallët dhe të kalojnë nëpërmjet kapanxhave. Një mjeku profesionist apo një terapisti profesionist mund t'i nevojitet të kryejë një vlerësim funksional në bordin e anijes.
- Një indeks i masës trupore prej më shumë se 35 kg/m<sup>2</sup> paraqet rrezik të lartë. Kandidatëve në këtë kategori mund t'u nevojitet të ndërmarrin reduktimin e peshës dhe të rivlerësohen. Duhet të theksohet se apnea e gjumit është më e zakonshme në personat me obezitet patologjik, siç janë diabeti dhe hipertensioni.

### 2) Sytë/shikimi

#### 2.1. Mprehtësia e shikimit

- Shikimi i largët është i nevojshëm, për:
  - i) detyrat e vrojtimit; dhe
  - ii) kontrollin e anijeve, varkave të vogla dhe vinçave të anijeve.
- Shikimi i afërt është i nevojshëm për të lexuar hartat detare, hartat e motit, ekranet e kompjuterëve, monitorët dhe udhëzimet.
- Shikimi i natës dhe i thellësisë është i nevojshëm për vrojtimin dhe kontrollin e anijes (pamja e thellësisë është veçanërisht e rëndësishme për funksionimin e vinçave në distanca të ngushta).

#### 2.2. Shikimi i ngjyrës

- Shikimi i mirë i ngjyrës është e nevojshëm për detyrat e vrojtimit të urës për të dalluar sinjalet e kuqe dhe të gjelbra të portit dhe kanalit djathtas, farët e lundrimit dhe dritat e lundrimit të anijeve. Aftësia për të identifikuar dritat e kuqe, të gjelbra dhe të bardha të lundrimit, përbën një pjesë thelbësore të punës për kapitenët, pilotët e kuvertës dhe detarët të cilëve u kërkohet të kryejnë detyra vrojtimi.
- Shikimi i dëmtuar i ngjyrës paraqet rrezik për inxhinierët të cilëve u kërkohet të dallojnë ngjyrat e instalimeve elektrike në mënyrë që të bëjnë lidhjet e duhura elektrike. Si i tillë, ai paraqet rrezik në varësi nga shkalla e dëmtimit që mund të ndikojë në aftësinë e personit për të kryer detyrat e tij.
- Megjithatë, inxhinierët dhe vlerësimet mund të sigurojnë të dhëna nga një punëdhënës përkatës se, gjatë dy viteve të fundit, shikimi i dëmtuar i ngjyrës, nëse ka qenë i pranishëm, nuk ka ndikuar në punën e tyre.
- Në rastin e testimit të shikimit të ngjyrës, detarët nuk duhet të mbajnë lente me ngjyra. Disa nga lentet e kontaktit ose syze me lente kromatike me filtra të kuqe, rrisin dallimin ndërmjet ngjyrave të gjelbra, të verdha dhe kafe, duke bërë të mundur që një detar me mangësi në dallimin e ngjyrave të kalojë testin Ishihara. Këto lente nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar detyra të sigurta të vrojtimit në det.
- Informacioni në lidhje me dëmtimin e shikimit të ngjyrës duhet të paraqitet në certifikatën mjekësore për të ndihmuar punëdhënësin që të marrë vendimin e duhur për punësimin në vazhdimësi. Udhëzimi mbi ekzaminimin e duhur për pamjen e ngjyrës përfshihet në këtë rregullore si shtojca 2.
- Çdo sëmundje e syrit ose mangësi që ndikon në shikim duhet të korrigjohet.
- Një histori e glaukomës ose uveitis kërkon vlerësim oftalmologjik.
- Standardet pamore të listuara në tabelën 1 janë standardet e pranura në nivel ndërkombëtar si të përshtatshme.

**Tabela 1: Standardet e shikimit**

	Shikimi i largët			Shikim i afërt (a)	Shikim i ngjyrës	Fushat e shikimit
	Syri Më i mirë jo më pak se	Syri tjetër (a) jo më pak se	Të dy sytë jo më pak se			
<i>Sektori i Kuvertës</i>						
1. Detarët që duhet të ndërmarrin detyra të vrojtimit:						
a) Për kandidatët e rinj	6/6	6/9	6/6		Normal (b)	
-Me ose pa syze apo lente kontakti (c)	6/12	6/24	6/12		Normal (b)	
-Shikimi pa ndihmë	6/6	6/9	6/6		Normal (b)	
b) Për stafin ekzistues	6/36	6/36	6/36		Normal (b)	Fushat normale të shikimit
-Me ose pa syze apo lente kontakti (c)	6/6	6/12	6/9	N8 për hartat detare, hartat e motit dhe N12 për leximin e detyrave të tjera me ose pa ndihma shikimi	Dallon ngjyrën e kuqe (d)	
-Shikimi pa ndihmë	6/12	6/60	6/60		Dallon ngjyrën e kuqe (d)	Fushat normale të shikimit
2. Detarë që nevojiten për të përdorur pajisje ngritëse						
P.sh. vinçat, çikrikët e anijeve:				N8 për hartat detare, hartat e motit dhe N12 për leximin e detyrave të tjera me ose pa	N/A	
-Me ose pa syze apo lente kontakti (c)						
-Shikimi pa ndihmë						
3. Detarë që nuk nevojiten të ndërmarrin						



detyra në 1 ose 2: (shikim i ndihmuar nëse është i nevojshëm)				ndihma shikimi		Fushat normale të shikimit
				N12 me ose pa ndihma shikimi		
				N12 me ose pa ndihma shikimi		Fushat e mjaftueshme të shikimit

**Sektor tjetër**

1.Dhoma e motorit (përfshin elektrikistin): (shikim i ndihmuar nëse është i nevojshëm)	6/12 6/12	6/60 6/60	6/12 6/12	N12 për të lexuar instrumentet, kalibrat për panelet e kontrollit N12 për të lexuar udhëzimet dhe panelet e kontrollit të pajisjeve të kateringut	Shih Shtojca 2 Nuk kërkohet	Fusha të mjaftueshme shikimi Fusha të mjaftueshme shikimi
2.Sektori i kateringut (furnizimit me ushqime) (shikim i nëse është i nevojshëm)						

**Shënim:**

i.Për detarët që mund të sigurojnë të dhëna të kënaqshme të shërbimit, lejohet shikimi monokular me përjashtim të detarëve të cilët duhet të përdorin pajisje ngritëse si vinçat.

ii.Shih shtojcën 2.

iii.Në të gjitha rastet, kur ndihma e shikimit (syze ose lente kontakti) janë të nevojshme për kryerjen efikase të detyrave, duhet të mbahen një palë rezervë për lundrim. Në rastet kur ndihma të ndryshme shikimi përdoren për pamje të afërta dhe të largëta, atëherë duhet të mbahen një palë rezervë për secilin rast.

iv.Është e mjaftueshme nëse zbatuesi mund të dallojë ngjyrën e kuqe nga ngjyrat e tjera.

**3) Gjendja e dëgjimit, veshit, hundës dhe fytyrës****3.1. Standardet e dëgjimit**

- Dëgjimi është i nevojshëm për komunikimin me radio, me telefon ose ndërmjet personash dhe për këtë arsye frekuencat kritike janë në rrezen e të folurit nga 500 deri në 2,000 Hz. Humbja e dëgjimit për kandidatët e rinj duhet të kontrollohet nëpërmjet një audiogrami. Nëse kandidati i ri përdor aparat dëgjimi, personi duhet t'i referohet një qendre audiologjie (dëgjimore) në rastet kur nuk sigurohet prova e testimit të kohëve të fundit dhe përdorimi i aparatit të dëgjimit nuk jep frytet e dëshiruara. Për detarët ekzistues, audiograma nevojitet vetëm nëse dëgjimi nuk është i mjaftueshëm në bisedë. Përveç kësaj, detarët që mbajnë aparat dëgjimi për arsye se kanë dëgjim të pamjaftueshëm në bisedë normale, duhet të kontrollojnë aparatit e tyre të dëgjimit dhe gjithashtu mund të kërkojnë një test praktik për të vlerësuar dëgjimin funksional.
- Të folurit duhet të jetë i qartë dhe pa belbëzime dhe hezitime, i mjaftueshëm për të përdorur radiot dhe për të komunikuar në kuvertë. Personat që përdorin vinça duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë sirenat kur këto përdoren.

**Tabela 2: Standardet minimale të dëgjimit për sektorët e kuvertës dhe motorit**

humbja dB në veshin më të mirë pa ndihma	Frekuenca Hz			
	500	1,000	2,000	3,000
	40	40	40	40

- Nëse humbja e dëgjimit është 40dB ose më shumë në frekuencën e përcaktuar në Tabelën 2, atëherë duhet të tregohet aftësia për të përdorur radio. Në këtë rrethanë aplikuesi duhet të kalojë testin e bisedës.

**3.2. Kryerja e testit të bisedës**

- Procedurat e rekomanduara për kryerjen e testit të bisedës janë si më poshtë vijon:
- Testi duhet të kryhet në një dhomë të qetë me një nivel të qëndrueshëm të zhurmës në sfond. Aparati i dëgjimit duhet të mbahet nëse përdoret normalisht në punë ose nëse nevojitet rritësi pas vendosjes së tij.
- Kontrolluesi duhet të vendosë subjektin përballë dhe t'i drejtohet atij/asaj nga një distancë prej 3 metrash për bisedë normale.
- Subjekti duhet të ulet i kthyer nga kontrolluesi për të penguar leximin e buzëve dhe përdorimin e të dhënave joverbale.
- Duhet të përdoret një volum bisedor normal i zërit.
- Materiali i testit duhet të jetë një përzierje e shkronjave të alfabetit dhe numrave në renditje të ndryshme, që nuk kalojnë numrin tre në çdo frazë, p.sh. 6Y3, 2N4, S5G, 7BL.
- Duhet të përdoren dhjetë kombinime, ku secili paraprihet nga fraza "JU LUTEM THONI".
- Subjekti duhet të përsërisë çfarë ai mendon se ka dëgjuar. Nëse është i pasigurt, atëherë nxitet të hamendësojë.
- Që testi të konsiderohet i mjaftueshëm, duhet të përsëriten gjashtë ose më shumë kombinime pa gabime.
- Aplikuesit që nuk e kalojnë këtë test duhet t'i referohen një vlerësimi tjetër të dëgjimit funksional dhe dallimit të të folurit nga një audiologjist.
- Humbja e dëgjimit funksional i mjaftueshëm për të ndërhyrë në komunikim ose për të penguar sigurinë (p.sh., pajisjet e dëgjueshme paralajmëruese të dëgjimit) paraqet rrezik të lartë.

**3.3. Gjendje të tjera të veshit, hundës dhe fytyrës**

- Infeksionet akute kërkojnë trajtim. Megjithatë sëmundja kronike e veshit të mesëm paraqet rrezik të lartë, infeksioni periodik ose



sinusi kronik paraqet më pak rrezik nëse Inspektori Mjekësor është i bindur se detari mund të menaxhojë gjendjen duke përdorur mjekimin e duhur në det.

▪Mosfunksionimi vestibular mund të ndodhë papritur dhe me ashpërsi të mjaftueshme duke bërë të pamundur funksionimin e sigurt të anijeve dhe vinçave. Ai mund të shoqërohet nga nystagmus që e rrit paaftësinë. Pra sëmundja Ménière paraqet rrezik të lartë.

▪Temperatura e lartë që kundërvepron ndaj terapisë (pa efekte anësore) përbën një nivel më të ulët rreziku.

▪Grykët e përsëritura shpesh përbëjnë rrezik të lartë deri në momentin që shërohen.

#### 4.Sistemi kardiovaskular

▪Gjendjet kardiovaskulare mund të shkaktojnë humbje të papritur ndjenjash duke vënë të tjerët në rrezik ose duke penguar ushtrimin që kërkon durim si në ngjitje ose në punë në hapësira të kufizuara. Disa gjendje kardiovaskulare, nëse bëhen akute, mund të kërkojnë kujdesin e menjëhershëm mjekësor ose evakuimin mjekësor, asnjëra prej të cilave nuk mund të jetë në dispozicion, veçanërisht në vende të largëta dhe/ose në mot të keq.

▪Vlerësimi i kujdesshëm është i nevojshëm për të siguruar se aplikuesit nuk vuajnë nga ndonjë gjendje kardiovaskulare që mund të rrezikojë ato apo të tjerët. Detarët që janë 55 vjeç e më lart, ose detarët që kanë një histori të sëmundjes kardiovaskulare, kanë të nevojshme një ECG në qetësi.

▪Një ECG tensioni mund të kryhet në qoftë se tregohet klinikisht.

##### 4.1.Sëmundja ishemike e zemrës

▪Angina aktuale paraqet rrezik të lartë. Për çdo dukuri brenda 3 muajve të mëparshëm të infarktut të konfirmuar të miokardit, rretransplantimi baipas i arterieve koronare, angioplasti koronar apo unaza, përbën rrezik të lartë.

▪Rreziku është më i ulët në qoftë se detari nuk ka pasur simptoma të sëmundjes së arterieve koronare për më shumë se 3 muaj dhe ka një kontroll të mirë të faktorëve të rrezikut pa ilaçe të nevojshme për kontrollin e anginës. Kontrolli duhet të bëhet nga një kardiolog duke përdorur rezultatet e testeve, p.sh. angiogramën, ECG e tensionit.

▪Çdo dyshim për formën mjekësore duhet t'i referohet një paneli të pavarur mjekësor.

▪Në qoftë se nga kontrolli konstatohet se kanë kaluar 3 muaj apo më shumë që nga incidenti i simptomës së fundit, nuk ka shenja të ishemisë në ushtrimin e ECG (më pak se 2mm ST depresioni i segmentit) dhe/ose angiografia koronare tregon një ulje të lumen më pak se 70% në degën kryesore koronare dhe më pak se 50% në arterien kryesore koronare të majtë, dhe fraksioni i nxjerrjes është 50% ose më shumë, detari mund të deklarohet i përshtatshëm për detyrë në det por duke i rekomanduar kontrolle vjetore ose më të shpeshta kardiologjike.

##### 4.2.Aritmia/stimuluesi kardiak

▪Historia e aritmisë së përsëritur ose të vazhdueshme që mund të rezultojë në të fikët apo simptoma paaftësie, përbën rrezik të lartë.

▪Një detar që ka bërë operacion (p.sh., për sindromin e bardhë të *wolff-parkinsonit*), apo trajtim të suksesshëm me ilaçe për të paktën 3 muaj, mund të deklarohet i përshtatshëm me kusht që t'i nënshtrohet kontrollit vjetor kardiologjik.

▪Në qoftë se detari ka pasur një stimulues kardiak të transplantuar dhe inspektori mjekësor ka marrë parasysh natyrën e sëmundjes kryesore të personit dhe është i kënaqur që funksioni i stimuluesit kardiak është testuar siç duhet, detari mund të deklarohet i përshtatshëm me kusht që t'i nënshtrohet testit 6-mujor në një klinikë stimulimi kardiak dhe kontrollit kardiologjik. Vini re se disa anije kanë fusha të fuqishme elektromagnetike në afërsi të pajisjeve të komunikimit dhe antenave të cilat mund të ndikojnë në funksionin e stimuluesit kardiak.

##### 4.3.Sëmundja e valvulave së zemrës

▪Një rast apo certifikatë e sëmundjes së valvulave, e shoqëruar me simptoma ose histori të embolisë, aritmisë, zmadhimit të zemrës (mbi rrezet X të kraharorit), ECG jonormale, apo tensioni të lartë paraqet rrezik të lartë.

▪Marrja e antikoagulantëve është e pranueshme në qoftë se doza ka qenë e qëndrueshme me kalimin e kohës dhe monitorimi i gjakut është në përputhje me ritmet.

▪Një detar mund të konsiderohet i përshtatshëm për detyrë në det nëse vlerësimi kardiologjik tregon sëmundje të lehtë apo të trajtuar të valvulave pa rëndësi hemodinamike, dhe nuk lidhet me asnjë simptomë, si dhe monitorimi i gjendjes mund të bëhet në frekuenca në përputhje me ritmet.

▪Rastet e dyshimta duhet t'i referohen një paneli të pavarur mjekësor.

##### 4.4.Kardiomiopatia

▪Kardiomiopatia e krijuar paraqet rrezik të lartë.

▪Transplantimi i zemrës ose zemrës/mushkërive paraqet rrezik të lartë.

##### 4.5.Aneurizmi (zmadhimi)

▪Historia e zmadhimit të aortës, kraharorit apo barkut, para ose pas një operacioni, paraqet rrezik të lartë.

##### 4.6.Hipertensioni

●Tensioni (matur në pozicionin ulur) prej 160/ 100 apo më shumë (i trajtuar ose i patrajtuar), paraqet rrezik të lartë.

●Dëmtimi i pjesëve fundore të organeve (zemrës, trurit, retinës ose veshkave) që dëmton funksionimin e sigurt të anijeve, vinçave apo mjeteve të vogla lundruese, paraqet rrezik të lartë.

●Çdo gjendje mjekësore që kërkon përdorimin e ilaçeve të cilat mund të rezultojnë në hipotension të theksuar ose vigjencë të dëmtuar gjë që shkakton humbjen e vëmendjes gjatë funksionimit të anijes, vinçit apo një mjeti të vogël lundrues, paraqet rrezik të lartë.





- Një vërtetim i formës mjekësore mund të lëshohet duke përfshirë kontrollin vjetor:
  - Në qoftë se detari është trajtuar me terapi ilaçesh antihipertensive dhe është arritur kontrolli efikas i hipertensionit (tensioni është më pak ose i barabartë me 140/90 por jo më shumë se 150/95) pa efekte anësore të dukshme për një periudhë vijuese mbi katër javë.
  - Në qoftë se nuk ka prova të dëmtimit të organit në fjalë, lidhur me isheminë apo forma të tjera të sëmundjes së zemrës; dhe
  - Në qoftë se janë trajtuar faktorë të tjerë shkakorë rreziku.

#### 4.7. Sëmundjet e lindura të zemrës

- Sëmundjet e lindura të zemrës (p.sh. defekti i septal, defekti i vogël ventrikular septal) pa simptoma dhe pa rëndësi hemodinamike mund të jenë të pranueshme.

#### 4.8. Qarkullimi periferik (anësor)

- Historia aktuale ose e kohëve të fundit e trombozës së thellë të venave me ose pa emboli, paraqet rrezik të lartë. Venat me variçe lidhur me ulcerat apo komplikime të tjera paraqet rrezik të lartë.
- Ngërçi (apo çalimi) i përhershëm paraqet rrezik të lartë.

#### 4.9. Qarkullimi pulmonar

- Historia e më shumë se një emboli pulmonar paraqet rrezik të lartë. Një episod i vetëm kërkon vlerësim të kujdesshëm të shkakut kryesor dhe rrezikut të përsëritjes.

#### 5. Sistemi i frymëmarrjes

- Çrregullimet e sistemit të frymëmarrjes duhet të merren parasysh në kontekstin e rrezikut të rëndimit akut që kërkon trajtim urgjent mjekësor (p.sh., astma, pneumotoraksi) ose sëmundjet simptomatike e rrugëve të frymëmarrjes të mjaftueshme për të reduktuar aftësinë për punë fizike ose aftësinë për të mbajtur respirator. Aftësia për të mbajtur respirator mund të jetë e nevojshme në anijet që mbartin ngarkesa gruri ose çimentoje, apo anijet naftëmbajtëse si dhe anijet që mbartin ngarkesa kimike.

#### 5.1 Pneumotoraksi

- Historia e pneumotoraksit të përsëritur paraqet rrezik të lartë. Një episod i vetëm që nuk përsëritet për një vit, ose pas trajtimit të suksesshëm kirurgjik, është i pranueshëm.

#### 5.2 Astma

- Astma, sëmundjet kronike bllokuese ose kufizuese të rrugëve të frymëmarrjes dhe emfizema ndikojnë në aftësinë e individit për të përdorur aparat frymëmarrjeje vetëfungsionues, dhe për të mbajtur respiratorë. Personat që vuajnë nga astma ose alergjia mund të zbulojnë se puna në anijet që mbartin grurë ndikon në funksionin e tyre të frymëmarrjes.
- Astma që kërkon kortikosteroide orale dhe/ose ilaçe të shpeshta, paraqet rrezik të lartë.
- Historia e fëmijëve që kanë vuajtur nga astma dhe më pas janë shëruar në adoleshencë, është e pranueshme.
- Astma e mirë-kontrolluar në kortikosteroidet e marra dhe nevoja e përhershme e bronkeve mund të jetë e pranueshme. Gjithashtu mund të kërkohet raporti i trajtimit mjekësor të detarit.
- Disa persona vuajnë nga astma e lehtë me simptoma të përsheptuara nga shkaqe të dukshme të tilla si infeksioni i rrugëve të frymëmarrjes dhe ekzistojnë persona tek të cilët astma zhvillohet papritur duke rrezikuar jetën gjë që bën të nevojshëm shtrimin në spital. Këta të fundit vuajnë nga astma që shpesh është më e vështirë për t'u kontrolluar ku dhe faktori i dukshëm përsheptues nuk mund të identifikohet për çdo goditje nga astma. Ky nën-grup i astmatikëve përbën rrezik të lartë.

#### 5.3 Funkzioni i reduktuar i mushkërive

- Çrregullime të rënda respiratore mund të pengojnë funksionimin e sigurt të anijeve dhe vinqave dhe punën në hapësira të kufizuara nëpërmjet oksigjenit të pamjaftueshëm dhe/ose dioksidit të karbonit në rritje në tru dhe zemër, duke çuar në gjykim të varfër, irritim ose të qenët i përgjumur, përqendrim të zvogëluar dhe efekte kardiace të tilla si infarkti apo aritmia.
- Për punë që kërkojnë përdorimin e një respiratori për shkak të hyrjes në hapësira të mbyllura apo për punë në anije me grurë dhe çimento, FEV1 nën 65%, FVC nën 70% dhe/ose FEV1/FVC më pak se 70% përbëjnë argumente shqetësuese. Vlerësimi praktik i respiratorit është i nevojshëm nëse mbajtja e respiratorëve është kërkesë thelbësore e detyrës.
- Në disa raste të funksionit të reduktuar të mushkërive, individë që gulçojnë mund ta kenë të vështirë të ngjiten shkallët e anijes. Një person që nuk është në gjendje për të mbajtur ritmin me njerëz të së njëjtës moshë dhe trup kur ecin në nivelin e tokës ose që kanë dispne (gulçojnë) në një fluturim nga shkallët, do ta kenë të vështirë të ngjiten shkallët, të ngjiten në impiante dhe pajisje, si dhe të ecin në distanca të arsyeshme në bordin e anijes. Në rast dyshimi për këtë problem, nevojitet kryerja e një testi praktik.

#### 5.4 Tuberkulozi

- Tuberkulozi i patrajtuar apo infeksione të tjera të rënda paraqesin rrezik të lartë. Në rastet kur aplikuesi ka vuajtur nga tuberkulozi apo infeksione të tjera të rënda të mushkërive, atëherë nga mjeku përkatës merret një dokument për të vërtetuar se detari nuk është më infektues.

#### 5.5 Rrezet X të gjoksit

- Rrezet-X të gjoksit janë të nevojshme në fillim p.sh. për vizitat mjekësore para fillimit të punës në det dhe përdoren kur ka një histori tuberkulozi, ose pneumotoraksi dhe/ose kur tregohet klinikisht. Nuk ka kërkesa për të bërë reze-X rutinë të gjoksit.

#### 6. Sistemi i tretjes

##### 6.1 Dhëmbët dhe mishi i dhëmbëve



●Detarët duhet të jenë të shëndetshëm nga ana dentare, meqenëse ndryshe nga lehtësimet e përkohshme të dhimbjeve, në bordin e anijes nuk ekziston mjekimi dentar. Abscesi dentar ose gjingjiviti i rëndë paraqet rrezik të lartë. Kontrolli dentar mund t'u nevojitet detarëve që kanë dhëmbët e pjekurisë.

#### 6.2.Ulcera peptike

●Ulcerimi peptik akut paraqet rrezik të lartë.

●Megjithatë, ulcerimi peptik i trajtuar është i pranueshëm me kusht që Inspektori Mjekësor të jetë i kënaqur me faktin se rreziku i përsëritjes, veçanërisht hemorragjia, është minimal. Në këtë rast, mund të kërkohej nga mjeku i trajtimit një dokument së bashku me raportin e endoskopisë.

#### 6.3Mëlçia dhe pankreasi

●Historia e sëmundjes kronike apo të përsëritur të pankreasit, paraqet rrezik të lartë. Sëmundja e rëndë ose progresive e mëlçisë siç është cirroza me komplikime të variceve të ezofagut, paraqet rrezik të lartë.

#### 6.4Sëmundja e fshikës së tëmthit

●Një person që ka një histori të sëmundjes së fshikës së tëmthit dhe/ose të inflamacionit të kanaleve biliare duhet të vlerësohet me kujdes për rrezikun e rishfaqjes përpara se të pranohet si i përshtatshëm për detyrë në det.

#### 6.5Hernia

●Hernia paraqet rrezik të lartë nëse nuk trajtohet në mënyrë kirurgjikale, me përjashtim të rastit kur aplikuesi i cili ka pasur hernie të vogël inguinale ku nuk ka rrezik të zënies së frymës dhe ku sipas mendimit mjekësor nuk ka shenja klinike për ndërhyrje kirurgjikale, mund të përcaktohet si i aftë për ngritjen e peshave.

●Ngatërimi i zorrës së trashë dhe hernia e kërthizës duhet të rregullohen nëpërmjet operacionit përpara se aplikuesit të pranohen si të përshtatshëm për ngritjen e peshave.

Hernia e diafragmës pa nxjerrë jashtë përdorimit refluksin e ezofagut ose simptoma të tjera, është e pranueshme.

#### 6.6 Kolostomia (operacioni i zorrës së trashë për të mundësuar jashtëqitjen artificiale)

●Një person që nuk ka gojëz të ndërlikuar, është i pranueshëm me kusht që shkaku kryesor të jetë në përputhje me punën në det të hapur dhe të ketë lehtësira të mjaftueshme për të ndryshuar qeset e kolostomisë në bordin e anijes.

#### 6.7Sëmundjet e zorrëve

●Ekuipazhi i shërbimit nuk duhet të ketë sëmundje infektive të zorrëve, duke përfshirë hepatitin A. Për zbulimin e antitropave antimikrobe të hepatitit A, mund të kërkohej një kampion gjaku në qoftë se aplikuesi nuk vërtetohet se gëzon imunizim të kënaqshëm. Kampioni i gjakut kërkohej vetëm për detarët që shfaqin simptoma dhe kur ka arsye klinike për të dyshuar për hepatitin A.

●Ekuipazhi i shërbimit dhe personat në kontakt me ujërat e zeza (p.sh., inxhinierët që merren me ruajtjen e impianteve të ujërave të zeza) duhet të jenë të imunizuar nga hepatiti A.

### 7.Sëmundja urogenitale

●Çdo person që ka gjak dhe/ose proteina në analizën e urinës, duhet të trajtohet me kujdes për të përjashtuar gjendjen që mund të keqësohet papritur dhe kërkon trajtim mjekësor të menjëhershëm, p.sh., gur në veshka.

●Në rastin e gurit në veshka këshillohet marrja e lëngjeve në mot të nxehtë. Prania e gurit në veshka i patrajtuar paraqet rrezik të lartë.

●Mosmbajtja e urinës paraqet rrezik të lartë.

●Hidrocela e madhe e patrajtuar paraqet rrezik të lartë. Hidrocela e vogël pa simptoma është e pranueshme.

●Prostata, për shkak të hipertrofisë prostatike që mund të shkaktojë simptoma urinare të tilla si rrjedhja e shpeshtë apo e dobët, paraqet rrezik të lartë deri në momentin që trajtohet për shkak të vështirësisë së mbajtjes akute të urinës.

●Mosfunksionimi menstrual që mund të çojë në dhimbje të forta apo hemorragji, p.sh. endometrioza ose rrjedhja e rëndë, paraqet rrezik të lartë.

●Shtatzënia ndikon në përshtatjen për punë në det për shkak të:

○Rrezikut të hipotensionit (tensionit të ulët), veçanërisht në ujë të nxehtë.

○Vështirësisë për t'u ngjitur për arsye të madhësisë së rritur të barkut dhe ngarkesës së shtuar kardiovaskulare.

○Neveria nga 'sëmundja e mëngjesit' që mund të përkeqësohet nga kushtet e detit.

○Kujdesi i paralindjes dhe obstetrik nuk janë në dispozicion në det, dhe një abort i mundshëm mund të përbëjë rrezik për jetën.

●Shtatzënia pra paraqet rrezik të lartë me përjashtim të rastit kur gruaja ka pasur shtatzëni të mëparshme pa komplikacione, është më pak se 28 javëshe në shtatzëninë e saj dhe punon vetëm në linja të shkurtra bregdetare. Në këtë rast duhet marrë raportin nga mjeku obstetër.

### 8.Sistemi neurologjik

●Humbja e papritur e vetëdijes ose humbja e kontrollit të gjymtyrëve apo ekuilibrit, dëmton aftësinë për të kontrolluar një anije, mjetet e vogla lundruese të anijes ose një vinç, si dhe aftësinë për të punuar në lartësi ose vetëm.

#### 8.1.Epilepsia

●Epilepsia mund të ndikohet nga lodhja e tepërt. Turnet e punës mund të përkeqësojnë gjendjen në qoftë se personi nuk merr gjumin e mjaftueshëm. Epilepsia e konfirmuar ose aktuale, me kriza gjatë 2 viteve të mëparshme, paraqet rrezik të lartë. Për detarët me epilepsi të mirëkontrolluar, duhet të paraqiten të dhëna për trajtimin dhe kontrollin e epilepsisë (p.sh. një letër nga



specialisti përkatës) në mënyrë që gjendja të jetë e pranueshme.

- Megjithëse vetëm rreth një e treta e pacientëve me një krizë të parë të paprovokuar do të provojnë kriza të tjera brenda 5 viteve, rreth 75% e pacientëve me dy ose tre kriza të paprovokuara provojnë kriza të tjera brenda 4 vjetëve.
- Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet rastit të konvulsioneve që ndodhin te një fëmijë mbi moshën 5 vjeç, i cili nuk ka pasur kriza për një periudhë të paktën dy-vjeçare, dhe të cilit nuk i nevojitet mjekimi përkatës.
- Një krizë e vetme e mëparshme ose një grup krizash për shkak të rethanave të veçanta të papërsëritshme (p.sh. dëmtimi i kokës që është shëruar plotësisht) mund të jenë të pranueshme.

### 8.2 Migrena

- Goditjet e forta akute të migrenës që mund të shoqërohen në shenja neurologjike të tilla si dobësimi i muskujve të njëjës anë të trupit dhe defektet vizuale, paraqesin rrezik të lartë.
- Migrena është e pranueshme kur nuk pengon aftësinë për të punuar në mënyrë të sigurt.

### 8.3 Goditja e trurit

- Rasti i hemorragjisë cerebrale në përgjithësi paraqet rrezik të lartë. Megjithatë, në varësi të shkallës së shërimit nga goditja, dhe me kusht që aftësitë e zgjidhjes së problemeve dhe gjykimi të mos jenë prekur, një person mund të konsiderohet i përshtatshëm për punë në det pas vlerësimit neuropsikometrik dhe raportit të mjekut neurolog/i rehabilitimit që dëshmon se sëmundja nuk përsëritet dhe nuk ka paaftësi të mbetur.

### 8.4 Goditjet e përkohshme të ishemiës (TIAs)

- Nëse shkaku kardiak për ngjarje të tilla zbulohet dhe trajtohet, çdo kufizim duhet të bazohet në prognozën e gjendjes, dhe mundësinë e përsëritjes.
- Gjendja mund të jetë e pranueshme kur përcaktohet etiologjia e goditjeve, zhduket shkaku kryesor, dhe për gjashtë muaj nuk ka pasur goditje.
- Në raste të tilla siç përshkruhen më lart, nevojitet kontrolli nga kardiologu/neurologu.

### 8.5 Çrregullimet neuromuskulare që përfshijnë sklerozë të shumëfishtë, parkinsoni

- Sëmundja e parkinsonit, skleroza e shumëfishtë, apo çrregullime të tjera neuromuskulare që nuk lejojnë kontrollin në anije, vinça ose pajisje të tjera, dhe ku paaftësia është më shumë se thjesht dobësi e vogël muskulore, mund të ndikojnë në aftësinë për të ngjitur shkallët me litar të anijes dhe shkallët prej çeliku. Në përgjithësi këto kushte paraqesin rrezik të lartë për shkak të natyrës progresive të shumicës së formave të çrregullimeve neuromuskulare.
- Parkinsoni i shkaktuar nga ilaçet mund të zhduket me ndërprerjen e trajtimit. Nëse kjo ndodh, dhe rasti kryesor për të cilin janë dhënë ilaçet nuk përbën shkak për përjashtim në të drejtën e vet, atëherë aplikanti mund të konsiderohet i aftë për detyrën në det.

### 9. Kushtet psikiatrike

- Çrregullimet afektive ndikojnë në gjykimin, vëmendjen dhe aktivitetin motor dhe inspektori mjekësor duhet të vlerësojë këtë fakt në lidhje me çdo punë me përgjegjësi për funksionimin e sigurt të anijes, vinçave dhe pajisjeve, duke përfshirë procedurat emergjente. Gjithashtu, Inspektori Mjekësor duhet të jetë i ndërgjegjshëm së jeta në bordin e anijes përfshin periudha mujore larg shtëpisë, familjes dhe mekanizmave të tjerë mbështetës, duke përfshirë mbështetjen psikiatrike.
- Rasti akut i sëmundjes mendore (p.sh. skizofrenia, depresivi maniak ose psikoza të tjera) apo sëmundjet mendore kronike të shfaqura nga simptoma që tregojnë rikthimin ose përqendrimin e sëmundjes në masën që i sëmurit mund të dëmtojë veten ose të tjerët, anijen apo ngarkesën e saj, paraqet rrezik të lartë.
- Çrregullimi mendor që kërkon terapi me ilaçe psikotrope, paraqet rrezik të lartë në qoftë se efektet anësore të këtij mjekimi ndikojnë në vigjilencën, koordinimin, shkaktojnë përgjumje ose hipotension (tension të ulët) postural.
- Çrregullimi mendor aktual ose i mëparshëm që ndikon në gjykimin ose aftësinë psikomotore, paraqet rrezik të lartë.
- Në rastet kur sëmundja mendore është kontrolluar dhe mjeku psikiatër lëshon një raport sipas të cilit sëmundja nuk ka të ngjarë të përsëritet, personi mund të konsiderohet i përshtatshëm për punë, me kusht që t'i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm.
- Në të gjitha rastet, kur ka dyshime për formën mjekësore, kërkohet konsultimi me mjekun psikiatër.

### 10. Medikamentet, ilaçet dhe alkooli

- Disa receta, të dhëna në rrugë ligjore, ose substanca të paligjshme kanë aftësinë të ndryshojnë vizionin, perceptimin, gjykimin, shtrirjen e vëmendjes, funksionin motor dhe karakteristika të tjera të rëndësishme, në funksionimin e sigurt të anijeve, vinçave, tornove dhe pajisjeve motorike.

### 10.1 Ilaçet e dhëna me recetë

- Çështjet kryesore me këto ilaçe në lidhje me përshtatshmërinë për punë në det, janë:
  - A rrezikojnë efektet anësore sigurinë e personit apo të tjerëve?
  - A duhet të kontrollohet mjekimi?
  - A është sëmundja kryesore, për të cilën është dhënë mjekimi, në përputhje me punën në det?
  - Çfarë efektesh mund të shkaktojë mosmarrja e disa dozave nëse sëmundja e detit nuk lejon marrjen e mjekimit?
- Nëse mjekimi jepet për një kohë të shkurtër, personi mund të konsiderohet përkohësisht i papërshtatshëm dhe të rikontrollohet.
- Dhënia për një kohë të gjatë e ilaçeve, mund të çojë në tolerancën e efekteve anësore qetësuese, p.sh. antihistamina



(antialergjik). Pas stabilizimit të gjendjes, marrja e mjekimit në vetvete nuk përbën pengesë për të punuar në impiante dhe pajisje të ndryshme. Inspektori mjekësor duhet të jetë i kënaqur që personi nuk vuan nga efekte anësore qetësuese dhe është i vetëdijshëm për efektet në rritje të alkoolit.

- Përdorimi afatshkurtër apo afatgjatë i ilaçeve të caktuara psikoaktive kërkon minimalisht të bëhet paralajmërimi i theksuar për rritjen e efektit nga alkooli. Është e pëlqyeshme që të ndërmerret terapi alternative, me ilaçe jopsikoaktive nëse është e mundur. Secili rast duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe të diskutohet me mjekun e personit.

- Vlerësime më të shpeshta në këtë drejtim janë të nevojshme.

- Personat që përdorin antihistamina, duhet të përdorin ato me efekte anësore qetësuese më të vogla, p.sh. astemizolin (Hismanal).

- Agjentët citotoksike, insulina, kortikosteroidet orale paraqesin rrezik të lartë.

- Qetësuesit e mëdhenj, narkotikët dhe hipnoza paraqesin rrezik të lartë. Një histori e mëparshme e trajtimit të tillë, kërkon shqyrtim të mëtejshëm.

- Mjekimi i përcaktuar duhet të renditet në formularin e vlerësimit të shëndetit. Aplikuesi duhet të paralajmërohet se ai ose ajo duhet të marrë mjekimin e mjaftueshëm.

**Tabela 3: Kategoritë e ilaçeve që ndikojnë në aftësitë e individit për të punuar në anije, varka, impiante dhe pajisje, duke përfshirë vinçat.**

<i>Grupi i ilaçeve</i>	<i>Shembuj</i>
Agjentët qetësues, hipnotik ose kundër ankthit	Barbiturati, benzodiazepani
Analgjezikët	Kodeina, narkotikët, propoksifeni
Agjentët oftalmik (aktuale)	Shumica e agjentëve për trajtimin e glaukomës
Agjentët antialergjik	Antihistamina
Medikamentet e bronkeve dhe astmës	Salbutamoli, beklometazon dipropionat, sodium kromaglikate budesonide
Antibiotikët	Minociklina
Agjentët andidepresiv dhe antipsikotik	Antidepresiv haloperidol fenotiazinë triciklik
Antikonvulsantët	Sodium valprate fenitoinë
Antikoagulantët	Aspirina komadinë
Antihipertensivët	Klonidina metildopa reserpinë
Agjentët kundër të përzierit në udhëtim	Antihistamina
Substanca pa receta	Alkooli, amfetamina, kokaina, marihuana

### 10.2 Ilaçet e paligjshme

- Ilaçet e paligjshme të tilla si narkotikët, kanabis dhe amfetaminat mund të pakësojnë aftësinë e personit për të drejtuar anijet, vinçat dhe makineritë. Ekzaminimi i ilaçeve nuk është i nevojshëm për Certifikatën e Formës Mjekësore, megjithëse punëdhënësit mund të fillojnë ekzaminimin e ilaçeve dhe alkoolit si pjesë e politikës së kompanisë.

- Përdorimi i të gjitha ilaçeve të paligjshme paraqet rrezik të lartë.

### 10.3 Alkooli

- Alkooli nënkuptohet si një faktor i rëndësishëm në aksidentet në punë. Është kërkesë ligjore që të gjithë personat, gjatë kohës që punojnë në një anije tregtare, të kenë nivelin zero të alkoolit në gjak.

- Marrja kronike në sasi të madhe e alkoolit (60 g në ditë) dëmton funksionet njohëse të tilla si përpunimi dhe përdorimi i informacioneve ndijimore dhe pakëson shpejtësinë dhe saktësinë e reagimit ndaj detyrave psikomotorë. Kjo gjendje mund të mos bëhet e dukshme deri në momentin kur personi ndodhet në situatë emergjente.

- Personi me një histori të qartë dhe prova klinike të abuzimit kronik me alkoolin, ku ka të dhëna të dëmtimit të pjesës fundore të organit të tillë si dëmtimi organik i trurit apo hepatomegalia (sëmundja e mëlçisë), paraqet rrezik të lartë.

- Një detar që është diagnostikuar se vuan nga alkoolizmi, nuk duhet të konsiderohet i përshtatshëm për punë para se të përfundojë një program rehabilitimi dhe inspektori mjekësor të jetë i bindur se detari është i përshtatshëm për t'iu rikthyer shërbimit në anije (shih shënimin në fund).

### 11. Sëmundjet muskulore-skeletore

- Lëvizja normale, shkathtësia dhe fuqia në shpinë dhe në të gjitha gjymtyrët, është e rëndësishme për detyrat që përfshijnë ngjitjen, ngritjen e peshave dhe punën në hapësira të kufizuara.

- Anijet kanë shkallë të pjerrëta, shkallë prej litari dhe shkallë vertikale prej çeliku për t'u ngjitur si dhe kapak hambari (kapanxhë) për të kaluar.

- Moti i ashpër rrit nevojën për këmbë të forta dhe fuqi të shpatullave, fleksibilitet dhe shkathtësi në lidhje me ngjitjen.

- Shumica e detyrave për ngritjen e peshave janë 25 kg ose më pak dhe mjetet e ngritjes së peshave përdoren shumë (vinça dhe çikrikë, vinça pirun) si në anije ashtu edhe në breg. Ngritja e peshave është më e vështirë për t'u kontrolluar gjatë procedurave emergjente për të lëvizur zinxhirët në kuvertë apo për të ngritur peshat dhe për t'i transportuar në hapësira të mbyllura.

- Rrezik të lartë paraqesin kushtet e mëposhtme:



○ Amputimi ose humbja kongjenitale e një prej gjymtyrëve të sipërme ose gjymtyrëve të poshtme nëse kjo ndikon në ngjitje.  
 ○ Amputimi ose humbja kongjenitale e një prej gjymtyrëve të poshtme që ndikojnë në përdorimin e kontrollit të këmbëve.  
 ○ Nevropatia periferike që rezultojnë në humbjen e ndjesisë ose ekuilibrit në pjesët fundore meqenëse e bën ngjitjen të vështirë.  
 ○ Paqëndrueshmëria e pashëruar e gjurit, p.sh. ndrydhja, nxjerrja.  
 ○ Zhvendosja/nxjerrja e pashëruar e shpatullës.  
 ○ Infiamacioni akut dhe dhimbja në ndonjë kyç që pengon përqendrimin ose dëmton lëvizjet në mënyrë të tillë që zbritja nga një varkë nuk mund të kryhet në mënyrë të sigurt – mund të jetë e nevojshme që personi të rikontrullohet në një datë të mëvonshme.

● Kushtet e mëposhtme paraqesin gjithashtu rrezik të lartë sepse ndikojnë në aftësinë për të kryer punë me dorë, për të ngjitur shkallët dhe herë pas here krijojnë qëndrime të pavolitshme në sallat e makinerive dhe hapësira të tjera të kufizuara:  
 ○ Radha e shkurtuar e lëvizjeve ose dhimbja kur rrotullohet qafa – pamundësia për të shikuar prapa dhe/ose lart gjatë punës në pajisje që përfshijnë vinçat dhe çikrikët.  
 ○ Dhimbja e pjesës fundore të shpinës e cila ndikon në aktivitetet e përditshme të jetës dhe/ose rezultojnë në pamundësinë për të punuar me lopatë, për t'u ngjitur, mbron qëndrime të pavolitshme të vazhdueshme dhe/ose të përsëritura.  
 ○ Lëvizjet e mundimshme kurriore ose të shpatullave me apo pa kufizime në drejtim të forcës.

● Inspektori mjekësor duhet të bëjë një vlerësim të kujdesshëm të personit me protezë të gjymtyrëve të poshtme (p.sh. për një amputim poshtë gjurit). Personi mund të nevojitet të bëjë një test aftësie për të provuar se ai mund të ngjitet në shkallët prej litari, shkallët prej çeliku dhe shkallët e anijes, ose ndryshe mund të paraqesë performancë të kënaqshme të punës në det.

● Gjithashtu testi i aftësisë mund të nevojitet kur një person vuan nga humbja e rëndësishme e drejtimin të lëvizjeve ose humbja e forcës së muskujve.

● Kur ka dyshime për lëvizshmërinë, inspektori mjekësor duhet të kërkojë kryerjen e një testi praktik duke kontaktuar me punëdhënësin përkatës.

## 12. Diabeti dhe çrregullime të tjera endokrine

### 12.1 Diabeti melit

● Inspektori mjekësor duhet të ketë parasysh rrezikun për sigurinë nëse aplikuesi ka pasur goditje nga hipoglicemia ose ka kaluar në gjendje kome ketacidotike (diabetike). Në veçanti, duhet t'i kushtohet kujdes detyrave të vrojtimit pasi ka periudha kur kapiteni ose ndihmëskapiteni është vetëm në urë dhe përgjigjet për sigurinë e anijes ndërkohë që punonjësi i integruar apo ndihmëskapiteni i integruar është duke bërë rrotullimin e anijes.

● Insulina me vartësi nga *diabetes mellitus* është më e vështirë për t'u përdorur nga një person në punë me turne. Gjithashtu problem përbën përdorimi i trajtimit emergjent në det për një person në koma që kërkon terapi urgjente intravenoze.

● Kushtet e mëposhtme paraqesin rrezik të lartë:

○ Insulina me vartësi nga diabeti melit (IDDM)

○ Mungesa e insulinës me vartësi nga diabeti i mjekuar në mënyrë të dobët, e cila paraqet interpretim të pakënaqshëm të glikometrit dhe/ose glicemi të përsëritur.

● Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit (EHO) kanë formuluar Udhëzimet për kryerjen e kontrolleve para-detare dhe periodike të formës mjekësore, sipas të cilëve personat që vuajnë nga IDDM nuk mund të shërbejnë në det.

● Mund të pranohen detarët ose aplikuesit që demonstronjë qëndrim të përgjegjshëm të vetë-menaxhimit të gjendjes së diabetit dhe që paraqesin raportin e mjekut të tyre që konfirmon kontrollin e saktë të diabetit, mungesën e komplikacioneve (ulcera, retinopatia, sëmundjet e veshkave) dhe aftësinë e tyre për të punuar me turne pa pasur rrezikun e goditjes nga hipoglicemia.

● Nëse diabeti i personit aktualisht nuk është trajtuar, p.sh. për shkak të ndryshimit të terapisë, mund të jetë e nevojshme që personi në fjalë të konsiderohet përkohësisht i papërshtatshëm për punë dhe t'i nënshtrohet rikontrullit në një periudhë prej tre muajsh.

### 12.2 Sëmundja e tiroideve

● Përshtatshmëria për punë në det varet nga shkalla e kontrollit të sëmundjes së tiroides, mungesa e komplikacioneve, veçanërisht atyre kardiake, dhe nga kërkesat për ndjekjen e mjekimit.

### 12.3 Sëmundja e veshkave

● Çrregullimet që ndikojnë në prodhimin e hormonit adrenokortikal të tillë si sindromi Cushing ose sëmundja Addison, paraqesin rrezik të lartë nëse nuk është trajtuar shkaku themelor dhe funksioni adrenal (i veshkave) i personit të jetë i mjaftueshëm.

## 13. Çrregullimet e lëkurës

### 13.1 Infeksionet e lëkurës

● Sëmundja ngjitëse e lëkurës paraqet rrezik të lartë në qoftë se nuk është trajtuar dhe nuk është më ngjitëse.

### 13.2 Sëmundja e pezmatimit të lëkurës

● Ekzema e lehtë endogjene është e pranueshme por inspektori mjekësor duhet të jetë i bindur që kjo gjendje nuk do të përkeqësohet nga ekspozimi me vajra, detergjentë apo substanca të tjera në punë në atë masë që e bëjnë personin të papërshtatshëm për punë në det.

● Psoriaza (sëmundja kronike e lëkurës), e pashoqëruar me poliartritin, është e pranueshme.



#### 14.Sëmundja e hemopotisë (sëmundje gjaku)

- Testet rutinë të gjakut nuk kërkohen për vlerësimin e formës mjekësore në qoftë se nuk ka shenja klinike, të tilla si anemia, limfadenopatia, hemartroza.
- Çrregullimet e koagulimit të tilla si mangësia e faktorit VIII, paraqesin rrezik të lartë pasi zakonisht trajtimi i hemorragjisë akute traumatike në det me zëvendësimin e faktorëve të koagulimit, është i pamundur.
- Leucemia dhe sëmundjet mieloproliferative paraqesin rrezik të lartë.
- Leucemia limfatike kronike, nëse është e lehtë dhe simptomatike, mund të jetë e pranueshme.

#### 15.Sëmundjet infektive

- Sëmundja infektive aktive paraqet rrezik të lartë. Tuberkulozi dhe sëmundjet ngjitëse të lëkurës janë përmendur në pjesët përkatëse.
- Stafii i furnizimit me ushqime nuk duhet të ketë sëmundje të zorrëve që përfshijnë hepatitin A.
- Testi HIV nuk kërkohet si rutinë dhe nuk duhet të bëhet nëse nuk ka shenja klinike. Ndërkohë që testi HIV pozitiv nuk përbën pengesë për punësimin, prova e AIDS (Sindromi i Fituari i Mungesës së Imunitetit), paraqet rrezik të lartë.
- Shqetësim të veçantë paraqesin sëmundjet neurologjike dhe neuropsikiatrike të cilat rrezikojnë sigurinë.

#### 16.Neoplazmat (tumoret)

- Neoplazmat e çdo lloji nuk lejojnë aplikuesin apo detarin të punojë në det për shkak të:

○ Simptomave akute, p.sh. hemianopia me tumoret e hipofizës.

○ Komplikacionet, p.sh. emboli pulmonar.

○ Efektet anësore të trajtimit/mjekimit, p.sh. mungesa e imunitetit, anemia, të përzier.

- Sëmundja malinje e hapur paraqet rrezik të lartë.

● Detarët duhet të rivlerësohen me kujdes pas konfirmimit të diagnozës së kancerit dhe trajtimit të filluar. Gjithashtu duhet të merren parasysh historia e lindur dhe prognoza e neoplazmës. E rëndësishme është që të vlerësohen me kujdes përparimi dhe gjasat e komplikimeve të sëmundjes apo trajtimi i saj.





## Analizat e detyrave të punës

1. Kapitani/ndihmëskapiteni/piloti	
<b>Shikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të lexojë udhëzimet</li> <li>● Të lexojë manualët e udhëzimeve</li> <li>● Të lexojë hartat detare</li> <li>● Të lexojë hartat e motit</li> <li>● Të dallojë dritat e kuqe/të bardha/të gjelbra të lundrimit</li> <li>● Të dallojë mjetet me ngjyra të alarmit</li> <li>● Të vëzhgojë drejtimit e anijeve të tjera</li> <li>● Të lexojë radarët, GPS dhe monitorë të tjerë (digjital, analog dhe grafik)</li> <li>● Të lexojë ekranet e kompjuterëve</li> <li>● Të identifikojë dritat e lundrimit nga farët, vozat, kullat e farëve, nga mjete të tjera lundrimi</li> <li>● Të vrojtojë për pengesat në lundrim</li> <li>● Të ketë pamje të qëndrueshme vrojtimi natën dhe perceptim të thellësisë</li> </ul>
<b>2. Dëgjimi/të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të japë/marrë udhëzime</li> <li>● Të përdorë telefonat dhe radiot marrëse-dhënëse</li> <li>● Të dallojë alarme të ndryshme kontrolli</li> </ul>
<b>3. Vetëdija</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të jetë në gatishmëri për ndryshimet në dridhjet e makinerive p.sh.motorët</li> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj lëvizjeve të anijeve të tjera</li> <li>● Të jetë në gatishmëri për pozicionin e varkave ndihmëse të anijes</li> <li>● Të interpretojë informacionet komplekse nga pajisjet e kompjuterizuara digjitale, analoge dhe grafike a.i. radar GPS, harta detare të kompjuterizuara, busulla</li> <li>● T'i përgjigjet alarmeve</li> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj ndryshimeve të motit</li> <li>● Të ketë nivel të lartë vendimmarrjeje në raste emergjente</li> <li>● Të jetë përgjegjës për sigurinë e ekuipazhit të anijes dhe sigurinë e anijes</li> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj lëvizjeve dhe pozicionit të ekuipazhit</li> </ul>
<b>4. Fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të ngjisë shkallë të ngushta, të pjerrëta</li> <li>● Të ngjisë shkallë litari 3 metra në det</li> <li>● T'i ngjitet direkt të anijes*</li> <li>● Të ngjisë shkallët prej çeliku</li> <li>● Të ngrejë kapanxhën*</li> <li>● Të gjejë teknikat e motorit të kursit detar në hartat detare, të përdorë tastierat në kompjuter, të rrotullojë dorezat, të tërheqë levat, të shtypë butonat</li> <li>● Të ndihmojë në ngritjen e peshave, në punë krahu p.sh. cilindra, bateri 25 litërshe etj.*</li> <li>● Të ndihmojë në pastrimin/mirëmbajtjen e urës (kabinës së timonit)*</li> <li>● Të vendosë etiketa për kontrollet e sigurisë*</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të pastrojë kabinën e tij, dushin, dmth përkulja, zgjatja, pastrimi me furçë, fshirja (ndryshon nga anija në anije)*</li> </ul> <b>Aspekte të tjera për anije furnizimi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Të transportojë mallra në kuvertën e pasme të anijes së furnizimit*</li> <li>● Të përdorë kablo, zinxhirë dhe litarë gjatë ankorimit</li> <li>● Të transportojë*</li> <li>● Të mbërtheja dhe zbërthejë kavot e rimorkimit*</li> </ul>
<b>5. Të Tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të punojë me turne (shërbime 4 ose 12 orëshë)</li> <li>● Të punojë herë pas here me orë të gjata pune (18+)</li> <li>● Të shkruajë raporte (ditari i anijes)</li> <li>● Të planifikojë riparimet e anijes*</li> <li>● Të planifikojë grafikun e punës</li> <li>● Të qëndrojë në det deri në 6 muaj pa ndërprerje*</li> <li>● Të kalojë nëpërmjet kapaxhave të shpëtimit*</li> <li>● Të punojë në temperatura të larta, lagështirë dhe/ose të në të ftohtë ekstrem &amp; në stuhi/ciklone, etj</li> <li>● Të mbajë veshur çizme-PPE, kominoshe, kapele të rëndë, aparat mbrojtës dëgjimi dhe respirator sipas rastit</li> <li>● Të sistemojë magazinat e kuvertës*</li> <li>● Të përdorë kompjuterin për të shkruar raporte, për të mbajtur katalogë të hartave detare*</li> <li>● Të kontrollojë pajisjet e radios, varkat e shpëtimit*</li> <li>● Të inspektojë naftën, mallra të tjera, cisternat me ballast dhe ujë si dhe zona të tjera të kufizuara*</li> <li>● Të punojë në kushte të rënda të detit në kuvertë</li> <li>● Të punojë në kushte që përfshijnë dallgëzime të forta dhe lëkundje të anijes</li> </ul>

(\* Normalisht këto detyra nuk kërkohen për një pilot)

<b>2. Kryeinxhinieri/inxhinieri/elektrici/montues</b>	
<b>Shikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të lexojë kalibrat e matjeve, disqet e telefonatave</li> <li>● Të lexojë manuallet e udhëzimeve, skicat</li> <li>● Të ketë shikim nga afër të kalibrit dhe instrumenteve të tjerë</li> <li>● Të ketë shikim nga afër për të përcaktuar dhe përdorur dado, bulona, vida, kapëse, etj</li> <li>● Të ketë aftësinë për të dalluar ngjyrat bazë për të njohur alarmet me ngjyra dhe telat me ngjyra</li> </ul>
<b>2. Dëgjimi/të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të komunikojë me radio marrësedhëse</li> <li>● Të dëgjojë alarmet dhe radiot e ndërlydhjes</li> <li>● Të japë/marrë udhëzime</li> </ul>
<b>3. Vetëdija</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj ndryshimeve në dridhjet e makinerive p.sh. motorët</li> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj alarmeve (pamore dhe dëgjimore)</li> <li>● Të përgjigjet emergjencave</li> <li>● Të jetë në gatishmëri ndaj pozicionit të varkave ndihmëse të anijes</li> <li>● Të interpretojë informacione komplekse nga monitorët dhe instrumentet matës për panelet e kontrollit të instrumenteve në sallën e</li> </ul>





	makinerive
<b>4. Fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Mbajtja dhe transportimi i bobinave të kondensatorit, tubave, motorëve, pompave deri në 35 kg – por mund të mbarten nga dy persona</li> <li>● Mbajtja dhe transportimi i konteinerëve të kimikateve që peshojnë 25 kg</li> <li>● Përdor torno, sharra rrethore, vegla dore, çikrik mprehës &amp; sondë</li> <li>● Saldimi/prerja me gaz</li> <li>● Përshtat zhdërvjelltësinë manuale për vendosjen e dadove, bulonave, vidave</li> <li>● Rrotullimi i valvulave, levave</li> <li>● Shtypja e butonave</li> <li>● Ngjitja në shkallët e pjerrëta, shkallët prej çeliku, shkallët në drekun dhe vinçin e anijes</li> <li>● Qëndrimi në këmbë dhe ecje pjesën më të madhe të turnit</li> <li>● Puna në qëndrime të pavolitshme</li> <li>● Puna në hapësira të kufizuara</li> <li>● Puna në tavanin e kabinës</li> <li>● Pastron kabinën e tij, dushin, dmth përkulja, zgjatja, pastrimi me furçë, fshirja (ndryshon nga anija në anije)</li> <li>● Aspekte të tjera për anije furnizimi</li> <li>● Transporton mallra në kuvertën e pasme të anijes së furnizimit</li> <li>● Përdor kablo, zinxhirë dhe litarë gjatë ankorimit</li> <li>● Mbërthen dhe zberthen kavot e rimorkimit</li> </ul>
<b>5. Të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Punon me turne (shërbime 4 orëshe)</li> <li>● Shkruan raporte (ditari i anijes)</li> <li>● Planifikon riparimet e anijes</li> <li>● Planifikon grafikun e punës</li> <li>● Qëndron në det deri në 6 muaj pa ndërprerje</li> <li>● Kalon nëpërmjet kapanxhave të shpëtimit</li> <li>● Punon në temperatura të larta, lagështirë dhe/ose të në të ftohtë ekstrem &amp; në stuhi/ciklone, etj</li> <li>● Mban veshur çizme-PPE, kominoshe, kapele të rëndë, aparat mbrojtës dëgjimi dhe respirator sipas rastit</li> <li>● Sistemon magazinat e kuvertës</li> <li>● Ekspozimi ndaj nxehtësisë dhe tymit</li> <li>● Përdor kompjuterat për të shkruar raporte, mban katalogë të hartave detare</li> <li>● Përdorimi i sigurt i kimikateve</li> <li>● Kontrollon pajisjet e radios, varkat e shpëtimit</li> <li>● Inspekton cisternat e ujit</li> <li>● Punon në kushte që përfshijnë dallgëzime të forta dhe lëkundje të anijes</li> </ul>
<b>3. Kryepunëtori i integruar/punëtori i integruar</b>	
Shikimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Lexon udhëzimet, procedurat</li> <li>● Lexon kalibrat e matjeve, disqet e telefonatave</li> <li>● Lexon etiketat për kimikatet</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Pamja nga afër kur përdor mjete lundruese të vogla, vinça, çikrikë</li> <li>● Shikon dritat e lundrimit të anijeve të tjera, fenerëve, farëve etj.</li> <li>● Dallon sinjalet me ngjyrë të kuqe/të gjelbër/të bardhë</li> <li>● Dallon sinjalet e alarmit me ngjyra</li> <li>● Kryen shërbim – pamje natën dhe perceptim të thellësisë</li> <li>● Pamja nga afër për të identifikuar zinxhirët, markimet në fasho, bulona, dado, vida etj.</li> </ul>
<b>2. Dëgjimi/të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Merr/jep udhëzime</li> <li>● Dëgjon fishkëllimën për lëvizjet e vinçit/çikrikut</li> <li>● Përdor radio marrësedhëse</li> <li>● Dëgjon makineritë, p.sh. vinçin,</li> <li>● Dëgjon sinjalet/alarmet paralajmëruese</li> <li>● Përdor duart pa kujfe për të komunikuar me radio në det të trazuar</li> </ul>
<b>3. Vetëdija</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Në gadishmëri ndaj lëvizjeve të personave të tjerë, funksionimit të makinerive, barkave të vogla të anijes, dhe helikopterit</li> <li>● Interpreton informacionet komplekse nga pajisjet e kompjuterizuara dixhitale, analoge dhe grafike a.i. radar GPS, harta detare të kompjuterizuara, busulla</li> <li>● Monitoron pajisjet që përfshijnë leximet radare, dixhitale dhe analoge për aparatet matëse, gps, busulla dhe, në përgjithësi ndihmon pilotin në shërbim</li> </ul>
<b>4. Fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Shkathësi manuale për të lidhur nyjat, lidh litarët, lidh telat, riparon/përdor veshje mushamaje kanavacë, vendos fashot, përdor pincat, çelësat dhe mjete të tjera dore</li> <li>● Tërheqja e dorezave, levave, shtypja e butonave për të drejtuar vinçin, makineritë, furrat për asgjësimin e mbeturinave</li> <li>● Arritja dhe puna në katin e sipërm</li> <li>● Heq me lopatë hirin nga furra për asgjësimin e mbeturinave dhe transporton çantat me mbeturina në furrat përkatëse</li> <li>● Transporton furnizimet</li> <li>● Ngrihet nga kuverta në katin e sipërm për të ngarkuar varkat e vogla të anijes</li> <li>● Ngjit shkallët prej litari të anijes (3m) në det të trazuar, dhe shkallët prej çeliku në kulla (deri në 30m) ndërkohë që mban me vete litarë, çanta me pajisje ndriçimi</li> <li>● Ngritja e peshave deri në 50 kg (për dy persona)</li> <li>● Ngritja e kablllove, kutive, baterive, çikrikëve, makarave deri në 40 kg</li> <li>● Përdor mjete të forta, sharra, trapanë, armë ushtuese, dalta, vare</li> <li>● Ankorimi/nisja e anijeve</li> <li>● Përdorimi i çikrikëve me zinxhirë në ajër/elektrikë – tërheqja në litarë, zinxhirë, dhe shtypja e butonave në kuti që mbarten me dorë</li> <li>● Detyra të zdrucktharisë/riparimit të anijeve</li> <li>● Pastron kabinën e tij, dushin, dmth përkulja, zgjatja, pastrimi me furçë, fshirja (ndryshon nga anija në anije)</li> </ul> <p><b>Aspekte të tjera për anije furnizimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Transporton mallra në kuvertën e pasme të anijes së furnizimit</li> <li>● Përdor kablllo, zinxhirë dhe litarë gjatë ankorimit</li> <li>● Mbërthen dhe zberthen kavot e rimorkimit</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Qëndrimi në këmbë për periudha të gjata (3 orë)</li> </ul>
<b>5. Të Tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Punon në lartësi</li> <li>● Punon në temperaturë të lartë, lagështirë dhe/ose të ftohtë ekstrem, dhe në stuhi, ciklone, etj</li> <li>● Orë të gjata pune (deri në 10-12 orë në ditë)</li> <li>● Qëndron në det deri në 6 muaj pa ndërprerje</li> <li>● Kalon nëpërmjet kapaxhave të shpëtimit</li> <li>● Punon me turne kur është në shërbim 4-orësh</li> <li>● Kontrollon sigurinë dhe zjarrin e anijes – inspekton të gjitha zonat rregullisht</li> <li>● Planifikon oraret e punës</li> <li>● Mban veshur pajisje mbrojtëse personale, p.sh. çizme të sigurisë, shtupa për të zënë veshët ose veshore, kapele të rënda, doreza, kominoshe, syze sigurie dhe herë pas here respiratorë</li> <li>● Është i mësuar me bojëra, hollues, vajra, zhbllokues, zgrasatues</li> <li>● Përdor zorrën e ujit kundër zjarrit, zjarrfikës</li> <li>● Punon në vajra, ngarkesa të tjera, cisterna me ballast dhe ujë, si dhe në zona të tjera të kufizuara</li> <li>● Punon në kushte që përfaqësojnë dallgëzime të mëdha dhe lëkundje të anijes</li> </ul>
<b>4. Kryekuzhinieri/Kuzhinieri/Kamarieri</b>	
<b>Shikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Shikim nga afër për të lexuar etiketa, menu, receta, kompjuter, udhëzues, porosi për furnizime, fatura, teleksë, fakse</li> <li>● Pamje nga afër për prerje, rrisim, gatim</li> <li>● Pamje nga afër për të identifikuar zinxhirët, markimet në fasho, bulona, dado, vida etj.</li> </ul>
<b>2. Dëgjimi/të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Merr/jep udhëzime</li> <li>● Përdor telefonat për të komunikuar me furnizuesit, klientët</li> <li>● Komunikon me ekuipazhin e anijes</li> <li>● Dëgjon alarmet</li> </ul>
<b>3. Vetëdija</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Në gatishmëri për lëvizjet e personave në kuzhinën e anijes për shkak të ushqimit të nxehtë në tenxhere dhe tabaka</li> <li>● Në gatishmëri për vendosjen e tiganëve të thellë, enëve të gatimit, veçanërisht në mot të ashpër</li> <li>● Në gatishmëri për rreziqet në anije, p.sh. zjarri etj.</li> </ul>
<b>4. Fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Mbatja, transportimi, zbrazja e furnizimeve nga shkalla-urë apo kuverta në magazinë dhe nga magazina në kuzhinën e anijes</li> <li>● Zbraz dhe vendos furnizimet në ndarjet e frigoriferëve nga dyshemeja në lartësinë e shpatullave</li> <li>● Zbraz kuti kartoni në çdo udhëtim, p.sh. pije të buta, kanaçe, artikuj ushqimor dhe mjete pastrimi</li> <li>● Pastrimi i tenxhereve dhe enëve të kuzhinës</li> <li>● Fshirja e stolave, sipërfaqes së sobës</li> <li>● Pastrimi i kuzhinës së anijes dhe lavanderisë – pastrimi me leckë, pastrimi me furçë</li> <li>● Pastron fshirëset e frigoriferëve</li> <li>● Pastron korridoret</li> <li>● Qëndron në këmbë për orë të gjata (3 orë)</li> <li>● Përdor shkathtësinë manuale për të përdorur enë kuzhine, thika dhe për të ndezur e fikur butonat, pastron çelësat në furra, pjata të nxehta dhe pajisje</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Pastron kabinën e tij, dushin, d.m.th. përkulja, zgjatja, pastrimi me furçë dhe fshirja</li> <li>● Pastron vendet e yndyrave dhe serbatorët</li> <li>● Pastron furrat dhe ngrirësit e thellë</li> <li>● Pastron shkallë të ngushta</li> </ul>
<b>5. Të Tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Porosit të gjithë furnizimin me ushqime</li> <li>● Planifikon menytë</li> <li>● Gatimi i të gjitha vakteve për të gjithë personat në bord</li> <li>● Punon më turne duke filluar punën herët plus orë shtesë për administrimin dhe dokumente të tjera</li> <li>● Qëndron në det për 6 muaj pa ndërprerje megjithëse ndalon në porte të ndryshme gjatë udhëtimit</li> <li>● Kalon nëpërmjet kapaxhave të shpëtimit</li> <li>● Përdor kompjuterin</li> <li>● Mban veshur këpucë sigurie</li> <li>● Punon në kushte që përfshijnë dallgëzime të mëdha dhe lëkundje të anijes</li> </ul>
<b>5. Shërbyesi dhe kamerieri i furnizimit me ushqime</b>	
<b>1. Shikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Shikim nga afër për: <ul style="list-style-type: none"> <li>-Leximin e etiketave</li> <li>-Leximin e udhëzimeve</li> <li>-Pastrimin e dysHEMEVE, sipërfaqeve etj.</li> </ul> </li> <li>● Dallon alarmet e dritave me ngjyrave/dritat e indikatorëve në kuzhinën e anijes</li> </ul>
<b>2. Dëgjimi/të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Jep/merr udhëzime</li> <li>● Dëgjon alarmet</li> <li>● Komunikon me ekuipazhin dhe pasagjerët e anijes</li> </ul>
<b>3. Vetëdija</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Në gatishmëri për lëvizjet e personave të tjerë në kuzhinën e anijes, qilar, për shkak të tenxhereve të nxehta, tabakave me ushqime etj.</li> </ul>
<b>4. Fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Pastrim i përgjithshëm i pjesës së brendshme të anijes p.sh. dritaret anësore</li> <li>● Fshirja e përditshme e dhomës rrëmujë</li> <li>● Pastrimi i dhomës dy herë në javë dhe i dysHEMEVE të tjera një herë në javë (3 nivele gjithsej)</li> <li>● Mbajtja, transportimi, zbrazja e furnizimeve</li> <li>● Mbajtja e tabakave të nxehta dhe furnizimi i magazinës</li> <li>● Mbajtja e pajisjeve të pastrimit (24 kg) nga dysHEMEJA në shkallët lart (2 persona)</li> <li>● Pastrimi, fshirja dhe/ose pastrimi i pluhurave</li> <li>● Fshirja dhe pastrimi i stolave, pjesët kryesore të kuvertës, muret ndarëse të kabinës</li> <li>● Puna mbi kokë, mbi lartësinë e shpatullave për të pastruar/fshirë sipërfaqe</li> <li>● Larja e enëve/tenxhereve në lavaman në lartësinë e belit</li> <li>● Ngarkimi/boshatisja e pjatallarësës – përkulja e nevojshme</li> <li>● Larja/tharja e çarçafëve dhe peshqirëve në ditën e ndërrimit të ekuipazhit</li> <li>● Pastrimi herë pas here i kabinave kur pasagjerët janë në bord</li> <li>● Mbajtja e banjave të pastra në të gjitha nivelet</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"><li>● Pastron kabinën e tij, dushin, d.m.th. përkulja, zgjatja, pastrimi me furçë, dhe fshirja</li><li>● Pastron të gjitha sipërfaqet me tapeta</li></ul>
<b>5. Të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>● Ndihmon Kuzhinierin për përgatitjen e ushqimit sipas kërkesës</li><li>● Punon me turne duke filluar herët në mëngjes</li><li>● Qëndron në det për 6 muaj pa ndërprerje megjithëse ndalon në porte të ndryshme gjatë udhëtimit</li><li>● Kalon nëpërmjet kapaxhave të shpëtimit</li><li>● Mban veshur këpucë sigurie</li><li>● Punon në kushte që përfshijnë dallgëzime të mëdha dhe lëkundje të anijes</li><li>● Ndërmerr rol aktiv në të gjitha ushtrimet e sigurisë dhe emergjencës së anijes</li><li>● Ndërmerr rol aktiv në menaxhimin e krizave në raste emergjente</li></ul>



### Udhëzuesi për dallimin e ngjyrave

#### 1. Domosdoshmëria për dallim të mirë të ngjyrave

- Pilotët e kuvertës duhet të dallojnë dritat e kuqe, të gjelbra dhe të bardha të lundrimit me qëllim që të marrin vendimet e duhura në lidhje me anijet që afrohen, dhe në lidhje me masat që duhen marrë për të shmangur përplasjen. Konfuzioni i shkaktuar nga ngatërimi i këtyre ngjyrave, mund të çojë në marrjen e vendimeve të pasakta me mundësi për përplasje si dhe vdekje, dëmtime dhe humbje të rezultuara.
- Në mënyrë të ngjashme, punonjësit në detyrë vëzhgimi duhet të dallojnë dritat e kuqe, të gjelbra dhe të bardha të lundrimit me qëllim që t'i japin këshillën e duhur pilotit të shërbimit.
- Pilotët inxhinierë dhe punonjësit me detyrë në sallën e makinerive duhet të dallojnë si drita paralajmëruese (zakonisht ngjyrë të kuqe) ashtu edhe dritat e fazës së duhur (zakonisht ngjyrë të bardhë ose gri) dhe gjithashtu të dallojnë ngjyrat e telave elektrike kur bëjnë lidhjet përkatëse.

#### 2. Testet

- Testet pseudoizokromatike Ishihara duhet të përdoren për të kontrolluar detarët në sektorët e kuvertës dhe makinerive për dëmtimet e dallimit të ngjyrave. Nëse testi tregon dëmtim të dallimit të ngjyrave, atëherë duhet të kryhen teste të mëtejshme.
  - Në rastin e personave që duhet të vrojtojnë në sektorin e kuvertës, testi vijues duhet të përdorë testin e fenerit të tipit B Holmes-Wright.
  - Ky test drejtohet nga disa oftalmologë (mjekë të syrit) dhe shkollat e optometrisë në universitete të ndryshme.
  - Në rastin e personave që punojnë në sektorin e makinerive, me detyrë për të bërë lidhjet elektrike, testi vijues që mund të përdoret është Testi i Tregtisë i Dallimit të Ngjyrave i Industrisë së Furnizimit me Energji në MB apo një standard i ngjashëm i BE-së.
- Personi që ka bërë një nga këto teste, nuk duhet të mbajë lente apo syze (të lyera) kromogjene.

#### 3. Testi Ishihara

- Testet pseudoizokromatike Ishihara (që përdorin setin e plotë më 38 fletë ose një version të shkurtuar me 24 fletë) janë të nevojshme për përdorim.
- Përgjigja e kënaqshme për të gjitha fletët në paraqitjen e parë, apo përgjigja e gabuar në paraqitjen e parë që korrigohet në paraqitjen e dytë ose të tretë, duhet vlerësuar se tregon pamje “normale” të ngjyrave. Nëse sipas testeve rezultojnë pamje e dëmtuar e ngjyrave, atëherë duhet të bëhen teste të mëtejshme.

#### 4. Testi i fenerit i tipit B Holmes Wright

- Testi i fenerit është një test praktik i stimuluar në kushte të një situatë vrojtimi, në lidhje me aftësinë e personit për të njohur dhe dalluar dritat e ndryshme të lundrimit që përdoren në det.
- Testi i fenerit kryhet nëpërmjet fenerit të tipit B Holmes/Wright i cili hap dritat e kuqe, të gjelbra dhe të bardha të shikuara nëpërmjet një pasqyre të lustruar në një distancë virtuale 6 metra nga sytë. Apertura e madhe e fenerit hap aperturë me dy drita me ngjyra krahpërkrah njëherësh. Çdo qark i plotë i fenerit përmban 9 vendosje të aperturave të mëdha më vete apo 9 vendosje të aperturave të vogla. Aperturat e vogla të fenerit tregojnë kombinime të mundshme të dy prej tre ngjyrave.
- Personi që përdor ndihmës për shikimin në testin e shkronjave, duhet të përdorë të njëjtin ndihmës për shikimin në testin e fenerit.
- Personi që nuk përdor ndihmës për shikimin në testin e shkronjave, nuk lejohet të përdorë ndihmës për shikimin në testin e fenerit.
- Personi që i nënshtrohet testit të fenerit nuk duhet të mbajë ndihmës të ngjyrosur shikimi me qëllim që të kalojë testin.
- Testi i fenerit duhet të kryhet në një dhomë që nuk hyn drita e diellit.
- Personi që kërkon të përshtatet në kushte të errësirës duhet të lejohet të qëndrojë në errësirë të plotë apo të pjesshme për 10 minuta për t'u përgatitur për testin e fenerit.
- Personi vlerësohet se ka kaluar testin e fenerit nëse ai ose ajo emëron me saktësi ngjyrat e një rrethi të plotë të aperturave të mëdha, 4 rathë të plota të aperturave të vogla të treguar sipas renditjes, dhe 9 vendosje të aperturave të vogla të treguara në mënyrë të rastësishme.
- Procedurat e përcaktuara nga 4.10 deri në 4.16 duhet të ndiqen kur personi që i nënshtrohet testit të fenerit, nuk arrin të kalojë.
- Në rastin kur personi gabon në emërtimin e ngjyrave siç duhet, kontrolluesi duhet të njoftojë personin për gabimin dhe vazhdon me testin, duke shtuar një tjetër rreth.
- Personi vlerësohet se ka kaluar testin nëse nuk bëhen gabime të tjera në test dhe në rrethin vijues.
- Procedura duhet të përsëritet në rast të një gabimi të dytë.



- Në rastin e një gabimi të tretë, testi duhet përsëritur nga fillimi pasi personit të testuar i është dhënë mundësia të pushojë apo ka rifituar qetësinë.
- Gjatë përsëritjes së testit të dështuar, kontrolluesi duhet të regjistrojë rezultatin por jo të njoftojë personin e testuar për gabimet e kryera.
- Në rastin e testit të përsëritur, personi vlerësohet se ka kaluar testin, nëse emërton saktë të gjitha ngjyrat.
- Ngatërrimi i ngjyrës së kuqe me të gjelbrën ose i ngjyrës së gjelbër me të kuqen në testin e përsëritur, do të thotë dështim i testit të fenerit.
- Personi që nuk ka kaluar testin e fenerit, mund të kërkojë një test tjetër.

#### 5. Testi i tregtisë i dallimit të ngjyrave

- Ky test duhet përdorur kur bëhen gabime në fletët pseudoizokromatike Ishihara.
- Aplikuesi duhet të ulet përballë Inspektorit Mjekësor në një pozicion të mirë të dritës. Nganjëherë secili nga telat me ngjyrë duhet të vendoset përballë aplikuesit mbi një sipërfaqe të sheshtë. Aplikuesit i kërkohet të përcaktojë ngjyrën e telit. Ngadalësia në përgjigje tregon vështirësi. Duhet pasur kujdes që aplikuesi të mos krahasojë ngjyrën e një teli me ngjyrat e telave të tjerë.
- Aplikuesve që përcaktojnë një ngjyrë gabim, duhet t'u jepet një tel më vete. Më pas, kontrolluesi duhet t'ia paraqesë aplikuesit nëntë telat secilin në një kohë. Kandidati duhet të pyetet se kur është kombinimi. Të gjitha nëntë ngjyrat duhet të testohen në këtë mënyrë.
- Pamundësia për të gjetur kombinimin e saktë, tregon dallim të pasigurt të ngjyrave.
- Kombinimi i saktë i ngjyrave por përcaktimi i gabuar i tyre më vete, do të thotë se do të bëhen gabime në përcaktimin e ngjyrave të caktuara pa i krahasuar ato me ngjyra të tjera.
- Aparati i kërkuar është:
  - Tel me ngjyrë një centimetër i mbuluar me plastikë është vendosur në një kartë të bardhë në një diapozitiv fotografik me ngjyrë, madhësia 5 x 5 cm, me një dritare shikimi 3.5 x 2.5 cm. Në këtë rast formohen dy sete të plota me ngjyra (18 diapozitivë), të vendosur në kasetën e diapozitivave.
  - Për qëllime kombinimi, duhet të jenë në dispozicion 9 tela më vete, një për çdo ngjyrë, secili 2.5 cm i gjatë.
  - Nëntë ngjyrat që duhet të përdoren janë: e bardhë, e zezë, e verdhë, e kuqe, gri, blu, e gjelbër, ngjyrë kafe dhe portokalli.
  - Të gjithë telat duhet të kenë diametër të njëjtë, që duhet të jetë nga 0.8 deri në 1.1 mm. Nëse është e mundur, preferohen telat me diametër 0.89 mm.

#### 6. Dokumenti nga punëdhënësi për ridallimin e ngjyrave

- Inxhinierët apo punonjësit që paraqesin një dokument apo certifikatë tjetër nga punëdhënësi përkatës se, gjatë dy viteve të fundit, dëmtimi i pamjes së ngjyrave, edhe nëse i pranishëm, nuk ka ndikuar në punën e tyre, duhet t'i nënshtrohen kontrollit nëpërmjet testit Ishihara. Në këto raste, certifikata e formës mjekësore duhet të shënohet "Po" kundrejt "Daltonik" (i verbër ndaj ngjyrave).

#### 7. Kandidatët e rinj

- Të gjithë kandidatët e rinj për inxhinierë apo të kuvertës, duhet t'i nënshtrohen kontrollit nëpërmjet testit Ishihara për të përcaktuar nëse kanë dëmtime në lidhje me dallimin e ngjyrave dhe shtrirjen e tyre.
- Kandidatët e rinj që punojnë në sektorin e furnizimit me ushqime duhet gjithashtu të kontrollohen nëse dëshirojnë të ndryshojnë specializimin e tyre më vonë.
- Dëmtimi i dallimit të ngjyrave pengon kandidatët që në karrierën e tyre përfshijnë vrojtimin detar.
- Kandidatë e tjerë me dëmtime të dallimit të ngjyrave, nuk pengohen për të punuar në det, por në rastet kur dëmtimit është i pranishëm, certifikata e formës mjekësore duhet shënuar "Po" kundrejt "Daltonik".



## ANEKSI IV



## Republika e Shqipërisë

**CERTIFIKATË E LËSHUAR SIPAS DISPOZITAVE TË KONVENTËS  
NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET E TRAJNIMIT, CERTIFIKIMIT  
DHE VROJTIMIT PËR DETARËT, 1978, E NDRYSHUAR**

Qeveria e .....vërteton se ..... është kualifikuar sipas rregullave në përputhje me dispozitat e Rregullores ..... të Konventës së mësipërme, të ndryshuar, dhe është kompetent për të kryer funksionet e mëposhtme, në varësi të kufizimeve të treguara dëri më ..... ose deri në datën e skadimit të zgjatjes së vlefshmërisë të kësaj certifikate siç tregohet në faqen tjetër:

Funksioni	Niveli	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Mbajtësi i ligjshëm i kësaj certifikate mund të shërbejë në funksionin apo funksionet e përcaktuara në kërkesat e zbatueshme të pajisjes me ekuipazh të Administratës:

Funksioni	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Certifikata Nr. .... lëshuar më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Emri i i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave





Kopja origjinale e kësaj certifikate mbahet në dispozicion në përputhje me Rregulloren I/2, paragrafi 9 i Konventës gjatë shërbimit në anije.

Data e lindjes së zotëruesit të certifikatës

Nënshkrimi i zotëruesit të certifikatës

Fotografia e zotëruesit të certifikatës

Vlefshmëria e kësaj certifikate zgjatet deri më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Data e rivlerësimit.....

Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Vlefshmëria e kësaj certifikate zgjatet deri më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Data e rivlerësimit.....

Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

2. Përveç siç parashikohet në paragrafin 1, formulari i përdorur për të vërtetuar lëshimin e certifikatës tregohet më poshtë, me kusht që fjalët “ose deri në datën e skadimit të zgjatjes së vlefshmërisë të këtij miratimi siç tregohet në faqen tjetër” në faqen e parë të formularit dhe dispozitat për regjistrimin e zgjatjes së vlefshmërisë në faqen tjetër, të lihen jashtë në rastet kur është i nevojshëm zëvendësimi i miratimit pas skadimit të tij. Udhëzuesi për plotësimin e formularit gjendet në Pjesën B-I/2 të këtij Kodi.



## Republika e Shqipërisë

**MIRATIMI I VËRTETIMIT TË LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SIPAS  
DISPOZITAVE TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET  
E TRAJNIMIT, CERTIFIKIMIT DHE VROJTIMIT PËR DETARËT, 1978, E  
NDRYSHUAR**

Qeveria e .....vërteton se certifikata Nr. .... i lëshohet ..... i cili është kualifikuar sipas rregullave në përputhje me dispozitat e Rregullores ..... të Konventës së mësipërme, të ndryshuar, dhe është kompetent për të kryer funksionet e mëposhtme, në varësi të kufizimeve të treguara dëri më ..... ose deri në datën e skadimit të zgjatjes së vlefshmërisë të këtij miratimi siç tregohet në faqen tjetër:

Funksioni	Niveli	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Mbajtësi i ligjshëm i këtij miratimi mund të shërbejë në funksionin apo funksionet e përcaktuara në kërkesat e zbatueshme të pajisjes me ekuipazh të Administratës:

Funksioni	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Certifikata Nr. .... lëshuar më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave



Kopja origjinale e kësaj certifikate mbahet në dispozicion në përputhje me Rregulloren I/2, paragrafi 9 i Konventës gjatë shërbimit në anije.

Data e lindjes së zotëruesit të certifikatës

Nënshkrimi i zotëruesit të certifikatës

Fotografia e zotëruesit të certifikatës

Vlefshmëria e këtij miratimi zgjatet deri më ..... (Vula zyrtare) Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave Data e rivlerësimit..... Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave
Vlefshmëria e këtij miratimi zgjatet deri më ..... (Vula zyrtare) Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave Data e rivlerësimit ..... Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

3. Formulari i përdorur për të vërtetuar lëshimin e certifikatës tregohet më poshtë, me kusht që fjalët “ose deri në datën e skadimit të zgjatjes së vlefshmërisë të këtij miratimi siç tregohet në faqen tjetër” në faqen e parë të formularit dhe dispozitat për regjistrimin e zgjatjes së vlefshmërisë në faqen tjetër, të lihen jashtë në rastet kur është i nevojshëm zëvendësimi i miratimit pas skadimit të tij. Udhëzuesi për plotësimin e formularit gjendet në Pjesën B-I/2 të këtij Kodi.



## Republika e Shqipërisë

**MIRATIMI I VËRTETIMIT TË NJOHJES SË CERTIFIKATËS SIPAS  
DISPOZITAVE TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET  
E TRAJNIMIT, CERTIFIKIMIT DHE VROJTIMIT PËR DETARËT, 1978, E  
NDRYSHUAR**

Qeveria e .....vërteton se certifikata Nr. .... i lëshohet ..... nga apo në emër të Qeverisë së ..... i cili është kualifikuar sipas rregullave në përputhje me dispozitat e Rregullores I/10 të Konventës së mësipërme, të ndryshuar, dhe është kompetent për të kryer funksionet e mëposhtme, në varësi të kufizimeve të treguara dëri më ..... ose deri në datën e skadimit të zgjatjes së vlefshmërisë të këtij miratimi siç tregohet në faqen tjetër:

Funksioni	Niveli	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Mbajtësi i ligjshëm i këtij miratimi mund të shërbejë në funksionin apo funksionet e përcaktuara në kërkesat e zbatueshme të pajisjes me ekuipazh të Administratës:

Funksioni	Zbatimi i kufizimeve (nëse ka ndonjë)

Certifikata Nr. .... lëshuar më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave



Emri i i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Kopja origjinale e kësaj certifikate mbahet në dispozicion në përputhje me Rregulloren I/2, paragrafi 9 i Konventës gjatë shërbimit në anije.

Data e lindjes së zotëruesit të certifikatës

Nënshkrimi i zotëruesit të certifikatës

Fotografia e zotëruesit të certifikatës

Vlefshmëria e këtij miratimi zgjatet deri më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Data e rivlerësimit.....

Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Vlefshmëria e këtij miratimi zgjatet deri më .....

(Vula zyrtare)

Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

Data e rivlerësimit.....

Emri i nëpunësit të autorizuar sipas rregullave

## **RREGULLORE**

**Nr. 2666/1, datë 21.6.2022**

### **PËR KRITERET, RREGULLAT DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË RAPORTEVE MJEKËSORE ELEKTRONIKE PËR PAAFTËSITË E PËRKOHSHME PËR PUNË, PËR BARRËLINDJE DHE PËR AKSIDENTE NË PUNË E SËMUNDJE PROFESIONALE**

Në mbështetje të neneve 21, 22, 23, 27, 28, 47 dhe 75, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017, “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”; të VKM-së nr. 419, datë 4.7.2018, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe

të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”; të VKM-së nr. 503, datë 24.6.2020, “Për mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor”, dhe të urdhrin nr. 493, datë 2.7.2019, “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratojnë këtë rregullore:

#### **KREU I TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Objekti dhe qëllimi**

1. Objekt i rregullores “Për kriteret, rregullat dhe procedurat për lëshimin e raporteve mjekësore elektronike për paaftësi të përkohshme për punë, për barrëldje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale” (në vijim rregullorja), janë raportet mjekësore elektronike për paaftësi të përkohshme për punë, për leje barrëldjeje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale që lëshohen me efekt përfitimi sipas përcaktimeve të



Kodit të Punës dhe të ardhurave të parashikuara në ligjin për sigurimet shoqërore.

2. Qëllimi i rregullores është përcaktimi i kriterëve për lëshimin e raporteve mjekësore elektronike, për paaftësi të përkohshme për punë, për leje barrëlindjeje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale, përcaktimi i rregullave dhe i procedurave që do të ndiqen e do të zbatohen nga mjekët përgjegjës dhe Komisioni Mjekësor për lëshimin e tyre.

### Neni 2 Fusha e zbatimit

Rregullorja është e detyrueshme për zbatim nga mjeku i familjes, mjekët specialistë në komisionet mjekësore sipas përcaktimeve në këtë rregullore, mjekët në spitalet publike e jopublike të licencuara, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat rajonale në varësi të tij.

### Neni 3 Përkufizime

Termat dhe emërtimet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon:

a) “Sigurim shoqëror i detyrueshëm” mbrojtje që ju ofrohet personave të punësuar, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrëlindjes, paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të sëmundjeve të përgjithshme, aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes, si dhe personave të tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me barrëlindjen, pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes;

b) “Raport mjekësor elektronik” dokument elektronik mjekësor standard, i plotësuar dhe i lëshuar nëpërmjet sistemit *e-Raporte* nga mjeku i familjes, mjekët specialistë dhe anëtarët e Komisionit Mjekësor, sipas përcaktimit në këtë rregullore;

c) “Raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë” është dokumenti elektronik mjekësor, që lëshohet/plotësohet nga mjeku i familjes, mjekët specialistë dhe anëtarët e Komisionit Mjekësor që

dëshmon e vërteton gjendjen shëndetësore të të punësuarit për një periudhë të caktuar kohore;

d) “Raport mjekësor për leje barrëlindjeje” dokument elektronik mjekësor me periudha të caktuara kohore, që i lëshohet gruas së siguar për pushim paralindjeje, paslindjeje, si dhe për kujdes ndaj fëmijës, babait të fëmijës, birësueses apo birësuesit për kujdes ndaj fëmijës;

e) “Raport mjekësor për aksidente në punë” dokument elektronik mjekësor që i lëshohet të punësuarit, i cili pëson aksident në punë, ose për shkak të punës, që nuk fillon nga sëmundje të përgjithshme, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme ose të përhershme për punë;

f) “Raport mjekësor për sëmundje profesionale” dokument elektronik mjekësor që i lëshohet të punësuarit për sëmundje të shkaktuara si rezultat i ekspozimit ndaj dëmtuesve, që rrjedhin nga veprimtaria e punës;

g) “Komisioni Mjekësor (KM)” përbëhet nga mjekë specialistë të cilët vlerësojnë gjendjen shëndetësore të të sëmurit dhe rekomandojnë trajtimin mjekësor, sipas specialitetit të tyre, dhe aftësinë për punë të tij;

h) “Sistemi informatik i raporteve mjekësore elektronike dhe dokumenteve që vërtetojnë gjendjen shëndetësore të shtetasve (*e-Raporte*)” është sistem informatik nëpërmjet të cilit profesionistët e shëndetësisë lëshojnë dokumente mjekësore me nënshkrim elektronik, sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me gjendjen shëndetësore të shtetasve, sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara.

## KREU II

### TIPAT E RAPORTEVE MJEKËSORE ELEKTRONIKE, KRITERET DHE PROCEDURA E LËSHIMIT TË TYRE

#### Neni 4

#### Paafësia e përkohshme në punë dhe tipat e raportit mjekësor elektronik

1. Paaftësia e përkohshme në punë si pasojë e sëmundjeve të përgjithshme të personit të punësuar vërtetohet vetëm me raport mjekësor elektronik të lëshuar nga mjekët e institucioneve shëndetësore publike, si dhe duke marrë në shqyrtim epikrizat nga mjekët në institucionet shëndetësore jopublike të licencuara, me shtretër.



2. Raportet mjekësore elektronike janë dokumente elektronike standarde, të plotësuara dhe të lëshuara nga mjeku i familjes, mjekët specialistë dhe anëtarët e Komisionit Mjekësor (në vijim KM), në bazë të ekzaminimeve dhe konsultave mjekësore, të cilët vërtetojnë gjendjen aktuale shëndetësore të të sëmurit për një periudhë të caktuar kohore.

2.1 Raportet mjekësore elektronike plotësohen dhe lëshohen nga mjekët përgjegjës vetëm nëpërmjet sistemit informatik të raporteve mjekësore elektronike dhe dokumenteve që vërtetojnë gjendjen shëndetësore të shtetasve (në vijim *e-Raport*), sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara. Në varësi të diagnozës, shkakut të saj, raportet mjekësore elektronike janë 5 tipash:

a) raport për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi;

b) raport për paaftësi të përkohshme në punë, për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga sigurimet shoqërore;

c) raport për paaftësi të përkohshme në punë, për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;

ç) raport për leje barrë lindjeje;

d) raport për kompensim në rast sëmundjeje ose shtatzënie kur ndryshon vendi i punës.

3. Mjekët e spitaleve publike dhe jopublike, si dhe anëtarët e KM, në procesin e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për të sëmurin, bazohen në “Kriteret klinike orientuese për caktimin e paaftësisë së përkohshme në punë”.

#### Neni 5

### **Raport për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi**

1. Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë, për shkak të sëmundjeve të përgjithshme, lëshohet nga mjeku i familjes, ku ka kartelën personale i punësuari, me afat nga 1 deri në 14 ditë pushim.

2. Mjeku specialist, mjeku stomatolog dhe mjekët specialistë/primar në turn të shërbimeve të urgjencës mjekësore pajisin të sëmurin me rekomandim, me qëllim lëshimin e raportit mjekësor sipas pikës 1 të këtij neni. Rekomandimi duhet të përmbajë diagnozën, të jetë i nënshkruar nga mjeku dhe institucioni ku është kryer akti dhe

të dorëzohet pranë mjekut të familjes së bashku me ekzaminimet/analizat e kryera. Dokumentet mjekësore përfshihen te kartela personale e pacientit pranë mjekut të familjes.

#### Neni 6

### **Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë, për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga sigurimet shoqërore dhe periudha e përfitimit**

1. Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme për sëmundje të përgjithshme në punë pas ditës së 14-të, lëshohet nga KM. Referimi në KM bëhet sipas sistemit të referimit në shërbimin shëndetësor publik.

1.1 Kur i punësuari shtrohet për mjekim në institucionet shëndetësore publike ose jopublike të licencuara, raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë lëshohet nga mjeku që nënshkruan epikrizën e pacientit dhe shefi i shërbimit, në një periudhë deri në 60 ditë nga dita e shtrimit në institucionin shëndetësor, sipas gjendjes shëndetësore të përcaktuar në “Kriteret klinike orientuese për paaftësi të përkohshme në punë”.

1.2 Kur i punësuari është duke u trajtuar me kimioterapi ose radioterapi, i cili ka kryer ose jo ndërhyrje për sëmundjen bazë, ka të drejtën për t’u pajisur me raport të paaftësisë së përkohshme në punë nga mjekët specialistë të shërbimit përkatës.

1.3 Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë, për persona të vendosur në karantinë mjekësore, lëshohet sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sëmundjet infektive.

2. Afati i raportit mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme mund të zgjatet nga Komisioni Mjekësor deri në 6 muaj nga data e lindjes të së drejtës së trajtimit me raport mjekësor.

3. Pas përfundimit të periudhës 6-mujore, periudha e përfitimit mund të zgjatet përjashtimisht 3 muaj të tjerë, në rast se komisioni i mjekëve ekspertë (KMCAP) provon që personi i punësuar do të shërohet në këtë periudhë dhe nuk do të deklarohet invalid.

4. Periudha e përfitimit të paaftësisë së përkohshme nga sëmundja për ata që marrin pension invaliditeti të pjesshëm është deri në tre muaj nga data e lindjes të së drejtës së trajtimit me raport mjekësor.



5. Periudha e përfitimit të paaftësisë së përkohshme nga sëmundja për punonjësit sezonal dhe të përkohshëm, të cilët kanë qenë të punësuar të paktën 3 muaj në 12 muajt e fundit, është deri në 75 ditë.

Neni 7

### **Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë të të sëmurëve që mjekohen jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. I punësuar i që trajtohet për probleme shëndetësore jashtë Republikës së Shqipërisë pajiset me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë me prapaveprim nga KM, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Komisioni i Qendrës Spitalore Universitare i cili ka vendosur dërgimin e të sëmurit jashtë shtetit.

2. Të drejtën për t'u pajisur me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë e ka dhe i punësuar i cili trajtohet jashtë Republikës së Shqipërisë, me shpenzimet e tij, në institucionet publike ose jopublike, në bazë të dokumenteve mjekësore zyrtare, të përkthyer dhe noterizuara, që vërtetojnë diagnozën dhe trajtimin.

3. Mjeku i familjes pranon dokumentacionin mjekësor që vërteton diagnozën dhe periudhën e trajtimit të qytetarit. Pranimi i dokumentacionit nga mjeku i familjes nënshkruhet elektronikisht dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore njoftohet nëpërmjet sistemit të Raporteve Mjekësore Elektronike. Brenda 5 (pesë) ditëve pune, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, mbi dokumentacionin mjekësor të pasqyruar në sistem nga mjeku i familjes, pas verifikimit të periudhës së sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për të drejtën e përfitimit, miraton nëpërmjet sistemit *e-Raport* vijimin e procedurës për vlerësim nga Komisioni Mjekësor, i cili me prapaveprim lëshon nëpërmjet *e-Raporteve*, raportet mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e gjithë kohën e trajtimit nga Institucioni Shëndetësor.

Neni 8

### **Raport për kompensim në rast sëmundjeje ose shtatzënie kur ndryshon vendi i punës**

1. I punësuar i që për arsye shëndetësore, me vendim të KM, duhet të ndryshojë vendin e punës,

pas ditës së 14-të të trajtimit me raport mjekësor nga mjeku i familjes, ka të drejtë të përfitojë nga sigurimet shoqërore kompensimin e të ardhurave sipas ligjit në fuqi për sigurimet shoqërore.

1.1 Të drejtën e përfitimit sipas pikës 1, të këtij neni, e ka edhe gruaja e siguruar e cila me vendim të KM ndryshon vendin e punës për arsye shtatzënie. Ky kompensim i jepet pas ditës së 14-të të trajtimit me raport mjekësor nga mjeku i familjes dhe vetëm në rast se është paguar kontribut për sigurimet shoqërore për një kohë jo më pak se 12 muaj.

2. Shuma e të ardhurave që do të përfitohet për kompensim është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme dhe pagës së vendit të punës së re.

2.1 Kompensimi për të punësuarin nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës dhe jepet për një periudhë jo më shumë se 3 muaj gjatë një viti, nga dita e fillimit të sëmundjes, për të cilën është ndryshuar vendi i punës.

2.2 Kompensimi për gruan shtatzënë që ndryshon vendin e punës nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit, nga data e lindjes të së drejtës për pagesë.

Neni 9

### **Raporti mjekësor për kujdes ndaj fëmijës së sëmurë**

1. I punësuar i, nëna, babai ose kujdestari ligjor i cili duhet të kujdeset për fëmijën deri në 14 vjeç të sëmurë, pajiset me raport mjekësor për kujdes ndaj fëmijës me afat deri në 14 ditë gjatë një periudhe 3-mujore.

2. Për nënën, babain ose kujdestarin ligjor i cili duhet të kujdeset efektivisht për fëmijën deri në moshën 14 vjeç, i cili trajtohet jashtë Republikës së Shqipërisë për diagnoza të rënda, pajiset me raport mjekësor për kujdes ndaj fëmijës me prapaveprim, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, me afat deri në 30 ditë.





## Neni 10

**Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për shkak aksidenti në punë, ose sëmundjeje profesionale**

1. Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjeje profesionale lëshohet nga institucionet spitalore dhe komisionet mjekësore përkatëse mbi bazën e dokumentacionit nga data e lindjes të së drejtës së trajtimit me raport mjekësor, sipas gjendjes shëndetësore të përcaktuar në “Kriteret klinike orientuese për paaftësi të përkohshme në punë”.

2. I punësuari, që për shkak aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, ka nevojë për riaftësim të kombinuar me mjekim balnear ose klimaterik, trajtohet me raport mjekësor sipas kësaj rregulloreje.

3. Raporti mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjeje profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë (KM), mund të zgjatet deri në 12 muaj.

## Neni 11

**Raport mjekësor për leje barrë lindjeje**

1. Raporti mjekësor për leje barrë lindjeje i lëshohet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrë lindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm.

1.1 Raporti mjekësor për lejen e paralindjes prej 35 ditësh kalendarike, lëshohet nga mjeku obstetër-gjinekolog dhe atje ku nuk ka të tillë nga mamia, e drejtë që fillon në moshën e barrës 35-javëshe të gruas.

1.2 Raporti mjekësor për lejen e paralindjes për gruan që ka mbi një fëmijë në barrë, është 60 ditë kalendarike, e drejtë që fillon në moshën e barrës 31-javëshe të gruas.

1.3 Gruas që i mbaron leja e paralindjes, por që akoma nuk ka lindur, për ditët deri sa të lindë, i lëshohet një vërtetim justifikues në bazë të të cilit punëdhënësi i jep leje pa të drejtë page.

1.4 Raporti mjekësor prej 330 ditësh kalendarike për lejen e lindjes fillon ditën që lind fëmija. Për 63

ditët e para të lejes së paslindjes, raporti mjekësor lëshohet nga mjeku obstetër-gjinekolog dhe aty ku nuk ka të tillë nga mamia, me një raport të vetëm 63-ditor. Pas këtij afati, raporti mjekësor lëshohet çdo muaj me raporte të veçanta 30-ditore nga mjeku i institucionit shëndetësor ku ka kartelën personale fëmija.

1.5 Gruaja nuk ka të drejtë që ditët e mbetura të papërdorura nga leja e paralindjes t'i përdorë pas lindjes dhe raportin mjekësor e merr sipas rregullave të caktuara në këtë rregullore.

1.6 Kur gruaja lind fëmijë të vdekur, ose fëmija vdes sapo lind, ajo ka të drejtë të marrë raport mjekësor pas lindjes vetëm 63 ditë. Me kalimin e këtij afati, në qoftë se gruaja vazhdon të jetë e sëmurë, i lëshohet raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë sipas rregullave të caktuara në këtë rregullore.

2. Raporti mjekësor për leje pas lindjes, për nënën, babain që ka qenë e/i siguruar jo më pak se 12 muaj dhe që birëson një fëmijë të moshës deri në 1 (një) vjeç, lëshohet nga mjeku i institucionit shëndetësor ku ka kartelën personale fëmija.

2.1 Raporti mjekësor sipas pikës 2, të këtij neni, lëshohet jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë.

2.2 Kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, gruaja që ka lindur pajiset me raport mjekësor për leje lindje sipas parashikimeve në këtë rregullore deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 63 ditë pas lindjes.

3. Babai i siguruar ose birësuesi i siguruar, pas periudhës 63-ditore nga lindja e fëmijës, pajiset me raport mjekësor për kujdes ndaj fëmijës, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

4. Raporti mjekësor për lejen e lindjes (kujdesi ndaj fëmijës) pas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, lëshohet nga mjeku i institucionit shëndetësor ku ka kartelën personale fëmija, pavarësisht vendbanimit sipas gjendjes civile të nënës/babit të fëmijës.

5. Kur nëna lind fëmijë jashtë Republikës së Shqipërisë, raportet mjekësore lëshohen me prapaveprim.

5.1 Nëna trajtohet me raport mjekësor për leje lindjeje (leje paslindjeje dhe kujdes ndaj fëmijës) pas



regjistrimit të fëmijës në zyrën e gjendjes civile. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, mbi bazën e dokumentit mjekësor të pasqyruar në sistem nga mjeku ku ka kartelën nëna ose fëmija, pas verifikimit të periudhës së sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për përfitim, miraton nëpërmjet sistemit elektronik të raporteve për vijimin e trajtimit me raporte nga mjeku, mbi bazën e dokumentit mjekësor përkatës të lëshuar nga institucioni shëndetësor i huaj që ka ndjekur si nënën ashtu dhe fëmijën.

5.2 Nëna trajtohet me raport mjekësor për leje lindje (leje paslindjeje dhe kujdes ndaj fëmijës) edhe për rastet e mosregjistrimit të fëmijës në zyrën e gjendjes civile. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, mbi bazën e dokumentit mjekësor dhe aktit të lindjes, të pasqyruar në sistem nga mjeku i familjes ku ka kartelën nëna, pas verifikimit të periudhës së sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për përfitim, miraton nëpërmjet sistemit elektronik të raporteve për vijimin e trajtimit me raporte nga mjeku, mbi bazën e dokumentit mjekësor përkatës të lëshuar nga institucioni shëndetësor i huaj që ka ndjekur si nënën ashtu dhe fëmijën.

### KREU III ORGANIZIMI DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT MJEKËSOR

Neni 12

#### **Ngritja dhe funksionimi i Komisionit Mjekësor**

1. Komisioni Mjekësor ngrihet nga drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, konfirmohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe funksionojnë në institucionet e shërbimit shëndetësor në poliklinika të specialiteteve.

2. Komisioni Mjekësor është organ i përhershëm, punon nën drejtimin e institucionit përkatës dhe kontrollohet e përgjigjet para Institutit të Sigurimeve Shoqërore lidhur me veprimtarinë e lëshimit të raporteve mjekësore të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 13

#### **Kriteret dhe procedura e anëtarësimit në Komisionin Mjekësor**

1. Komisioni Mjekësor përbëhet nga tre anëtarë, përfshirë kryetarin dhe dy anëtarë të tjerë zgjidhen zëvendësues.

2. Anëtarë të KM zgjidhen mjekë specialistë, si: kardiolog, patolog (reumatolog, nefrolog, pneumoftiziatër, endokrinolog etj.), kirurg, ortoped, neurolog, neurokirurg, psikiatër dhe okulist që punojnë në institucione shtetërore me shtretër, kanë njohuri shumë të mira në specialitetin e tyre dhe eksperiencë në specialitet.

3. Njësia vendore e kujdesit shëndetësor, drejtoria rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, i dërgon zyrtarisht rekomandimin me emrat e specialistëve të zgjedhur sipas përcaktimeve në këtë rregullore drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore për aprovim.

4. Njësia vendore e kujdesit shëndetësor, drejtoria rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor pas aprovimit nga DRSSH-ja/DSSH-ja, me urdhër të veçantë, ngre Komisionin Mjekësor në institucionet e shërbimit shëndetësor përkatëse. Urdhri shënon momentin e fillimit të aktivitetit të Komisionit.

5. Ndryshimet e mëvonshme në komision, lidhur me llojin e specialitetit dhe numrin e anëtarëve bëhen vetëm sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Në rajone të mëdha, mund të ngrihen komisione mjekësore të specializuara të përbëra prej tre mjekësh dhe dy zëvendësues, Komisioni Mjekësor mund të thërrasë në konsultë dhe mjekë të tjerë specialistë sa herë që e sheh të arsyeshme.

### KREU IV TË FUNDIT

Neni 14

#### **Plotësimi dhe lëshimi i raporteve mjekësore**

1. Raportet mjekësore janë dokumente elektronike standarde, më nënshkrim elektronik, që plotësohen sipas manualit të përdorimit të sistemit.



2. Raportet mjekësore elektronike të lëshuara në kundërshtim me parashikimet e kësaj rregulloreje, janë të pavlefshme dhe pagesa e tyre nga qendrat e punës dhe/ose nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëjnë shkelje të disiplinës financiare.

3. Raporti mjekësor elektronik ka datën dhe numrin e regjistrimit që mjeku viziton të sëmurin apo datën dhe numrin e regjistrimit të seancës së komisionimit që konstatohet paaftësia e përkohshme për punë.

4. Raporti mjekësor për të punësuarit që ndodhen me shërbim jashtë vendbanimit, do të lëshohet nga institucioni i kujdesit shëndetësor në të cilin është vizituar ose shtruar sipas rregullave të caktuara në këtë rregullore.

5. Ndalohet lëshimi i raportit mjekësor elektronik për kohë të kaluar në kundërshtim me këtë rregullore, me përjashtim të rasteve me sëmundje të shëndetit mendor, kur raporti mjekësor mund të lëshohet jo më shumë se 15 ditë para vizitës.

6. Personeli mjekësor i institucioneve shëndetësore është i detyruar t'i regjistrojë të dhënat e raporteve mjekësore si në regjistrin e vizitave ashtu edhe në kartelat personale të të sëmurve.

7. Raportet mjekësore janë dokumente financiare që ruhen dhe mbahen si të gjitha dokumentet e kësaj natyre.

#### Neni 15

#### Ushtimi i kontrollit

1. Organet e institucioneve shëndetësore shtetërore dhe sigurimet shoqërore ngarkohen me kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Strukturat përgjegjëse të ISSH-së/për verifikimin e ligjshmërisë së lëshimit të raporteve mjekësore, ushtrojnë kontroll sistematik të vazhdueshëm, sipas një programi kontrolli të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të dispozitave ligjore, akteve nënligjore, të kësaj rregulloreje, si dhe të kriterëve klinike orientuese për caktimin e paaftësisë së përkohshme në punë, mbahet akti përkatës, rast pas rasti, për të gjitha problematikat e hasura, si dhe hartohet një

relacion i mirëarsyetur me rekomandime/propozime mbi gjetjet.

#### Neni 16

#### Masat administrative dhe gjobat

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për shkeljet e konstatuara në procesin e ligjshmërisë së lëshimit të raporteve mjekësore, njofton zyrtarisht sipas rastit njësinë vendore të kujdesit shëndetësor, drejtorinë rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe titullarin e institucionit shëndetësor në të cilin është i punësuar specialisti përgjegjës.

1.1 Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në varësi të shkeljes së konstatuar, krahas aplikimit të gjobës sipas këtij neni, ka të drejtë t'i rekomandojë institucionit punëdhënës marrjen e masave me karakter administrativ sipas legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.

2. Shkeljet e parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm nga të cilat janë shkaktuar dëme të fondit të sigurimeve shoqërore, krahas masave të tjera sipas rastit, shoqërohen me masat materiale (gjobë), për mjekun e familjes e për secilin anëtar të Komisionit Mjekësor dhe për çdo rast të konstatuar, si vijon:

a) mosvijimesi në përcaktimin e diagnozës, diagnoza të ndryshme pa u shoqëruar me ekzaminime përkatëse, dënohet me gjobë nga 10.000 lekë;

b) lëshimi i raporteve me prapaveprim në kundërshtim me përcaktimet e kësaj rregulloreje dënohen me gjobë nga 15.000 lekë;

c) lëshimi i raporteve në kundërshtim me kushtet ligjore dënohet me gjobë nga 20.000 lekë;

d) përcaktimi i diagnozave në kundërshtim me "Kriteret klinike orientuese për caktimin e paaftësisë së përkohshme në punë" dënohet me gjobë nga 10,000 lekë;

e) mospërcaktimi i saktë i diagnozës bazuar në ekzaminimet dhe analizat përkatëse, dënohet me gjobë nga 5,000 lekë;

f) përcaktimi i afatit të periudhës së paaftësisë së përkohshme në punë në kundërshtim me kriteret klinike dhe afatet e përcaktuara, dënohet me gjobë nga 5,000 lekë;

g) veprimi në kundërshtim me normat e caktuara dhe që dëmtojnë fondet e sigurimeve



shoqërore, dënohen me gjobë nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) paga minimale në shkallë vendi;

h) kryerja e veprimeve aktive apo mosveprimeve të kundërligjshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lëshimit të raporteve mjekësore, apo për shkak të saj, si: falsifikim dokumentesh, korrupsion aktiv/pasiv, shpërdorim detyre etj., pavarësisht dënimit të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, dënohet me gjobë nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) paga minimale në shkallë vendi.

Neni 17

### **Dispozita tranzitore dhe të fundit**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

2. Rregullorja e përbashkët e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe e Ministrisë së Shëndetësisë “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë” nr. 494, datë 5.10.1993, të ndryshuar, shfuqizohet.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Joana Duro**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE  
SHOQËRORE  
**Astrit Hado**

## **KËRKESË**

**Nr. 347-6, datë 6.7.2022**

### **PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Cërrik–Kajan–Kuçovë–Jagodinë’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në shoqërinë “OST” sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 555,402 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË  
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE  
**Erlis Hereni**



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 110 kV CËRRIK–KAJAN–KUÇOVË–JAGODINË”

Nr. rendor	Nr. shtyllë	Pronari			Të dhëna hipotekore										Vlerësimet për shpronësim				Adresa	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m <sup>2</sup> )	Trrall (m <sup>2</sup> )	Ndërtesë (m <sup>2</sup> )	Volumi	Faqe	Arë			Vlera totale (lekë)		
															Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)			
A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	Y	Z			
1	4	Tasim		Mece	Lugaj	2511	118/1/5	Ullishte	2490							21.39	222	4749	4749	Fshati Lugaj, NjAPapër, Bashkia Elbasan.
2	8	Ilinjan	Zybi	Memko	Cërrik - F ermë	2281	94/6	Vresht	625							17.12	222	3801	3801	Fshati Cërrik - Fermë, Bashkia Cërrik
3	11	Hidajete	Hajredin	Xhelo	Cërrik - Fermë	2281	174/44	Arë	1100	1100						17.12	222	3801	3801	Fshati Cërrik - Fermë, Bashkia Cërrik
4	12	Tomorr	Hasan	Kasa	Cërrik - Fermë	2281	240/15	Arë	9437	9437						18.69	222	4149	4149	Fshati Cërrik - Fermë, Bashkia Cërrik
5	13	Perparim	Livan	Skenderi	Cërrik - Fermë	2281	240/12	Arë	5960	5960						21.39	222	4749	4749	Fshati Cërrik - Fermë, Bashkia Cërrik
6	15	BP familja Meçi			Shalës	3313	199/2	Arë	10288	10288						17.12	222	3801	3801	Fshati Shalës, NjA Shalës, Bashkia Cërrik
7	16	Sabri	Pasho	Salja	Shalës	3313	201/3	Arë	2630	2630						20.21	222	4487	4487	Fshati Shalës, NjA Shalës, Bashkia Cërrik
8	17	Qamil	Rakip	Qosja	Shalës	3313	207/5/1	Arë	7200	7200						18.69	222	4149	4149	Fshati Shalës, NjA Shalës, Bashkia Cërrik
9	18	Dalip	Jonuz	Balashi	Shalës	3313	251/11	Arë	3754	3754						18.69	222	4149	4149	Fshati Shalës, NjA Shalës, Bashkia Cërrik
10	19	BP familja Kuçja			Liçaj	2449	416/32	Arë	3492	3492						18.69	222	4149	4149	Fshati Liçaj, NjA Shalës, Bashkia Cërrik
11	27	Ramadan	Qazim	Dymyshi	Dushku	1581	54/29	Arë	14300	14300						17.12	222	3801	3801	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
12	28	Luan	Hysni	Musta	Dushku	1581	53/4	Arë	3000	3000						19.87	222	4411	4411	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
13	29	Nuri	Ismail	Muça	Dushku	1581	52/8	Arë	11000	11000						21.87	222	4855	4855	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
14	30	Idriz	Haxhi	Shkëmbi	Dushku	1581	88/25	Arë	4337	4337						21.87	222	4855	4855	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
15	31	Besim	Nezir	Dyrma	Dushku	1581	88/6	Arë	6400	6400						17.12	222	3801	3801	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
16	33	Kujtim	Rushan	Xhelili	Dushku	1581	162/1	Arë	6563	6563						17.12	222	3801	3801	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
17	34	Kujtim	Ibrahim	Muça	Dushku	1581	177/34	Arë	2000	2000						18.69	222	4149	4149	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
18	35	Meçan	Dine	Salla	Dushku	1581	177/18	Arë	2100	2100						18.69	222	4149	4149	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
19	36	BP familja Kuçja			Dushku	1581	177/24	Arë	4922	4922						17.12	222	3801	3801	Fshati Dushk, NjA Belsh, Bashkia Belsh
20	39	BP Harizi, Lleshi, Jaupi, Kushta, Roci, Lleshi, Daja			Rrenas	3223	1/26	Arë	2216	2216						17.12	222	3801	3801	Fshati Rrenas, NjA Grekan, Bashkia Belsh



21	43	BP familja Shtino & Spahiu			Grekan	1853	170/4	Pyll	447000						17.00	85	1445	1445	Fshati Grekan, NjA Grekan, Bashkia Belsh
22	46	Bezat	Livan	Allkja	Kajan	2026	71/15	Arë	14000	14000					72.25	222	16040	16040	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
23	47	Gani	Shahin	Kullolli	Kajan	2026	67/9	Arë	5816	5816					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
24	48	Banush	Reshit	Kullolli	Kajan	2026	118/12	Arë	12000	12000					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
25	50	Kujtim	Nevruz	Elezi	Kajan	2026	122/9	Arë	7079	7079					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
26	51	Teuta	Bashkim	Se NjA	Kajan	2026	52/7/1	Arë	4400	4400					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
27	52	BP familjet Xhafa, Hysa, Buzani, Allkja, Tafani, Bërdufi, Cërriku.			Kajan	2026	130/14	Arë	8186	8186					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
28	53	Qemal	Ramazan	Ferhati	Kajan	2026	134/3	Arë	11600	11600					17.12	222	3801	3801	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
29	54	Fent	Haziz	Xhafa	Kajan	2026	169/62	Arë	11581	11581					21.39	222	4749	4749	Fshati Kajan, NjA Kajan, Bashkia Belsh
30	56	Selman	Demir	Paja	Turbull	3663	73/1	Arë	5807	5807					63.95	222	14197	14197	Fshati Turbull, NjA Kajan, Bashkia Belsh
31	57	Sherif	Mersin	Roci	Turbull	3663	96/3	Arë	6170	6170					18.69	222	4149	4149	Fshati Turbull, NjA Kajan, Bashkia Belsh
32	59	BP familja Kullolli			Turbull	3663	169/6	Arë	6000	6000					17.12	222	3801	3801	Fshati Turbull, NjA Kajan, Bashkia Belsh
33	60	Sabri	Hysen	Kullolli	Turbull	3663	170/2	Arë	3625	3625					17.12	222	3801	3801	Fshati Turbull, NjA Kajan, Bashkia Belsh
34	61	Xhevahir	Isuf	Toromani	Gjinuku	1744	2/2	Arë	12128	12128					17.12	222	3801	3801	Fshati Gjinuk, NjA Kajan, Bashkia Belsh
35	62	B.P. familja Paja			Gjinuku	1744	2/38	Arë	3585	3585					21.39	222	4749	4749	Fshati Gjinuk, NjA Kajan, Bashkia Belsh
36	63	Jemin	Emin	Tabaku	Gjinuku	1744	33/1	Arë	4736	4736					17.12	222	3801	3801	Fshati Gjinuk, NjA Kajan, Bashkia Belsh
37	64	BP familja Dragoti, Kuka, Halko			Dragot	1528	65/17	Arë	3900	3900					17.12	222	3801	3801	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
38	65	Tafil	Shahin	Dragoti	Dragot	1528	75/35	Arë	5900	5900					17.12	222	3801	3801	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
39	66	Skender	Sheme	Dragoti	Dragot	1528	75/64	Arë	1125	1125					18.69	222	4149	4149	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
40	67	Nazmi	Sabri	Dragoti	Dragot	1528	130/46	Arë	2228	2228					21.87	222	4855	4855	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
41	68	Halim	Ymer	Dragoti	Dragot	1528	132/37	Pemëtores	788						26.3	222	5839	5839	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
42	69	Xhaferr	Faik	Preci	Dragot	1528	174/3	Arë	19500	19500					17.12	222	3801	3801	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
43	70	Osman	Xhaferr	Preci	Dragot	1528	174/1	Arë	12069	12069					17.12	222	3801	3801	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
44	71	Kujtim	Sul	Joldashi	Dragot	1528	248/22	Arë	4157	4157					20.21	222	4487	4487	Fshati Dragot, NjA Kajan, Bashkia Belsh
45	72	Fadil	Ramadan	Shtëpë NjA	Vlashuk	3798	65/7	Arë	11034	11034					21.39	268	5733	5733	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
46	73	Fatos	Qatip	Haxhiu	Vlashuk	3798	65/46	Arë	4851	4851					17.12	268	4588	4588	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
47	74	BP familja Çela			Vlashuk	3798	59/17	Arë	6437	6437					17.12	268	4588	4588	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
48	75	Myftar	Aqif	Haxhiu	Vlashuk	3798	59/31	Arë	4560	4560					17.12	268	4588	4588	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë



49	76	Krenar	Mersin	Haxhiu	Vlashuk	3798	57/45	Arë	6715	6715							21.39	268	5733	5733	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
50	77	Katerina	Xhemal	Domi	Vlashuk	3798	56/11	Arë	4600	4600							18.69	268	5009	5009	Fshati Vlashuk, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
51	78	Hashi	Veiz	Pire	Zdrave	3966	539/3	Arë	3400	3400							18.69	268	5009	5009	Fshati Zdrave, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
52	80	Sadik Pire & Hashi Pire			Zdrave	3966	530/5	Arë	4000	4000							17.12	268	4588	4588	Fshati Zdrave, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
53	82	Shtet			Havaleas	1943	527	Pemëtores	31000								17.12				Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
54	83	Shtet			Havaleas	1943	527	Pemëtores	31000								28.56				Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
55	85	Bashkëpronarë			Havaleas	1943	472	Vresht	18175								21.39	300	6417	6417	Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
56	86	Asqeri	Arfi	Mara	Havaleas	1943	486/9	Arë	5556	5556							34.81	300	10443	10443	Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
57	87	Xhevahir	Jons	Mara	Havaleas	1943	794/8	Arë	9800	9800							21.87	300	6561	6561	Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
58	88	Gani	Nuderin	Mara	Havaleas	1943	781/2	Arë	8230	8230							21.39	300	6417	6417	Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
59	89	BP F. Bujqësore Xhezmi Roseni & Ali Çako			Havaleas	1943	1110/1	Ullshite	1400								15.23	300	4569	4569	Fshati Havaleas, NjA Kozarë, Bashkia Kuçovë
60	93	Zoi	Jani	Prifti	Rreth-Tapi	3227	23/10	Arë	9000	9000							57.40	311	17851	17851	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
61	94	Halit	Rexhep	Vrapit	Rreth-Tapi	3227	51/1	Arë	12397	12397							26.05	311	8102	8102	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
62	95	Xhevair	Rexhep	Vrapit	Rreth-Tapi	3227	51/11	Arë	2000	2000							17.12	311	5324	5324	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
63	96	BP familja Suli			Rreth-Tapi	3227	71/33	Arë	8150	8150							26.3	311	8179	8179	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
64	97	Vangjel	Faik	Bava	Rreth-Tapi	3227	70/22	Arë	14000	14000							17.12	311	5324	5324	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
65	98	Islam	Shaban	Daulle	Rreth-Tapi	3227	63/6	Arë	10000	10000							21.39	311	6652	6652	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
66	106	Gazment	Shaban	Daulija	Rreth-Tapi	3227	63/14	Arë	9000	9000							4.0	311	1244	1244	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
67	107	Goni	Lipe	Qafoku	Rreth-Tapi	3227	70/4	Arë	12000	12000							17.12	311	5324	5324	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
68	108	Taulant	Besim	Ferthi	Rreth-Tapi	3227	72/4	Arë	2570	2570							17.12	311	5324	5324	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
69	109	Hati	Qamil	Tifi	Rreth-Tapi	3227	76/3	Arë	1768	1768							17.12	311	5324	5324	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
70	110	Pellumb	Siko	Tole	Rreth-Tapi	3227	78/7	Arë	8000	8000							20.21	311	6285	6285	Fshati Rreth Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
71	112	Shkelqim	Sadik	Kallmi	Tapi	3561	1314/3	Arë	960	960							17.12	311	5324	5324	Fshati Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
72	113	BP familja Plaku			Tapi	3561	1493/1	Arë	1140	1140							21.87	311	6802	6802	Fshati Tapi, NjA Perondi, Bashkia Kuçovë
73	115	Mihal	Andon	Koraçe	Çiflik	1405	688/12	Arë	3782	3782							18.69	204	3813	3813	Fshati Çiflik, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
74	116	Bilbil	Tahir	Avdiu	Çiflik	1405	721/26	Arë	1927	1927							18.69	204	3813	3813	Fshati Çiflik, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
75	119	Hasan	Tofik	Roci	Poshnjë	3032	794/10	Arë	11300	11300							18.69	204	3813	3813	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
76	120	Agim	Qemal	Protoduari	Poshnjë	3032	799/7	Arë	5472	5472							20.2	204	4121	4121	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal



77	121	Josif	Themi	Mbrice	Poshnjë	3032	863/6	Arë	2000	2000					26.05	204	5314	5314	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
78	122	Fatmir		Musta	Poshnjë	3032	883/1	Arë	6200	6200					23.66	204	4827	4827	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
79	123	Petraç	Miti	Zhuka	Poshnjë	3032	338/9	Arë	300	300					4.0	204	816	816	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
80	124	BP familja Ziu & Protoduan			Poshnjë	3032	887/302	Ullishte	1875						17.12	204	3492	3492	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
81	125	Myrteza	Veli	Ismailaj	Poshnjë	3032	889/7	Ullishte	1600						26.3	204	5365	5365	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
82	126	Genci	Yzedin	Ismailaj	Poshnjë	3032	887/129	Ullishte	4550						23.66	204	4827	4827	Fshati Poshnjë, NjA Poshnjë, Bashkia Dimal
83	127	Gori	Miho	Kerni	Sqepur	3504	159/12	Arë	5148	5148					71.0	203	14413	14413	Fshati Sqepur, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
84	128	Gaqi	Lili	Thanasi	Sqepur	3504	158/10	Arë	9750	9750					15.23	203	3092	3092	Fshati Sqepur, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
85	130	BP Thanasi, Llace, Hitollari			Sqepur	3504	155/1	Arë	5000	5000					17.12	203	3475	3475	Fshati Sqepur, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
86	133	Muharrem	Ramadan	Sclamaj	Kutalli	2349	4/79	Arë	2950	2950					17.12	203	3475	3475	Fshati Kutalli, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
87	135	Përfaqësues të familjeve bashkëpronar			Kutalli	2349	7/23	Vrshet	19650						17.12	203	3475	3475	Fshati Kutalli, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
88	136	Jorgje	Mihal	Bibo	Kutalli	2349	7/24	Vrshet	460						17.12	203	3475	3475	Fshati Kutalli, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
89	141	Fernk	Mane	Dogani	Kutalli	2349	66/19	Arë	2300	2300					17.12	203	3475	3475	Fshati Kutalli, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
90	142	Arben	Zabif	Vrapi	Kutalli	2349	66/4	Arë	2180	2180					26.3	203	5339	5339	Fshati Kutalli, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
91	145	Pëllumb	Hakuran	Hatija	Kumarak	3173	65/13	Arë	1560	1560					15.23	203	3092	3092	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
92	146	Baftar	Musa	Hatija	Kumarak	3173	65/28	Arë	4357	4357					4.0	203	812	812	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
93	148	Lufar	Medi	Hatija	Kumarak	3173	37/22	Arë	4400	4400					17.12	203	3475	3475	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
94	149	Fasli	Xhelal	Yzeiri	Kumarak	3173	38/14	Arë	6750	6750					17.12	203	3475	3475	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
95	150	Vladimir	Pelivan	Cala	Kumarak	3173	20/4	Arë	4260	4260					17.12	203	3475	3475	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
96	151	Xhevahir	Hysni	Mbarsi	Kumarak	3173	11/48	Arë	1200	1200					21.87	203	4440	4440	Fshati Kumarak, NjA Kutalli, Bashkia Dimal
97	154	Koli	Kristo	Kalivaci	Strum	3532	22/11	Arë	13237	13237					26.3	269	7075	7075	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
98	155	Afrim	Idajet	Myrto	Strum	3532	20/5	Arë	10120	10120					17.12	269	4605	4605	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
99	156	Kadri	Tahir	Muska	Strum	3532	16/5	Arë	8300	8300					17.12	269	4605	4605	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
100	157	Nexhip Reapo Hazizi + 4 bashkëpronarë			Strum	3532	119/15	Arë	7450	7450					23.60	269	6348	6348	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
101	158	Hajdar	Shaip	Hazizi	Strum	3532	12/9	Arë	12400	12400					18.69	269	5028	5028	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
102	159	Reapi	Llazi	Vasa	Strum	3532	5/1	Arë	4500	4500					17.12	269	4605	4605	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
103	160	Agron dhe Altina Cjapi			Strum	3532	3/5	Arë	6650	6650					17.12	269	4605	4605	Fshati Strum, NjA Strum, Bashkia Roskovec
104	162	Jorgji	Lame	Goga	Roskovec	3196	76/2	Arë	11000	11000					17.12	269	4605	4605	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec





105	163	Flutura	Qani	Hajdini	Roskovec	3196	80/13	Arë	4278	4278					21.39	269	5754	5754	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
106	164	Rajmonda	Rustem	Hajdini	Roskovec	3196	68/17	Arë	4400	4400					17.12	269	4605	4605	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
107	165	Xhevit	Ramadan	Gega	Roskovec	3196	66/13	Arë	15400	15400					20.21	269	5436	5436	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
108	166	Diana	Myrteza	Vrapi	Roskovec	3196	62/6	Arë	5504	5504					21.87	269	5883	5883	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
109	167	Fatbardha	Xhezai	Vrapi	Roskovec	3196	63/16	Arë	15819	15819					17.12	269	4605	4605	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
110	168	Bashkim	Shaban	Çepele	Roskovec	3196	13/119	Arë	6600	6600					17.12	269	4605	4605	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
111	169	Sulo	Rustem	Çepele	Roskovec	3196	14/18	Arë	13200	13200					17.12	269	4605	4605	Fshati Roskovec, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
112	170	Agim	Gani	Çepele	Jagodinë	1992	17/1	Arë	3200	3200					21.39	269	5754	5754	Fshati Jagodinë, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
113	171	Gezim	Shyqo	Myrto	Jagodinë	1992	1/48	Arë	2333	2333					18.69	269	5028	5028	Fshati Jagodinë, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
114	172	Hanik	Dane	Çepele	Jagodinë	1992	1/58	Arë	3376	3376					21.87	269	5883	5883	Fshati Jagodinë, NjA Roskovec, Bashkia Roskovec
<b>SHUMA</b>																		<b>555402</b>	





*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 432 lekë